Po, ju jeni emnue mësues.

Kur âsht emnue ai oficer?
Ai âsht emnue oficer në vjetin 19..

A i emnon oficerat Presidenti?
Po, Presidenti i emnon oficerat.

Kush i emnon oficerat?
Presidenti i emnon oficerat.

A emnohet apo zgjidhet Presidenti i Shtetevet të Bashkueme?
Presidenti i Shtetevet të Bashkueme zgjidhet.

A emnohen apo zgjidhen ministrat?
Ministrat emnohen.

4.

A përfshîn nji rreth nji numër fshatrash?
Po, nji rreth përfshîn nji numër fshatrash.

A përfshîn nji qytet nji numër lagjesh?
Po, nji qytet përfshîn nji numër lagjesh.

Cila njisí administrative përfshin nji numër fshatrash?
Rrethi përfshîn nji numër fshatrash.

Ç'njisí administrative përfshîn nji numër lagjesh?
Qyteti përfshîn nji numër lagjesh.

5.

A varet zgjedhja e nji presidenti nga votat e popullit?
Po, zgjedhja e nji presidenti varet nga votat e popullit.

Nga çka varet zgjedhja e nji presidenti?
Zgjedhja e nji presidenti varet nga votat e popullit.

A jeni ju të pavarun në vendimet tueja?
Po, na jemi të pavarun në vendimet tona.

Në çka jeni ju të pavarun?
Na jemi të pavarun në vendimet tona.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A âsht Shqipnija nji shtet i pavarun?
Po, Shqipnija âsht nji shtet i pavarun.

Çfarë shteti âsht Shqipnija?
Shqipnija âsht nji shtet i pavarun.

A ka qenë Shqipnija nji shtet i pavarun para vjetit 1912?
Jo, Shqipnija nuk ka qenë nji shtet i pavarun para vjetit 1912.

Kur âsht bâ Shqipnija nji shtet i pavarun?
Shqipnija âsht bâ nji shtet i pavarun në vjetin 1912.

6.

Zakonisht, a mund të marrin dënim me vdekje ata që vrasin?
Po, zakonisht ata që vrasin mund të marrin dënim me vdekje.

Çfarë dënimi mund të marrin ata që vrasin?
Ata që vrasin mund të marrin dënim me vdekje.

A zbatohet dënimi me vdekje me pushkatim në Shqipní?
Po, besoj se dënimi me vdekje zbatohet me pushkatim në Shqipní.

Me çka tjetër zbatohet në Shqipní dënimi me vdekje?
Në Shqipní dënimi me vdekje zbatohet edhe me varje në litár.

Ku zbatohet dënimi me vdekje me pushkatim ase me varje në litár?
Në Shqipní dënimi me vdekje zbatohet me pushkatim ase me varje në litár.

Zakonisht, a mbarohet mirë nji punë që bâhet shpejt?
Jo, zakonisht nji punë që bâhet shpejt nuk mbarohet mirë.

Çka nuk mbarohet mirë zakonisht?
Nji punë që bâhet shpejt nuk mbarohet mirë zakonisht.

Çfarë pune nuk mbarohet mirë?
Puna që bâhet shpejt nuk mbarohet mirë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A mund të pritet njeriu me brisk kur rruhet shpejt?
Po, njeriu mund të pritet me brisk kur rruhet shpejt.

Kur mund të pritet njeriu me brisk?
Njeriu mund të pritet me brisk kur rruhet shpejt.

Në çfarë rasti mund të pritet njeriu me brisk?
Kur rruhet shpejt njeriu mund të pritet me brisk.

7. kam me ..., kam për të ...
(used as future tenses under necessity or obligation, usually)

A do të shkojsh sot në pazár për të blé ca plaçka?
Po, unë do të shkoj sot në pazár për të blé ca plaçka?

A ke me shkue sot në pazár për të blé ca goma?
Po, kam me shkue sot në pazár për të blé ca goma.

A ke për të shkue sot në pazár për të blé harxh për shtëpí?
Po, sot kam për të shkue në pazár për të blé harxh për shtëpí.

Kush do të shkojë në pazár për të blé ca plaçka?
Ai do të shkojë në pazár për të blé ca plaçka.

Kush ka me shkue në pazár për të blé ca goma?
Ai ka me shkue në pazár për të blé ca goma.

Kush ka për të shkue në pazár për të blé harxh për shtëpí?
Ai ka për të shkue në pazár për të blé harxh për shtëpí.

Ku do të shkoj unë për të blé ca plaçka?
Ti do të shkojsh në pazár për të blé ca plaçka.

Ku kam me shkue unë për të blé ca goma?
Ti ke me shkue në pazár për të blé ca goma.

Ku kam për të shkue unë për të blé harxh për shtëpí?
Ti ke për të shkue në pazár për të blé harxh për shtëpí.

A do të punoj unë mbasnesër?
Po, ju do të punoni mbasnesër.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A keni me punue mbasnesër?
Po, unë kam me punue mbasnesër.

A keni për të punue mbasnesër?
Po, unë kam për të punue mbasnesër.

8. dyfish, trefish, katërfish etj.

A e bleve biletën e teatrit?
Po, por e pagova dyfish sepse e bleva në pazár të zí.

Kush e pagoi dyfish biletën për të hŷ në teatër?
Unë e pagova dyfish biletën për të hŷ në teatër.

Pse e pagove dyfish biletën e teatrit?
E pagova dyfish sepse s'gjeta biletë përveçse në pazár të zí.

A âsht dyfishue popullsija e Shqipnís qysh nga vjeti 1945?
Po, popullsija e Shqipnís âsht mâ shumë se dyfishue nga vjeti 1945.

Po popullsija e Tiranës?
Popullsija e Tiranës âsht shtue pothuejse gjashtëfish.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 64
PART V
READING TEXT

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

Tue qenë se Kuvendi Popullor âsht nji organ që punon periodikisht, âsht paraqitë nevoja e formimit të nji organi tjetër të naltë të pushtetit, i cili duhet të vendosi për të gjitha çashtjet e rândësishme shtetnore që dalin gjatë kohës që Kuvendi Popullor nuk âsht në sesion. Sikur pamë, nji organ i tillë âsht Presidiumi i Kuvendit Popullor. Simbas Kushtetutës së vjetit 1976 kompetencat e Presidiumit të Kuvendit Popullor janë të shumta. Këto janë disa nga këto kompetenca: thërret sesionet e Kuvendit Popullor, shpall dekrete, deklaron luftë në raste të jashtëzakonshme etj.

Organet lokale të pushtetit popullor janë këshillat popullore. Nga pikëpamja administrative, RPS e Shqipnís ndahet në 26 rrethe dhe në qytetin e Tiranës. Secila prej tyne ka këshillin e vet popullor. Gjithashtu edhe çdo fshat dhe çdo lagje e qytetit ka nji këshill popullor, i cili varet nga ai i rrethit. Këshillat Popullore të rrethevet dhe të qytetit varen nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Këshillat Popullore zgjedhin, nga gjiu i tyne, komitetet ekzekutive; këto nuk janë asgjâ tjetër veçse organet e tyne ekzekutive. Çdo komitet ekzekutiv ka seksione ose zyra të veçanta, me anën e të cilave drejton punët e ndryshme t'administratës shtetnore.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Sot në Shqipní ka këto gjykata: Gjykata e Lartë, e cila zgjidhet nga Kuvendi Popullor, Gjykata Ushtarake dhe gjykatat popullore; këto të fundit zgjidhen nga populli. Nuk duhet harrue se kandidatët si për deputetë ashtu edhe për gjyqtarë popullorë i paraqet partija, dhe populli nuk ka mundësí të paraqesi kandidatët e vet.

Në Kushtetutë gjithashtu thuhet se Prokurorija (e Përgjithshme) âsht organ i Kuvendit Popullor, dhe Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet po nga Kuvendi Popullor. Nji ndër detyrat e tija âsht edhe të kontrollojë që ligjët dhe dekretet të pajtohen me Kushtetutën.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS - PYETJE

1. Cili âsht organi mâ i naltë i pushtetit që punon periodikisht?
2. Pse âsht paraqitë nevoja e formimit të nji organi tjetër të naltë të pushtetit?
3. Si quhet ky organ i naltë që vendos për të gjitha çashtjet e rândësishme shtetnore?
4. Gjatë cilës kohë dalin çashtje të rândësishme për të cilat vendos Presidiumi i Kuvendit Popullor?
5. Sesionet e cilit organ thërret Presidiumi i Kuvendit Popullor?
6. Çka shpall Presidiumi?
7. Në cilat raste deklaron luftë Presidiumi?
8. Çka janë këshillat popullore?
9. Nga cila pikëpamje ndahet në 26 rrethe dhe në qytetin e Tiranës RPS e Shqipnís?
10. Çfarë organi ka secila prej këtyne zonave?
11. Cili âsht këshilli popullor mâ i vogël?
12. Nga cili organ varet këshilli popullor i fshatit?
13. Nga cili organ varet këshilli popullor i lagjes?
14. Nga cili organ varet këshilli popullor i rrethit dhe ai i qytetit?
15. Cili organ e zgjedh komitetin ekzekutiv?
16. Cilat janë pra organet ekzekutive të këshillavet popullore?
17. Çka ka çdo komitet ekzekutiv?
18. Çka drejton komiteti ekzekutiv me anën e seksionevet dhe zyravet të veçanta që ka?
19. A kanë të gjitha fshatrat komitete ekzekutive?
20. Cili organ e bân punën kur nji fshat nuk ka komitet ekzekutiv?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

21. Sa lloj gjykatash ka sot në Shqipní?

22. Cilat janë këto tri lloj gjykatash që ka sot në Shqipní?

23. Cili organ e zgjedh Gjykatën e Lartë?

24. Kush i zgjedh gjykatat popullore?

25. Kush i paraqet kandidatët për deputetë ase gjyqtarë popullorë?

26. Kush nuk ka mundësí të paraqesi kandidatët e vet?

27. Ku thuhet se Prokurorija âsht organi i Kuvendit Popullor?

28. Çka thuhet në Kushtetutë?

29. Nga cili organ zgjidhet Prokurori i Përgjithshëm?

30. Cila âsht nji ndër detyrat e Prokurorit të Përgjithshëm?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 64
PART VI
HOMEWORK

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

A. Përgjigjuni me fjalët tueja këtyne pyetjeve:

1. Pse âsht formue Presidiumi i Kuvendit Populllor?

2. Cilat janë disa nga detyrat e Presidiumit të Kuvendit Populllor?

3. Kush e zgjedh Gjykatën e Lartë?

4. Kush i zgjedh gjykatat populllore?

B. Mbushni vendet boshe të fjalivet që vazhdojnë:

5. Të lutem, m'ep _____ (some cheese)?

6. A ke me më dhânë _____ (some money) hua?

7. Sa âsht _____ (the subscription) në këtë gazetë?

8. Në shumë vende të botës s'ka _____ (death penalty)?

9. Por në disa vende tjera ka dënim me vdekje, i cili zbatohet ja _____ (by hanging) ja _____ (by a firing squad).

10. Ju duhet _____ (act) menjiherë; s'keni kohë shumë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E SHTATË
FJALORI

LESSON 64
PART VII
VOCABULARY

administrative, -e	(adj. m. & f.)	administrative
çashtje, çashtja çashtje, -t	(f.)	question, problem, issue, matter
dekret, -i dekrete, -t	(m.)	decree; commission (authorization)
dënim, -i dënime, -t	(m.)	condemnation, sentence, punishment
ekzekutiv, -e	(adj.) m. & f.)	executive
formim, -i formime, -t	(m.)	formation
me gjykue (unë gjykoj)	(v.)	to judge, to try (law)
gjyqtár, -i gjyqtarë, -t	(m.)	judge
i, të jashtëzakonshëm e, të jashtëzakonshme	(adj. m. & f.)	extraordinary, unusual
kandidat, -i kandidatë, -t	(m.)	candidate
komitet, -i komitete, -t	(m.)	committee
kompetencë, -a kompetenca, -t	(f.)	competence, competency, prerogative
me kontrollue (unë kontrolloj)	(v.)	to check, search, control, check up
legjislativ, -e	(adj. m. & f.)	legislative
ligjë, -a ligjë, -t	(f.)	law
litár, -i litarë, -t	(m.)	rope

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

lokal, -e	(adj. m. & f.)	local
mot	(adv.)	next year
ndamje ndamja ndamje, -t	(f.)	division, subdivision; split, schism
pajtim, -i pajtime, -t	(m.)	reconciliation; conformity; subscription
me u-pajtue (unë pajtohem)	(v.)	to be reconciled with, to reconcile; subscribe to, to be in conformity with, agree with
me paraqitë (unë paraqes)	(v.)	to put forward, submit, present, introduce
i, e, të pavarum të pavaruna	(adj. m. & f.)	independent
me u-paraqitë (unë paraqitem)	(v.)	to be presented, to be introduced, to report, to introduce oneself
periodikisht	(adv.)	periodically
me përfshî (unë përfshîj)	(v.)	to include, encompass
me përmendë (unë përmend)	(v.)	to mention
me u-përmendë (unë përmendem)	(v.)	to be mentioned; to come to (to regain consciousness)
pikëpamje, pikëpamja pikëpamje, -t	(f.)	point of view, standpoint
prokurorí, -ja prokurorí, -t	(f.)	the office of the district attorney
Prokurori i Përgjithshëm	(m.)	Attorney General

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

pushkatim, -i pushkatime, -t	(m.)	execution by a firing squad
seksion, -i seksione, -t	(m.)	section
me sundue (unë sundoj)	(v.)	to rule, govern, dominate, master
me shpallë (unë shpall)	(v.)	to proclaim, declare, announce
i, e, të shumtë të shumta	(adj. m. & f.)	many, (the) majority of, most of
ushtarak, -e	(adj. m. & f.)	military army-
me u-varë (unë varem)	(v.)	to depend on, to be subordinate to; to be hung; to hang oneself
varje, varja varje, -t	(f.)	hanging, execution by hanging
vendim, -i vendime, -t	(m.)	decision, verdict
me veprue (unë veproj)	(v.)	to act, operate, work, perform, function
me u-zbatue (zbatohet)	(v.)	to be carried out, applied, executed
me u-zgjedhë (unë zgjidhem)	(v.)	to be elected, selected, chosen, picked out

<u>Shënime</u>

me anë të ...	through, by means of
dënim me vdekje	death sentence, death penalty

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 65
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE — GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1.

Njija âsht mâ e vogël se dyja.

A âsht njija mâ e vogël se dyja?
Cili numër âsht mâ i vogël se dyja?
Cili numër âsht mâ i madh se njija?

Trija në nândë hŷn trí herë.

A hŷn trija në nândë trí herë?
Sa herë hŷn trija në nândë?
Cili numër hŷn trí herë në nândë?

Klasa ka marrë 10 teta në provimin e gjuhës shqipe.

A ka marrë klasa 10 teta në provimin e gjuhës shqipe?
Sa teta ka marrë klasa në provimin e gjuhës shqipe?
Në cilin provim ka marrë 10 teta klasa?

Ai ka marrë 4 shtata sivjet.

A ka marrë ai 4 shtata sivjet?
Kush ka marrë 4 shtata sivjet?
Sa shtata ka marrë ai sivjet?
Kur ka marrë ai 4 shtata?

2.

1980-a ka qenë plot ngjarje me rândësí.

A ka qenë 1980-a plot ngjarje me rândësí?
Cili vjet ka qenë plot ngjarje me rândësí?
Me çfarë ngjarjesh ka qenë plot 1980-a?

Automobilat e 1982-së kanë dalë vjet.

A kanë dalë vjet automobilat e 1982-së?
Kur kanë dalë automobilat e 1982-së?
Ç'prodhim ka dalë vjet?

Dy provime të 1981-së do t'i bâj në mars të 1982-së.

A do të bâj dy provime të 1981-ës në mars të 1982-së?
Kush do të bâjë dy provime të 1981-ës në mars të 1982-së?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kur do t'i bâj dy provime të 1981-së?
Sa provime do të bâj në mars të 1982-së?

Frori i 1981-së ka pasë 28 ditë.

A ka pasë 28 ditë frori i 1981-së?
Sa ditë ka pasë frori i 1981-së?
Cili muej i 1981-së ka pasë 28 ditë?

1981-së do t'i apim fund me nji festë të bukur.

A do t'i apim fund 1981-së me nji festë të bukur?
Cilit vjet do t'i apim fund me nji festë të bukur?
Me çfarë feste do t'i apim fund 1981-së?

1980-ën e kam kalue tue punue.

A e kam kalue 1980-ën tue punue?
Kush e ka kalue 1980-ën tue punue?
Cilin vjet kam kalue tue punue?
Si e kam kalue 1980-ën?

Prej 1945-ës e deri në 1949 ai ka qenë n'Italí.

A ka qenë ai n'Italí prej 1945-ës deri në 1949?
Kush ka qenë n'Italí prej 1945-ës deri në 1949?
Kur ka qenë ai n'Italí?
Prej cilit vjet deri në cilin vjet ka qenë ai n'Italí?

3.

Vetëm nji e treta e klasës doli mirë në provim.

A doli mirë në provim vetëm nji e treta e klasës?
Cila pjesë e klasës doli mirë në provim?
Si doli në provim nji e treta e klasës?

Do t'a shikoj unë provimin e nji së tretës së klasës.

A do t'a shikoj unë provimin e nji së tretës së klasës?
Kush do t'a shikojë provimin e nji së tretës së klasës?
Provimin e cilës pjesë të klasës do të shikoj unë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Nji së tretës së klasës i dhanë leje të shkojë në shtëpí.

A i dhanë leje nji së tretës së klasës të shkojë në shtëpí?
Cilës pjesë të klasës i dhanë leje të shkojë në shtëpí?
Ku i dhanë leje nji së tretës së klasës të shkojë?

Nji të tretën e klasës e thirrën në mbrâmje.

A e thirrën në mbrâmje nji të tretën e klasës?
Cilën pjesë të klasës thirrën në mbrâmje?
Kur e thirrën nji të tretën e klasës?

Dy të tretat e shkollës janë ushtarë.

A janë ushtarë dy të tretat e shkollës?
Sa të treta të shkollës janë ushtarë?
Çka janë dy të tretat e shkollës?

Uniformat e dy të tretavet të nxânësvet nuk kanë ardhë ende.

A kanë ardhë uniformat e dy të tretavet të nxânësvet?
Uniformat e sa të tretavet të nxânësvet nuk kanë ardhë ende?
Uniformat e kujt s'kanë ardhë ende?

Dy të tretavet të shkollës u dhanë libra.

A u dhanë libra dy të tretavet të shkollës?
Sa të tretavet të shkollës u dhanë libra?
Çka u dhanë dy të tretavet të shkollës?
Cilëve u dhanë libra?

Dy të tretat e klasës i dërgova në shtëpí sepse ishin të sëmundë me grip.

A i dërgova në shtëpí dy të tretat e klasës sepse ishin të sëmundë?
Sa të treta të klasës dërgova në shtëpí?
Ku i dërgova dy të tretat e klasës?
Pse i dërgova në shtëpí dy të tretat e klasës?
Ç'kishin dy të tretat e klasës që i dërgova në shtëpí?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

S'i kam marrë ende detyrat e shtëpís prej dy të tretavet të klasës.

A i kam marrë detyrat e shtëpís prej dy të tretavet të klasës?
Kush s'i ka marrë ende detyrat e shtëpís prej dy të tretavet të klasës?
Prej sa të tretavet të klasës s'i kam marrë ende detyrat e shtëpís?
Çka s'kam marrë ende prej dy të tretavet të klasës?

4.

Nji shoku im ka ardhë me u-pá me jú.

A ka ardhë me u-pá me jú nji shoku im?
Kush ka ardhë me u-pá me jú?
Me kê ka ardhë me u-pá nji shoku im?
Nji shoku i kujt ka ardhë me u-pá me jú?

Kjo âsht shtëpija e nji shoku tim.

A âsht kjo shtëpija e nji shoku tim?
Shtëpija e kujt âsht kjo?
Cila âsht shtëpija e nji shoku tim?

Ky âsht kushrîni i nji shoku tim të ngushtë.

A âsht ky kushrîni i nji shoku tim të ngushtë?
Kushrîni i kujt âsht ky?
Cili âsht kushrîni i nji shoku tim të ngushtë?

Këto toka janë të nji miku tim.

A janë këto toka të nji miku tim?
Të kujt janë këto toka?
Cilat toka janë të nji miku tim?

I shkrova nji shoku tim n'Italí të më dërgojë nji palë këpucë.

A i shkrova nji shoku tim n'Italí të më dërgojë nji palë këpucë?
Kush i shkroi nji shoku të tij n'Italí t'i dërgojë nji palë këpucë?
Çka i shkrova nji shoku tim n'Italí të më dërgojë?
Kujt i shkrova n'Italí të më dërgojë nji palë këpucë?
Sa palë këpucë i shkrova nji shoku tim të më dërgojë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Nji shokun tim në Shqipní e kanë futë në burg për arsye politike.

A e kanë futë në burg nji shokun tim në Shqipní për arsye politike?
Kê kanë futë në burg në Shqipní për arsye politike?
Ç'i ka ngjá nji shoku tim në Shqipní?
Pse e kanë futë në burg nji shokun tim në Shqipní?

Jam në merak sepse s'kam marrë letër prej nji shoku tim të vjetër.

A jam në merak sepse s'kam marrë letër prej nji shokut tim të vjetër?
Kush âsht në merak sepse s'ka marrë letër prej nji shokut të tij të vjetër?
Pse jam në merak?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 65
PART II
DIALOGUE

Partija e Punës e Shqipnís

1. Kur âsht themelue partija komuniste në Shqipní?
2. Në nânduer të 1941-së, pesë muej mbasi Gjermanija naziste filloi invadimin e Bashkimit Sovjetik.

3. Shqipnija n'at kohë ishte e pushtueme nga Italija, apo jo?
4. Po, por qëllimi kryesor i partís nuk ishte çlirimi i vendit nga okupatori.

5. Në çka synonte partija n'at kohë?
6. Me marrë fuqín në dorë; në këtë drejtim ata filluen menjiherë punën për popullarizimin e ideologjís marksiste-leniniste.

7. A kanë pasë përkrahje nga populli?
8. Po, populli i përkrahu komunistët, sepse u-gënjye nga premtimet e tyne të shumta.

9. A ka pasë ndonji arsye tjetër?
10. Po, komunistët ishin t'organizuem me emnin "Lëvizja Nacional Çlirimtare" (LNÇ).

11. Çka do me thânë kjo?
12. Ky titull, thjesht nacionalist, i përqente popullit, sepse kujtonte se organizata ishte tue luftue okupatorin.

13. Si e ushtron Partija e Punës e Shqipnís veprimtarín e saj n'administrimin e vendit?
14. E ushtron me anë t'organizatavet të ndryshme, që janë degë të saja.

15. Cilat janë këto organizata?
16. Rinija e Punës e Shqipnís, Bashkimi i Gravet të Shqipnís dhe Bashkimet Profesionale.

17. A janë anëtarë partije përfaqësuesit e popullit në Kuvendin Popullor?
18. Po, janë, por njerzit mâ me rândësí të qeverís janë anëtarë të KQ të Partís ase të Byrosë Politike.

19. Cilat janë njisít e vogla të Partís, me të cilat Partija kontrollon vendin?
20. Organizatat-bazë të Partís; ato ndodhen në çdo qendër pune e prodhimi.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 65



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 65
PART II
DIALOGUE

Albania's Workers' Party

1. When was the Albanian Communist Party founded?
2. In November 1941, five months after Nazi Germany began the invasion of the Soviet Union.

3. Albania at that time was occupied by Italy, isn't that so?
4. Yes, but the primary aim of the Communists was not the liberation of the country from the occupiers.

5. What were the aims of the Party at that time?
6. To have the power in their hands; with this aim in mind, they began at once the popularization of Marxist-Leninist ideology.

7. Did they have the support of the population?
8. Yes, the people supported them because they were tricked by the many promises the Communists made.

9. Were there any other reasons?
10. Yes, the Communists were organized in the National Liberation Front (NLF).

11. What does this mean?
12. This title, purely nationalistic, pleased the people because they thought the NLF was fighting the enemy.

13. How does the Albanian Workers' Party exercise its authority in the administration of the country?
14. It exercises it through different organizations, which are its branches.

15. Which are these organizations?
16. Workers' Youth of Albania, Women's Union of Albania and the Trade Unions.

17. Are the representatives of the people in the People's Assembly party members?
18. Yes, they are, but the most important people in the government are members of the Central Committee of the Party or of the Politbureau.

19. What are the small units through which the Party controls the country?
20. The "base organizations" of the Party; they are located in each work and production center.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

LESSON 65
PART III
GRAMMAR ANALYSIS

1. SUBSTANTIVIZED NUMERALS

Cardinal numbers may be substantivized.

a. The following are feminine:

nji, njija (pl. missing)	the number one
dy, dyja (pl. missing)	the number two
tri, trija (pl. missing)	the number three
katër, katra katra, -t	the number four
dhetë, -a dheta, -t	the number ten

b. The following are masculine:

qind, -i qinda, -t	the number hundred
milion, -i miliona, -t	the number one million

c. The numbers nji, dy and tre may also be substantivized by attaching the suffix -sh and are then treated as masculine nouns.

Examples:

njish, -i njisha, -t	the number one
dysh, -i dysha, -t	the number two
tresh, -i tresha, -t	the number three

The above mentioned nouns have a high frequency of usage in mathematics and sports.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Examples:

Shkrueje njishin nën dysh.
(Write number one under the two.)

Njishi dhe dyshi ishin nota të këqija.
([Numbers] one and two were poor grades.)

Treshi (lojtari numër tre) doli i pari.
([The player] number three came out the first.)

2. THE INDEFINITE ARTICLE PRECEDING THE POSSESSIVE ADJECTIVE

The possessive adjective preceded by nji corresponds to the English "a ... of mine," and so on.

Examples:

Ka vdekë nji shoku im.
(A friend of mine passed away.)

Ky âsht automobili i nji kushrîni tim.
(This car belongs to a cousin of mine.)

Mbrâmë shkova në kinema me nji shokun tând.
(Last night I went to the movies with a friend of yours.)

Remark: In the direct object the form nji shokun tim, nji shokun tând," etc., can also be nji shok timin, nji shok tândin, and so on.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 65
PART IV
GRAMMAR DRILL

1. Numrat kur përdoren si emna dhe thyesat:

a. Sa âsht 1/4 e 20-ës?
1/4 e 20-ës âsht 5.

Sa âsht 1/3 e 30-ës?
1/3 e 30-ës âsht 10.

Sa âsht 1/5 e 10-ës?
1/5 e 10-ës âsht 2.

Sa âsht 1/6 e 30-ës?
1/6 e 30-ës âsht 5.

Kemi 10 lekë dhe apim huá 2.

Cilën pjesë kemi dhânë huá?
Kemi dhânë huá 1/5.

Sa pjesë na mbeten?
Na mbeten 4/5.

Na mbeten 4/5 e cilës shumë?
Na mbeten 4/5 e 10 lekëve.

Nji klasë ka 9 nxânës: 3 prej tyne janë në spital.

Cila pjesë e nxânësvet âsht në spital?
1/3 âsht në spital.

Cila pjesë e nxânësvet ka ardhë në shkollë?
2/3 e nxânësvet kanë ardhë në shkollë.

Vjet kemi pasë 12 nxânës: prej 3 nxânësve kemi marrë letra.

Prej cilës pjesë të nxânësvet kemi marrë letra?
Kemi marrë letra prej 1/4 së nxânësvet.

Prej cilës pjesë presim ende letra?
Presim letra prej 3/4 të nxânësvet.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Cila pjesë e nxânësvet na ka shkrue?
1/4 e nxânësvet na ka shkrue.

Cila pjesë e nxânësvet ka për të na shkrue?
3/4 e nxânësvet kanë për të na shkrue.

12 shokëve duhet t'u shkruej këtë javë; deri tash u kam shkrue vetëm 3 shokëve.

Cilës pjesë të shokëvet i kam shkrue?
I keni shkrue 1/4 së shokëvet.

Cilës pjesë duhet t'i shkruej këtë javë?
Këtë javë duhet t'u shkrueni 3/4 të shokëvet.

Nji shishe venë nxên 10 gota; unë pij 1 gotë në ditë.

Sa pjesë të venës pij unë çdo ditë?
Ju pini çdo ditë 1/10 e venës.

Sa pjesë të venës pij unë në 3 ditë?
Ju pini në 3 ditë 3/10 e venës.

Sa pjesë të venës pij unë në 9 ditë?
Ju pini në 9 ditë 9/10 e venës.

Dheta âsht nota mâ e mirë në shkollat shqiptare dhe pesa âsht nota mâ e ulët.

Cila âsht nota mâ e mirë në shkollat shqiptare?
Dheta âsht nota mâ e mirë në shkollat shqiptare.

Cila âsht nota mâ e mirë që vjen mbas dhetës?
Nânda âsht nota mâ e mirë që vjen mbas dhetës.

Cila âsht nota mâ e ulët në shkollat shqiptare?
Pesa âsht nota mâ e ulët në shkollat shqiptare.

A ka marrë Petriti sivjet dy shtata, tri teta dhe dy nânda?
Po, Petriti ka marrë sivjet dy shtata, tri teta dhe dy nânda.

A ka marrë Lulja sivjet nji shtatë, tri teta dhe tri nânda?
Po, Lulja ka marrë sivjet nji shtatë, tri teta dhe tri nânda.

Cili ka marrë nota mâ të mira sivjet: Petriti apo Lulja?
Lulja ka marrë sivjet nota mâ të mira se Petriti.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

b. Nxânsi le të përsërisi të njajtën fjalí që thotë mësuesi, por pa përdorë fjalën "vjet". P.sh.

Mësuesi: Shinat e vjetit 1980 qenë të nevojshme për bujqësín.

Nxânsi: Shinat e 1980-ës qenë të nevojshme për bujqësín.

Ju të gjithë i dini ngjarjet e vjetit 1980.
Ju të gjithë i dini ngjarjet e 1980-ës.

Tërmeti i vjetit 1905 âsht ndie në gjithë Ballkanin.
Tërmeti i 1905-ës âsht ndie në gjithë Ballkan.

Gjatë vjetit 1941 Evropa nuk u-bombardue shumë.
Gjatë 1941-së Evropa nuk u-bombardue shumë.

Në vjetin 1945 mori fund Lufta e Dytë Botënore.
Në 1945 mori fund Lufta e Dytë Botënore.

Prej vjetit 1960 deri në vjetin 1962 kam qenë n'Evropë.
Prej 1960-ës deri në 1962 kam qenë n'Evropë.

Ngjarjet e vjetit 1942 nuk do t'i harroj kurrë.
Ngjarjet e 1942-së nuk do t'i harroj kurrë.

Më duket se e kam takue aty nga vjeti 1930.
Më duket se e kam takue aty nga 1930-a.

2. Dje nji miku yt na ftoi për drekë.

Çka bâni nji miku yt?
Kur na ftoi nji miku yt për drekë?
Çka na ftoi dje nji miku yt të hamë?
Kê ftoi dje për drekë nji miku yt?

Sonte e kam thirrë për darkë edhe nji shokun tând.

Edhe kê kam thirrë sonte për darkë?
Kur e kam thirrë edhe nji shokun tând për darkë?
Pse e kam thirrë edhe nji shokun tând?
Kush e ka thirrë edhe nji shokun tând për darkë sonte?

Ata erdhën këtu me nji oficerin e tij.

Me cilin oficer erdhën ata këtu?
Kush erdhi këtu me nji oficerin e tij?
Ç'bânë ata?
Ku erdhën ata me nji oficerin e tij?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

LESSON 65
PART V
READING TEXT

Në nânduer të vjetit 1941, dy komunistë të huej të famshëm në komunizmin ndërkombëtár, ndihmuen n'organizimin e Partís Komuniste Shqiptare. Kjo ngjau pesë muej mbasi Gjermanija naziste filloi invadimin e Bashkimit Sovjetik; deri atëherë komunistëvet shqiptarë u pëlqente bashkimi i Gjermanís me Rusín, e cila, dy vjet mâ parë jo vetëm kishte pranue invadimin e Polonís nga Gjermanija, por kishte marrë për vete gati gjymsën e këtij shteti. Partija Komuniste n'at kohë ishte e organizueme mirë, por nuk kishte përkrahjen e popullit. Për të fitue këtë përkrahje komunistët filluen mos me përdorë mâ fjalën "komunist" dhe me 16 shtatuer 1942 themeluen Lëvizjen Nacional Çlirimtare (LNÇ).

Tue kujtue se kjo organizatë ishte tue luftue okupatorin, n'at kohë ushtrija italiane, populli i dha çdo përkrahje: e ndihmoi me të holla, i strehoi njerzit e saj, i dha djelmt. Qëllimi kryesor i LNÇ ishte me marrë fuqín në dorë dhe për këtë arsye ata filluen luftën kundër nacionalistëvet, të cilët, t'organizuem nga patriotë të vërtetë, ishin ç'prej kohe në luftë me okupatorët. Vllavrasja vetëm i shkaktoi popullit nja 6000 - 8000 të vramë.

Qeverija komuniste që doli nga partija u-përpoq, posa mori fuqín në dorë, t'a bâjë sa mâ të fortë pozitën e saj: vrau ase futi në burg të gjithë patriotët dhe

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

intelektualët e ndershëm; tregtarëvet u vûni taksa të rânda në mënyrë që mos t'ishin në gjendje t'i paguejshin dhe kështu i futi në burg.

Më 1948 Partija Komuniste Shqiptare mori emnin Partija e Punës e Shqipnís. Organi mâ i naltë i saj âsht Kongresi i Partís, i cili mblidhet çdo pesë vjet. Ky zgjedh Komitetin Qendror të Partís dhe kandidatët e KQ. Komiteti Qendror mblidhet çdo tre muej për t'i dhânë udhëzime Partís kur Kongresi i saj nuk âsht në sesion. Për të krye punët e përditshme dhe të vazhdueshme që ka mbi vete Partija, KQ ka nji grup 13 vetësh që quhet Byroja Politike dhe nji grup tjetër 4 vetësh për punën ekzekutive që quhet Sekretariat. Sekretari i Parë i këtij organi âsht kryetari i vërtetë i Partís, ai që ka fuqí të jashtëzakonshme mbi gjithë veprimtarín e qeverís. Organet mâ të vogla, me anën e të cilave ky ushtron fuqín e tij deri në qoshet mâ të largëta të vendit, janë Organizatat-bazë të Partís; ato gjinden kudo: ndër shkolla, ndër zyra, ndër qendra pune e prodhimi, kudo që ka dy vetë që jetojnë e punojnë së bashku.

Me urdhën të Partís së Punës edhe rinija, grát dhe punëtorët janë t'organizuem n'organizatat e tyne, që janë degë të saja. Ato janë: Rinija e Punës e Shqipnís, Bashkimi e Gravet të Shqipnís dhe Bashkimet Profesionale.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS-PYETJE

1. Në nânduer të vjetit 1941, sa komunistë të huej ndihmuen n'organizimin e Partís Komuniste Shqiptare?
2. Ku ishin të famshëm këta dy komunistë?
3. Kjo ngjau pesë muej mbasi Gjermanija filloi invadimin e cilit shtet?
4. Çka kishte pranue Rusija dy vjet mâ parë?
5. Deri atëherë, kujt i pëlqente bashkimi i Gjermanís me Rusín?
6. Invadimin e cilit shtet kishte pranue Rusija dy vjet mâ parë?
7. Përveç se kishte pranue invadimin e Polonís, çka tjetër kishte bâ Rusija?
8. Cila partí ishte e organizueme mirë?
9. Megjithëse ishte e organizueme mirë, çka nuk kishte Partija Komuniste Shqiptare?
10. Për të fitue përkrahjen e popullit, çka filluen me bâ komunistët?
11. Pse filluen komunistët mos me përdorë mâ fjalën "komunist"?
12. Cilën organizatë themeluen komunistët më 16 shtatuer 1942?
13. Kush kujtoi se Lëvizja Nacional Çlirimtare ishte tue luftue okupatorin?
14. Çka kujtoi populli?
15. Cili ishte okupator n'at kohë në Shqipní?
16. Kush i dha LNÇ çdo përkrahje?
17. Me çka e ndihmoi populli LNÇ?
18. Kê strehoi populli?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

19. Çka i dha populli LNÇ?

20. Cili ishte qëllimi kryesor i LNÇ?

21. Për të marrë fuqín në dorë, kundër kujt e filluen ata luftën?

22. Nga kush ishin t'organizuem nacionalistët?

23. Me kê ishin në luftë nacionalistët ç'prej kohe?

24. Sa mijë të vramë i shkaktoi popullit vllavrasja?

25. Cila qeverí u-përpoq t'a bâjë sa mâ të fortë pozitën e saj?

26. Çka u-përpoq të bâjë qeverija komuniste që doli nga partija?

27. Kê vrau ase futi në burg?

28. Kujt i vûni taksa të rânda?

29. Pse u vûni qeverija tregtarëvet taksa të rânda?

30. Dhe mâ në fund, çka u bâni qeverija tregtarëvet?

31. Çfarë emni mori Partija Komuniste Shqiptare më 1948?

32. Cili âsht organi mâ i naltë i Partís së Punës të Shqipnís?

33. Sa shpesh mblidhet Kongresi i Partís?

34. Kê zgjedh Kongresi i Partís?

35. Sa shpesh mblidhet KQ?

36. Pse mblidhet KQ çdo tre muej?

37. Cila organizatë ia ep udhëzimet Kongresit të Partis kur ky nuk âsht në sesion?

38. A ka Partija mbi vete punë të përditshme dhe të vazhdueshme?

39. Sa grupe njerzish ka KQ për të krye punët të përditshme?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

40. Si quhet grupi i përbâmë prej 13 vetësh?

41. Si quhet grupi tjetër i përbâmë prej 4 vetësh?

42. Për çfarë pune âsht Sekretariati?

43. Ç'titull ka njeriu që udhëheq Sekretariatin?

44. Kush âsht sot Sekretari i Parë?

45. A âsht Sekretari i Parë kryetari i vërtetë i Partís?

46. Mbi çka ka ky fuqí të jashtëzakonshme?

47. A janë Organizatat-bazë të Partís organet e saja mâ të vogla?

48. Me anën e cilave organe e ushtron fuqín e vet Sekretari i Parë?

49. Deri ku e ushtron Sekretari i Parë fuqín e vet?

50. Ku gjinden organizatat-bazë?

51. A kanë edhe rinija, grât dhe punëtorët organizatat e tyne?

52. Si quhet organizata e rinís?

53. Si quhet organizata e gravet?

54. Si quhet organizata e punëtorëvet?

55. Degë të cilës organizatë janë trí organizatat që përmendëm?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

LESSON 65
PART VI
HOMEWORK

A. Plotësoni fjalít që vijojnë:

1. Kam lexue mâ shumë se _____ (four-fifths of the book).

2. _____ (One-third of the people) që ishin mbrâmë në kinema ishin pa xhaketa.

3. Komunistët _____ (came to power) në nânduer _____ (of 1944).

4. Unë kam pasë _____ (my parents' support) deri sa mbarova shkollën.

5. Me _____ (promise) âsht gjâ e lehtë, por _____ (keep those promises) âsht gjâ tjetër.

B. Përkëtheni shqip këto fjalí:

6. When their school was founded, the citizens gave a large amount of money.

7. The purpose of his visit was to see their representative.

8. Some people believe that the number 13 brings bad luck, but some others do not think so.

9. All the youth in Albania are members of the "Workers' Youth Organization."

10. Although he is a close friend of mine, he almost never writes to me.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E SHTATË
FJALORI

LESSON 65
PART VII
VOCABULARY

administrim, -i	(m.)	administration, administering
anëtár, -i anëtarë, -t	(m.)	member
bashkim, -i bashkime, -t	(m.)	union, unity
Bashkimi Sovjetik		Soviet Union
bazë, -a baza, -t	(f.)	base, basis
byroja politike	(f.)	Politbureau (the executive committee of the central committee of a Communist Party)
çlirim, -i	(m.)	liberation
çlirimtár, -e	(adj. m. & f.)	liberation, liberating
me u-gënjye (unë gënjehem)	(v.)	to be deceived, cheated
ideologjí, -j ideologjí, -t	(f.)	ideology
invadim, -i invadime, -t	(m.)	invasion
komunist, -i komunistë, -t	(m.)	communist
kongres, -i kongrese, -t	(m.)	convention, congress
me krye (unë kryej)	(v.)	to finish, complete, accomplish, achieve
i, e, të largët të largëta	(adj. m. & f.)	remote, distant
me luftue (unë luftoj)	(v.)	to fight (in a war)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

marksist-leninist marksiste-leniniste	(adj. m. & f.)	Marxist-Leninist
nacionalist, -i nacionalistë, -t	(m.)	nationalist
nacional, -e	(adj. m. & f.	national
nacionalist, -e	(adj. m. & f.)	nationalistic, nationalist
nazist, -e	(adj. m. & f.)	Nazi
ndërkombëtar, -e ndërkombëtarë	(adj. m. & f.)	international
notë, -a nota, -t	(f.)	school grade; diplomatic note; musical note
okupator, -i okupatorë, -t	(m.)	conqueror, invader
organizatë, -a organizata, -t	(f.)	organization
organizim, -i organizime, -t	(m.)	organizing, organization
i, t'organizuem e, t'organizueme	(adj. m. & f.)	organized
patriot, -i patriotë, -t	(m.)	patriot
përfaqësues, -i përfaqësues, -it	(m.)	representative
pozitë, -a pozita, -t	(f.)	position
me përkrahë (unë përkrah)	(v.)	to support
përkrahje, -a	(f.)	support
popullarizim, -i	(m.)	popularization

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

premtim, -i premtime, -t	(m.)	promise
profesional, -e	(adj. m. & f.)	professional
i, të pushtuem e, të pushtueme	(adj. m. & f.)	occupied
qendror, -e	(adj. m. & f.)	central
qëllim, -i qëllime, -t	(m.)	goal, purpose; intention
rini, -ja	(f.)	youth
sovjetik, -e	(adj. m. & f.)	Soviet
me synue (unë synoj)	(v.)	to aim, have as a goal
me shkaktue (unë shkaktoj)	(v.)	to cause
shumë, -a shuma, -t	(f.)	sum, amount
me u-themelue (themelohet)	(v.)	to be founded
thjesht	(adv.)	pure, simple, simply
titull, -i tituj, -t	(m.)	title
thyesë, -a thyesa, -t	(f.)	fraction (math.)
me ushtrue (unë ushtroj)	(v.)	to exercise, train, drill, practice (a profession also); exert
vllavrasje, vllavrasja	(f.)	fratricide, civil war

Shënime:

me marrë fuqin në dorë — to seize power

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 66
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE — GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. Lidhorja në vend të kohës s'ardhme:

A shpresoj unë që fundi i tetorit të më gjêjë këtu?
Po, ti shpreson që fundi i tetorit të të gjêjë këtu.
Kush shpreson që fundi i tetorit t'a gjêjë këtu?
Ti shpreson që fundi i tetorit të të gjêjë këtu.
Çka shpresoj unë?
Ti shpreson që fundi i tetorit të të gjêjë këtu.

A jam unë gati të t'ap çdo gjâ që të më kërkojsh?
Po, ti je gati të m'apish çdo gjâ që të të kërkoj.
Kush âsht gati të t'api çdo gjâ që t'i kërkojsh?
Ti je gati të m'apish çdo gjâ që të të kërkoj.
Kujt jam gati t'i ap çdo gjâ që të më kërkojë?
Ti je gati të m'apish mue çdo gjâ që të të kërkoj.
Ç'jam gati të t'ap?
Ti je gati të m'apish çdo gjâ që të të kërkoj.

2. Lakimi i numrorëvet kur përdoren si fjalë më vete:

a. A janë të dy librat e mij mbi tryezë?
Po, të dy librat tuej janë mbi tryezë.
Ku janë të dy librat e mij?
Të dy librat tuej janë mbi tryezë.

<u>Dy shokët e mij kanë nga nji automobil.</u>

A janë automobilat e të dyve të rij?
Po, automobilat e të dyve janë të rij.
Si janë automobilat e të dyve?
Automobilat e të dyve janë të rij.
Automobilat e kujt janë të rij?
Automobilat e të dyve janë të rij.

<u>Dy prej shokëvet të mij u kam pasë borxh</u>.

A u a pagova borxhin të dyve?
Po, ti u a pagove borxhin të dyve.
Kujt ia pagova borxhin?
Ti u a pagove borxhin të dyve.
Ç'u pagova të dyve?
Ti u a pagove borxhin të dyve.
Cilëve u a pagova borxhin?
Ti u a pagove borxhin të dyve.
Kush u a pagoi borxhin të dyve?
Ti u a pagove borxhin të dyve.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Dje mora dy libra në bibliotekë.

A i harrova mbrâmë të dy në kinema?
Po, ti i harrove mbrâmë të dy në kinema.
Ku i harrova mbrâmë të dy?
Ti i harrove mbrâmë të dy në kinema.
Kush i harroi mbrâmë të dy në kinema?
Ti i harrove mbrâmë të dy në kinema.
Ç'harrova mbrâmë në kinema?
Ti i harrove mbrâmë të dy librat në kinema.
Sa libra harrova mbrâmë në kinema?
Ti i harrove mbrâmë të dy librat në kinema.

Të dy shokët e tú të kanë shkrue.

A ke marrë letër prej të dyve?
Po, kam marrë letër prej të dyve.
Ç'ke marrë prej të dyve?
Kam marrë prej të dyve letër.
Prej cilëve ke marrë letër?
Kam marrë letër prej të dyve.
Kush ka marrë letër prej të dyve?
Unë kam marrë letër prej të dyve.
Prej kujt ke marrë letër?
Kam marrë vetëm nji letër prej të dyve.

b. Në rrugën "Kashari" kam dy shtëpí.

A janë të dyja shtëpít në të njâjtën rrugë?
Po, të dyja janë në të njâjtën rrugë.
Në cilën rrugë janë të dyja shtëpít?
Të dyja janë në të njâjtën rrugë.
Në ç'vend janë të dyja shtëpít?
Të dyja shtëpít janë në të njâjtën rrugë.

Shtëpít e të dyja motravet të mija janë në plazhë.

A janë në plazhë shtëpít e të dyjave?
Po, shtëpít e të dyjave janë në plazhë.
Ku janë shtëpít e të dyjave?
Shtëpít e të dyjave janë në plazhë.
Shtëpít e kujt janë në plazhë?
Shtëpít e të dyja motravet tueja janë në plazhë.

Ti u thé të dyja motravet të tua që të blejnë nga nji çantë të ré.

A u thé të dyjave që të blejnë nga nji çantë të ré?
Po, u thash të dyjave që të blejnë nga nji çantë të ré.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ç'u thé të dyjave?
U thash të dyjave që të blejnë nga nji çantë të ré.
Cilave u thé që të blejnë nga nji çantë të ré?
U thash të dyja motravet të mija që të blejnë nga nji çantë të ré.
Ç'u thé të dyjave që të blejnë?
U thash të dyjave që të blejnë nga nji çantë të ré.

Unë i shoqnova të dyja shoqet e mija deri në plazhë.

A i shoqnuet të dyja deri në plazhë?
Po, i shoqnova të dyja deri në plazhë.
Kush i shoqnoi të dyja deri në plazhë?
Unë i shoqnova të dyja deri në plazhë.
Deri ku i shoqnuet të dyja?
Të dyja i shoqnova deri në plazhë.

Ai ka dy motra në Shqipní.

A ka marrë ai letër prej të dyjave?
Po, ai ka marrë letër prej të dyjave.
Prej sa motrave ka marrë ai letër?
Ai ka marrë letër prej të dyjave.

c. Tre vllaznit e mij kanë qenë të sëmundë këtë javë.

A do të dalin të tre nesër në punë?
Po, të tre do të dalin nesër në punë.
Sa prej vllazënvet të mij do të dalin nesër në punë?
Të tre do të dalin nesër në punë.
Ç'do të bâjnë nesër të tre?
Të tre do të dalin nesër në punë.
Kush do të dali nesër në punë?
Të tre do të dalin nesër në punë.

Unë kam trí motra.

A janë të trija të martueme?
Po, të trija janë të martueme.
Sa prej motravet të mija janë të martueme?
Të trija janë të martueme.

Katër prej shokëvet të mij do të shkojnë në Durrës për pushime.

A do të udhëtojnë të katër me aeroplan?
Po, të katër do të udhëtojnë me aeroplan.
Sa prej tyne do të udhëtojnë me aeroplan?
Të katër do të udhëtojnë me aeroplan.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Me se do të udhëtojnë të katër?
Të katër do të udhëtojnë me aeroplan.

Ai ka katër motra.

A dijnë të katra të këndojnë mirë?
Po, të katra dijnë të këndojnë mirë.
Sa prej tyne dijnë të këndojë mirë?
Të katra dijnë të këndojnë mirë.
Qysh dijnë të këndojnë të katra?
Të katra dijnë të këndojnë mirë.



Manastiri i Shën Naumit, Pogradec

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 66
PART II
DIALOGUE

Baza e ekonomís në RPS të Shqipnís

1. Cila âsht baza e ekonomís në RPS të Shqipnís?
2. Baza e ekonomís âsht prona socialiste; në Shqipní pothuej se çdo gjâ âsht shtetzue.

3. Dij se industrija, minierat dhe bankat janë shtetzue; çka tjetër kanë shtetzue?
4. Ujnat, pyjet, kullotat, mjetet e komunikacionit ajror, hekurudhor e detâr, ndërmarrjet ekonomike etj.

5. Po prona kooperativiste, ç'âsht?
6. Prona kooperativiste âsht nji formë tjetër e pronës socialiste mbi mjetet e prodhimit.

7. Sa lloje kooperativash hŷjnë në sistemin kooperativist?
8. Ka trí grupe kooperativash: kooperativat bujqësore, kooperativat e artizanatit dhe kooperativat e konsumit.

9. Cilat kooperativa përfshîjnë dy të fundit?
10. Kooperativat e artizanatit përfshîjnë kooperativat e prodhimit, si p.sh. kooperativat e veshmbathjes, ato të shërbimevet etj.

11. Po kooperativat e konsumit?
12. Në këto hŷjnë të gjitha ato kooperativa që merren me prodhimin dhe shpërndamjen e artikujvet ushqimorë.

13. Po tokat, a janë të gjitha pronë e kooperativavet bujqësore?
14. Po, përmbi 90% të tokavet, si edhe kafshët e veglat e punës janë pronë e kooperativavet bujqësore.

15. A nxjerr bujku fitime të mira nga kooperativa?
16. Atij shpeshherë nuk i del as me jetue; shteti vetëm ka përfitime nga sistemi kooperativist.

17. Ku bazohe ti kur e thue këtê?
18. Në rregulloren e organizimit të kooperativavet lexohet: prodhimi vjetor ndahet ndër anëtarë vetëm pasi të kenë shlye detyrimet.

19. Detyrimet vjetore ndaj shtetit?
20. Po, nji pjesë të madhe i a ep shtetit, mandej duhet të paguejë SMT-në, të mbajë invalidët, pleqt, jetimat, bursistat, çerdhet e ku t'a dij unë ...

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

21. Po prona vetjake, ç'âsht?

22. Simbas Kushtetutës së vjetit 1976 pronë vetjake quhen t'ardhunat nga puna dhe nga burime tjera të ligjshme, shtëpija e banimit dhe sende të tjera që shërbejnë për nevoja vetjake dhe familjare.



Ura e Mesit mbi Kir



Ura e Vezirit mbi lumin Drini i Bardhë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 66



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 66
PART II
DIALOGUE

The Basis of the Economy of the People's Socialist Republic of Albania

1. What is the economy of the People's Socialist Republic of Albania based on?
2. The basis of the economy is Socialist ownership; in Albania almost everything is nationalized.

3. I know that industry, mines, and banks are nationalized; what else is nationalized?
4. Water, forests, pastures, airlines, railroads, maritime fleet (lines) , economic enterprises, and so on.

5. What is cooperative ownership?
6. Cooperative ownership is another form of Socialist ownership of the means of production.

7. How many kinds of cooperatives are included in the cooperative system?
8. There are three kinds of cooperatives: agricultural cooperatives, trade cooperatives and consumers' cooperatives.

9. Which cooperatives are included in the last two mentioned?
10. The trade cooperatives encompass those of production, such as the clothing and footwear cooperatives, and those of public services, etc.

11. What about the consumers' cooperatives?
12. These are all the cooperatives that deal with the production and distribution of food articles.

13. What about arable land, does it all belong to the agricultural cooperatives?
14. Yes, over 90% of the arable land, as well as animals and tools, are the property of the agricultural cooperatives.

15. Does the farmer draw good profits from the cooperative?
16. Oftentimes he cannot even make his living; only the state draws profits from the cooperative system.

17. What is your basis for saying this?
18. We read in the organizational rules in cooperatives: "The annual production of the cooperative is divided among its members only after they have fulfilled their obligations."

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

19. Annual obligations towards the state?
20. Yes, a large part is given to the state, then the motor and tractor stations must be paid, the invalids, old people, orphans, scholarship holders, kindergartens and what not must be supported.

21. What is personal property?

22. According to the Constitution of 1976 personal property is called the income from work and from other legitimate sources, the dwelling, and other things that serve personal and family needs.



Ura e Ujmishtit mbi Drinin e Zí
(Lumë)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

1. THE INTERROGATIVE PRONOUN i sati?

The interrogative adjective sa? is used to ask a question related to quantity. To reply to sa? we use cardinal numbers.

Examples:

Sa libra keni ju?	How many books do you have?
Unë kam 1 (2, 5, 100 libër.	I have 1 (2, 5, 100) book(s).

The pronoun i sati? (e sata, të satët, and të satat) is formed from the pronoun sa? It is used to ask a question related to an order or succession of things. To reply to i sati? we use an ordinal number.

I sati dole në garën e 100 metërshit?	How did you finish in the the 100-meter dash?
Dola i dyti.	I finished second.
E sata u-klasifikue kjo pikturë?	How was this painting classified?
U-klasifikue e para.	It won first prize.
Të satët dolën në klasë Agimi e Petriti?	How were Agim and Petrit classified at the end of the year?
Agimi doli i treti dhe Petriti i fundit.	Agim was third in the class and Petrit was last.

2. CARDINAL NUMBERS DENOTING DEFINITE QUANTITY

To convey the idea of a definite quantity the particle të precedes the cardinal number; the noun that follows, if any, will be in the definite form.

Examples:

Unë kam folë me të dy.	I have spoken to both of them.
Të tre djelmt janë të martuem.	All three of the boys are married.
Të dyja vajzat janë të mijat.	Both girls are my daughters.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Unë kam katër vajza dhe të katra janë n'universitet.	I have four daughters and all four of them are in college.

Paradigms of the declension of të dy djelmt "both boys "and të dy "both of them":

Masculine

Nom.		të dy djelmt			të dy
Gen.	i, e, të	të dy djelmvet	i, e, të		të dyve
Dat.		të dy djelmvet			të dyve
Acc.		të dy djelmt			të dy
Abl.	prej	të dy djelmvet	prej		të dyve

Feminine

Nom.		të dyja vajzat			të dyja
Gen.	i, e, të	të dyja vajzavet	i, e, të		të dyjave
Dat.		të dyja vajzavet			të dyjave
Acc.		të dyja vajzat			të dyjave
Abl.	prej	të dyja vajzavet	prej		të dyjave

3. THE USE OF THE SUBJUNCTIVE INSTEAD OF THE FUTURE

The subjunctive is also used to substitute for the future, whenever we express readiness or desire to do something.

Examples:

Jam gati të ju ap çdo gjâ që të më kërkoni.
do të më kërkoni.
(I am willing to give you anything you ask of me.)

Shpresoj që fundi i dhetorit të më gjêjë këtu.
do të më gjêjë këtu.
(I hope the end of December will find me here.)

A keni shpresë të vîni me mue?
se do të vîni me mue?
(Do you hope that you will go with me?)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 66
PART IV
GRAMMAR DRILL

1. Përdorimi i lidhores në vend të kohës s'ardhme:

a. A do të pranoni çfarëdo pune që të gjêni?
Po, unë do të pranoj çfarëdo pune që të gjêj.

Kush do të pranojë çfarëdo pune që të gjêjë?
Unë do të pranoj çfarëdo pune që të gjêj.

Çfarë pune do të pranoni ju?
Unë do të pranoj çfarëdo pune që të gjêj.

A mund të vîjë mjeku në çdo orë që t'a thërras?
Po, mjeku mund të vîjë në orë që t'a thërrasish.

Kush mund të vîjë në çdo orë që t'a thërras?
Mjeku mund të vîjë në çdo orë që t'a thërrasish.

Në cilat orë mund të vîjë mjeku?
Mjeku mund të vîjë në çdo orë që t'a thërrasish.

A janë ata gati të kryejnë çdo detyrë që t'u caktoj?
Po, ata janë gati të kryejnë çdo detyrë që t'u caktojsh.

Kush âsht gati të kryejë çdo detyrë që t'i caktoj?
Ata janë gati të kryejnë çdo detyrë që t'u caktojsh.

Ç'janë ata gati të bâjnë?
Ata janë gati të kryejnë çdo detyrë që t'u caktoj unë.

Çfarë detyre janë ata gati të kryejnë?
Ata janë gati të kryejnë çdo detyrë që t'u caktojsh.

b. Nxânsit le të bâjnë pyetje nga fjalît që vijojnë:

Unë do të ju ftoj për drekë kur të marr rrogën.

Na do të largohemi prej këtu kur të mbarojmë kursin.

Agimi ka ndërmend me shkue në kinema posa të mbarojë letrën.

Na do t'i pyesim shokët kur t'i takojmë.

Due me qenë edhe unë aty kur t'a blejsh.

Ata kanë vendosë të mos shkojnë kur t'i ftojnë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

2. Përemni pyetës "i sati?".

a. Nxânsi le të bâjë pyetje me përemnin "i sati?".

Mësuesi: Vllai im doli i pari i klasës.
Nxânsi: I sati doli vllai juej?

Motra ime do të niset e para.
E sata do të niset motra juej?

Vllaznit e mij e mbaruen provimin të parët.
Të satët e mbaruen provimin vllaznit e tû?

Motrat e mija dolën të parat.
Të satat dolën motrat e tua?

Shoku im mrrîjti i treti në 1500 m.
I sati mrrîjti shoku juej në 1500 m.?

Drita mrrîjti e katërta në 100 m.
E sata mrrîjti Drita në 100 m.?

Shokët e mij mrrîjtën të parët me barkën e tyne.
Të satët mrrîjtën shokët tuej me barkën e tyne?

Motrat e mija u-klasifikuen të parat në 100 e 200 m.
Të satat u-klasifikuen motrat e tua në 100 e 200 m.?

Alushi u-klasifikue i katërti ndër 300 vetë.
I sati u-klasifikue Alushi ndër 300 vetë?

Alushin e klasifikuen të katërtin.
Të satin e klasifikuen Alushin?

Hana u-klasifikue e para në historí dhe e dyta në gjeografí.
E sata u-klasifikue Hana në historí dhe e sata në gjeografí?

Hanën e klasifikuen të parën.
Të satën e klasifikuen Hanën?

Zekiu mori çmimin e parë.
Të satin çmim mori Zekiu?

Petritin e takova sot për të tretën herë.
Për të satën herë e takove Petritin sot?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

b. Përgjigjuni këtyne pyetjeve:

E sata ditë e javës âsht e hânja?

E sata ditë e javës âsht e dielja?

E sata orë mësimi âsht kjo?

I sati fëmijë je ti në familjen tânde?

I sati muej i vjetit âsht prilli?

I sati muej i vjetit âsht tetori?

3. Nxânsi le të përdori vetëm numrorët si fjalë më vete:

Mësuesi: Unë fola me Hasanin dhe me Hysenin.
Nxânsi: Unë fola me të dy.

Unë u dhash të dy djelmvet të njâjtin kështill.
Unë u dhash të dyve të njâjtin kështill.

Të tre librat që bleva, janë shkrue sivjet.
Të tre janë shkrue sivjet.

Baba mori nji shtëpí me qirá për të katër vllaznit e mij.
Baba mori nji shtëpí me qirá për të katër.

Të pesë nxânësvet u kam thânë me ardhë.
Të pesëve u kam thânë me ardhë.

Prej të tre mësuesvet kam marrë letra.
Prej të treve kam marrë letra.

A u thé të katër shokëvet me ardhë mâ heret nesër?
A u thé të katërve me ardhë mâ heret nesër?

Si njâni ashtu edhe tjetri flasin shqip.
Të dy flasin shqip.

Si njânit ashtu edhe tjetrit i kam dërgue letër.
Të dyve u kam dërgue letër.

Të dyja motrat kanë shtëpí.
Të dyja kanë shtëpí.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Të trija motravet u kam dhânë punë të lehta.
Të trijave u kam dhânë punë të lehta.

I humba të trija pêndat.
I humba të trija.

Prej të dyja vajzavet kam marrë lajme të këqija.
Prej të dyjave kam marrë lajme të këqija.

Shtëpît e të dyja vajzavet janë në plazhë.
Shtëpît e të dyjave janë në plazhë.

Të trija dritoret janë hapët.
Të trija janë hapët.



Kisha e Thethit

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

LESSON 66
PART V
READING TEXT

Nji ndër qëllimet kryesore të luftës nacional çlirimtare në Shqipní, e thonë vetë komunistët, ishte që komunistët të merrshin fuqín në dorë dhe të krijojshin nji pushtet të rí. Menjiherë mbasi erdhën në fuqí, më 1945, qeverija e ré nxori ligjë që filluen t'i vênë bazat nji ekonomije së ré, ekonomís socialiste. Kështu, nji nga nji, industrija, minierat, bankat, mjetet e komunikacionit ajror, hekurudhor e detâr, të gjitha ndërmarrjet ekonomike e deri kullotat kaluen në duert e shtetit; me nji fjalë krijuen "pronën socialiste," e cila âsht baza ekonomike e pushtetit popullor në RPS të Shqipnís.

Në RPS të Shqipnís ka dy llloj pronash: pronë socialiste e pronë vetjake. Pronë private nuk ka. Le t'i shofim llojet dhe format e këtyne pronave simbas kuptimit që i ep secilës regjimi komunist.

Sektori mâ i rândësishëm i ekonomís popullore âsht sektori socialist, sepse ai âsht baza e ekonomís së shtetit në nji kohë kur po ndërtohet socializmi. Sektori socialist përfshîn: minierat, ujnat, pyjet, kullotat, mjetet e komunikacionit, postat, telefonat, bankat, ndërmarrjet ekonomike, nji pjesë të madhe të tokës bujqësore etj. Të gjitha këto përbâjnë "pronën socialiste"; kjo ndahet në pronë shtetnore dhe pronë kooperativiste. Në pronën e shtetit hŷjnë të gjitha mjetet e prodhimit që

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

thamë mâ nalt si edhe këto: ndërmarrjet bujqësore, radiostacionet, apartamentet, uzinat, fabrikat etj. Në pronën kooperativiste hŷjnë ato mjete dhe vegla prodhimi që janë pronë e nji grupi njerzish ase ndërmarrjesh. Ka shumë lloje kooperativash: kooperativat bujqësore, kooperativat e artizanatit dhe kooperativat e konsumit. Në kooperativat e artizanatit bâjnë pjesë rrobaqepsit, këpucëtarët etj., kurse në kooperativat e konsumit hŷjnë peshkatarët, fabrikat e vogla t'ushqimit etj.

Kooperativat bujqësore janë natyrisht mâ të rândësishmet, janë ato që i apin shtetit fitimet mâ të mira. Në rregulloren e këtyne kooperativave lexohet se kooperativa duhet të shlyejë së pari detyrimet që ka ndaj shtetit, të paguejë SMT-në për shërbimin që i ka bâ, të paguejë për mbajtjen e invalidëvet, të pleqvet, të jetimavet, të bursistavet, të çerdhevet dhe mâ në fund t'i ndajë fitimet ndër anëtarë, d.m.th. ndër bujq. Sa përqind të prodhimit vjetor duhet t'i api kooperativa shtetit si detyrim nuk dihet, sepse qeverija nuk e thotë, por dihet se bujku shqiptâr âsht aq i vorfën sa nuk i del me jetue nga prodhimet që merr nga kooperativa.

Pronë vetjake në RPS të Shqipnís janë: t'ardhunat nga puna dhe nga burime të tjera të ligjshme, shtëpija e banimit dhe sende të tjera që shërbejnë për plotësimin (supplement) e nevojavet materiale e kulturore vetjake e familjare.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS-PYETJE

1. A ishte nji ndër qëllimet kryesore të luftës nacional çlirimtare që komunistët të merrshin fuqín në dorë?
2. Cili ishte qëllimi kryesor i luftës nacional çlirimtare?
3. Çfarë pushteti do të krijojshin komunistët mbasi t'a merrshin fuqín në dorë?
4. Kur erdhi në fuqí qeverija e ré?
5. Çka nxori qeverija e ré menjiherë mbasi komunistët erdhën në fuqí?
6. Cilës ekonomí filluen t'i vênë bazat ligjët që nxori qeverija?
7. Në duert e kujt kaluen industrija, minierat e bankat?
8. Mjetet e cilit komunikacion kaluen gjithashtu në duert e shtetit?
9. Çka tjetër kaloi në duert e shtetit?
10. Me nji fjalë, cilën pronë krijuen komunistët?
11. Baza e cilit pushtet âsht prona socialiste?
12. Sa lloj pronash ka në RPS të Shqipnís?
13. A ka pronë private në Shqipní?
14. Cili sektor âsht sektori mâ i rândësishëm i ekonomís populllore?
15. Pse âsht sektori socialist mâ i rândësishmi?
16. Cilat pasuní përfshîhen në sektorin socialist?
17. Cilën pronë përbâjnë pasunít që përmendëm?
18. Në sa prona ndahet prona socialiste dhe cilat janë?
19. A hŷjnë në pronën shtetnore të gjitha mjetet e prodhimit që thamë mâ parë?
20. Çka tjetër përfshîhet në pronën shtetnore?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

21. Në cilën pronë hŷjnë ato mjete e vegla prodhimi që janë pronë e nji grupi njerëzish ase ndërmarrjesh?

22. Sa lloje kooperativash ka?

23. Cilat janë llojet e kooperativavet?

24. Në cilat kooperativa bâjnë pjesë rrobaqepsit, këpucë-tarët etj?

25. Në cilat kooperativa hŷjnë peshkatarët e fabrikat e vogla t'ushqimit?

26. Cilat kooperativa janë mâ të rândësishmet?

27. Çfarë fitimesh i apin shtetit kooperativat bujqësore?

28. Çka duhet të shlyejë kooperativa së pari?

29. Për çka duhet t'a paguejë SMT-në?

30. Për mbajtjen e kujt duhet të paguejë kooperativa?

31. Dhe mâ në fund, çka duhet të bâjë kooperativa me fitimet?

32. Sa përqind të prodhimit vjetor duhet t'i api kooperativa shtetit?

33. Pse nuk dihet sa përqind të prodhimit duhet t'i api shtetit?

34. Kush âsht i vorfën?

35. A i del me jetue bujkut shqiptâr me prodhimet që merr nga kooperativa?

36. Sa i vorfën âsht bujku shqiptár?

37. Si quhen t'ardhunat që merren nga puna?

38. Çka tjetër mbahet si pronë vetjake?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

LESSON 66
PART VI
HOMEWORK

Përshkrueni me pak radhë (100 fjalë mjaftojnë) si i kuptojmë na në SHBA pronën private.



Fron në Kishën Ortodokse të Korçës (skulpturë e shekullit XIX)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E SHTATË
FJALORI

LESSON 66
PART VII
VOCABULARY

t'ardhuna, -t	(f.)	income, revenue
artikull, -i artikuj, -t	(m.)	article
artizanat, -i artizanate, -t	(m.)	trade, craft
bankë, -a banka, -t	(f.)	bank; bench
me u-bazue (unë bazohem)	(v.)	to put on a base or basis, to rely upon, on
bujqësuer, bujqësore bujqësorë	(adj. m. & f.)	agricultural, farming
bursist, -i bursista, -t	(m.)	scholarship holder
çerdhe, çerdhja çerdhe, -t	(f.)	nest; nursery (for the care of children)
detår, -e detarë	(adj. m. & f.)	sea-, marine, maritime
detyrim, -i detyrime, -t	(m.)	obligation
ekonomí, -ja	(f.)	economy, economics
ekonomik, -e	(adj. m. & f.)	economic, economical
fitim, -i fitime, -t	(m.)	gain, earnings, winning
hekurudhor, -e	(adj. m. & f.)	railroad-
invalid, -i invalidë, -t	(m.)	invalid
jetim, -i jetima, -t	(m.)	orphan
komunikacion, -i komunikacione, -t	(m.)	communications

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

konsum, -i	(m.)	consumption
kooperativë, -a kooperativa, -t	(f.)	co-operative
kooperativist, -e	(adj. m. & f.)	co-operative
me krijue (unë krijoj)	(v.)	to create
kulturor, -e	(adj. m. & f.)	cultural
kullotë, -a kullota, -t	(f.)	pasture
me u-kuptue (unë kuptohem)	(v.)	to be understood, to understand each other
kursim, -i kursime, -t	(m.)	saving(s)
me u-lexue (lexohet)	(v.)	to be read
i, të ligjshëm e, të ligjshme	(adj. m. & f.)	legitimate, legal
minierë, -a miniera, -t	(f.)	mine (ore deposit)
me u-ndá (unë ndahem)	(v.)	to be distributed, shared, split; divided, separated
ndaj	(prep.)	toward
ndërmarrje, -a ndërmarrje, -t	(f.)	enterprise, under-taking
pasi	(conj.)	after; since
me përbâ (unë përbâj)	(v.)	to form, make up, consist of
përfitim, -i përfitime, -t	(m.)	profit
i, e, të rrallë të rralla	(adj. m. & f.)	rare

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

i sati, e sata të satët, të satat	(pron. m. & f.)	which (in numerical order)
sistem, -i sisteme, -t	(m.)	system
socialist, -e socialistë	(adj. m. & f.)	socialist, socialistic
shoqnuer, shoqnore shoqnorë	(adj. m. & f.)	social
shpërndamje, -a	(f.)	distribution; dispersion
shprehje, -a shprehje, -t	(f.)	expression
me shtetzue (unë shtetzoj)	(v.)	to nationalize
me u-shtetzue (shtetzohet)	(v.)	to be nationalized
ushqimuer, ushqimore ushqimorë	(adj. m. & f.)	food-
vetjak, -e	(adj. m. & f.)	personal

Shënime:

... e ku t'a dij unë, ku t'a dij unë	...and what not, how should I know?
SMT (Stacion makinash e traktorësh)	machine and tractor station

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 67

PJESA E PARË — PART I

USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE — GRAMMAR PERCEPTION DRILL

Na vishemi në mëngjes dhe xhvishemi në mbrâmje.

Kur vishemi na?
Na vishemi në mëngjes.

Çka bâjmë na në mëngjes?
Në mëngjes na vishemi.

Kur xhvishemi na?
Na xhvishemi në mbrâmje.

Çka bâjmë na në mbrâmje?
Na xhvishemi në mbrâmje.

Çka bâjmë në mëngjes dhe çka bâjmë në mbrâmje?
Në mëngjes na vishemi dhe në mbrâmje xhvishemi.

Kur lodhemi kemi nevojë me u-çlodhë.

Çka kemi nevojë me bâ kur lodhemi?
Kur lodhemi kemi nevojë me u-çlodhë.

Kur kemi nevojë me u-çlodhë?
Na kemi nevojë me u-çlodhë kur lodhemi.

A duhet t'a fillojmë punën përsërí mbasi të çlodhemi?
Po, mbasi të çlodhemi duhet t'a fillojmë punën përsërí.

Na e rregulluem dhomën, por erdhën fëmijët dhe e çrregulluen.

Kush e rregulloi dhomën?
Na e rregulluem dhomën.

Çka bâmë na?
Na e rregulluem dhomën.

Çka rregulluem na?
Na e rregulluem dhomën.

Kush e çrregulloi dhomën?
Fëmijët e çrregulluen dhomën.

Çka bânë fëmijët?
Fëmijët e çrregulluen dhomën.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Mbasi të bâhet, puna e keqe nuk zhbâhet mâ.

Çka nuk zhbâhet, mbasi të bâhet?
Puna e keqe nuk zhbâhet mbasi të bâhet.

Kur nuk zhbâhet puna e keqe?
Puna e keqe nuk zhbâhet mbasi të bâhet.

Në drekë u-dukën ré të zeza, por n'orën dy u-zhdukën.

Çfarë résh u-dukën në drekë?
Në drekë u-dukën ré të zeza.

Kur u-dukën ré të zeza?
Në drekë u-dukën ré të zeza.

Kur u-zhdukën rét e zeza?
N'orën dy u-zhdukën rét e zeza.

Çfarë résh u-zhdukën n'orën dy?
Rét e zeza u-zhdukën n'orën dy.

Cilat ré u-zhdukën n'orën dy?
Rét e zeza u-zhdukën n'orën dy.

Gjyshi i merr fëmijët për dore posa ata fillojnë me ecë.

Kush i merr fëmijët për dore?
Gjyshi i merr fëmijët për dore.

Çka bân gjyshi?
Gjyshi i merr fëmijët për dore.

Kë merr gjyshi për dore?
Gjyshi i merr fëmijët për dore.

Kur i merr gjyshi fëmijët për dore?
Gjyshi i merr fëmijët për dore posa ata fillojnë me ecë.

Infermieri e mori të sëmundin për krahu dhe e çoi në dhomë.

Kush e mori të sëmundin për krahu?
Infermieri e mori të sëmundin për krahu.

Kë mori infermieri për krahu?
Infermieri e mori të sëmundin për krahu.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Qysh e mori të sëmundin infermieri?
Infermieri e mori të sëmundin për krahu.

Ku e çoi ai të sëmundin tue e mbajtë për krahu?
Tue e mbajtë për krahu ai e çoi të sëmundin në dhomë.

Petriti e tërhoqi qenin për bishti.

Kush e tërhoqi qenin për bishti?
Petriti e tërhoqi qenin për bishti.

Çka bâni Petriti?
Petriti e tërhoqi qenin për bishti.

Çka tërhoqi Petriti për bishti?
Petriti e tërhoqi qenin për bishti.

Qysh e tërhoqi Petriti qenin?
Petriti e tërhoqi qenin për bishti.

Dy vajza u-zûnë dhe e kapën njâna-tjetrën për flokësh.

Kë kapën për flokësh dy vajza?
Dy vajza e kapën për flokësh njâna-tjetrën.

Çka bânë dy vajza?
Dy vajza u-zûnë dhe e kapën njâna-tjetrën për flokësh.

Qysh e kapën dy vajza njâna-tjetrën?
Dy vajza e kapën njâna-tjetrën për flokësh.

Pse e kapën dy vajza njâna-tjetrën për flokësh?
Dy vajza e kapën njâna-tjetrën për flokësh sepse u-zûnë.

Qeni e kapi Petritin për pantallonash.

Çka bâni qeni?
Qeni e kapi Petritin për pantallonash.

Kë kapi qeni për pantallonash?
Qeni e kapi Petritin për pantallonash.

Çka i bâni qeni Petritit?
Qeni e kapi Petritin për pantallonash.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ku e kapi Petritin qeni?
Qeni e kapi Petritin për pantallonash.

Polici e lidhi vjedhësin për duersh e për kâmbësh.

Kush e lidhi vjedhësin për duersh e për kâmbësh?
Polici e lidhi vjedhësin për duersh e për kâmbësh.

Kë lidhi polici për duersh e për kâmbësh?
Polici e lidhi vjedhësin për duersh e për kâmbësh.

Në çfarë mënyre e lidhi polici vjedhësin?
Polici e lidhi vjedhësin për duersh e për kâmbësh.

Gjoleka u-vrá dhe i rrodhi gjak për hundësh e për goje.

Çka i rrodhi Gjolekës për hundësh e për goje?
Gjolekës i rrodhi gjak për hundësh e për goje.

Kujt i rrodhi gjak për hundësh e për goje?
Gjolekës i rrodhi gjak për hundësh e për goje.

Nga cilat pjesë të trupit i rrodhi gjak Gjolekës?
Gjolekës i rrodhi gjak për hundësh e për goje.

Përdorimi i ndajfoljes "mos"

a. Në fjalí pyetëse:

Mësuesi: Më duket se ju jeni vllai i Tefikut.
Nxânsi: A mos jeni ju vllai i Tefikut?

Unë dishroj që Hasani të ketë fjetë ke ju.
A mos ka fjetë Hasani ke ju?

Ndoshta ju e dini kur këthehet drejtori.
A mos e dini kur këthehet drejtori?

Na jemi takue diku; më duket se po.
A mos jemi takue ndokund?

Pendën e kam humbë, por shpresoj të ju a kem dhânë jú.
A mos ju a kam dhânë jú pendën?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Shpresoj të vîjë sonte, por nuk e dij a vjen.
A mos do të vîjë sonte?

Më duket se Halimi ka pasë dje nji aksident: shpresoj se jo.
A mos ka pasë Halimi nji aksident dje?

Shpresoj që ti të dijsh gjermanisht.
A mos di gjermanisht ti?

Më duket se fola me jú dje.
A mos fola me jú dje?

b. Në fjalí që shprehin frikë:

Mësuesi: Ndoshta e kanë arrestue.
Nxânsi: Kam frikë se mos e kanë arrestue.

Më duket se e kam humbë sahatin.
Kam frikë se mos e kam humbë sahatin.

Nesër do të bjerë shí, për fat të keq.
Kam frikë se mos do të bjerë shí nesër.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 67
PART II
DIALOGUE

PJESA E DYTË
DIALOGU

Marrëdhâniet diplomatike dhe tregtare të RPS të Shqipnís

1. A ka Shqipnija marrëdhânie diplomatike me Shtetet e Bashkueme t'Amerikës?
2. Jo, as me SHBA as me Britanín e Madhe, qysh nga nândori i 1946-ës.

3. Ç'gradë kishte përfaqësuesi diplomatik i SHBA më 1946, ambasador apo konsull?
4. As konsull as ambasador; SHBA përfaqësoheshin nga nji mision në krye të të cilit ishte nji kryetár.

5. Po para Luftës së Dytë, ambasadë kishte atje?
6. Jo. Përfaqësuesi amerikan në Tiranë ishte ministër fuqiplotë.

7. Me cilat shtete bân tregtí Shqipnija sot?
8. Me vendet përtej perdes së hekurt dhe me disa nga shtetet prendimore.

9. Ç'eksporton Shqipnija?
10. Mâ shumë se çdo gjâ tjetër eksporton prodhime të nëntokës, në radhë të parë vojgur, bakër e krom.

11. Ku ndodhen zonat vojgurore mâ me rândësí?
12. Rreth Beratit. Puset e vojgurit mâ me rândësí janë të përqëndrueme rreth Kuçovës, që sot quhet Qyteti Stalin.

13. Ç'tjetër eksporton përveç prodhimevet të nëntokës?
14. Lëkura, lesh, duhan, dërrasa e fruta; këto janë disa nga artikujt që eksporton Shqipnija.

15. Firma dhe shoqní private janë ato që bâjnë tregtí me vendet e hueja?
16. Jo. Tregtija, qoftë e mbrendshme ose e jashtme, âsht monopol i shtetit dhe bâhet nga Ministrija përkatëse e Tregtís, d.m.th. nga ajo e Jashtme dhe nga ajo e Mbrendshme.

17. Sa âsht rroga mesatare e nji punëtori në Shqipní?
18. Nji punëtor i pakualifikuem në sektorin e bujqësís ka nji mëditje prej 12 lekësh; në sektorin e industrís fiton pak mâ shumë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

19. Po nji punëtor i kualifikuem?
20. Nji punëtor i kualifikuem ose nji nëpunës i ndërmarrjeve të ndryshme shtetnore paguhet 15-22 lekë në ditë.

21. Ç'fuqí blese ka kjo shumë?
22. Me 15 lekë ai blen 6 kg. miell ose nji kilogram e gjymës sheqer.

23. Sa thyhet dollari në Shqipní?
24. Në çek banka e thyen dollarin me 15 lekë; turistëvet u a thyen me 25.



Dajlani i Bunës

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 67



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 67
PART II
DIALOGUE

Diplomatic and Trade Relations of the People's Socialist Republic of Albania

1. Does Albania have diplomatic relations with the U.S.A.?
2. No, neither with the U.S.A. nor with Great Britain since November 1946.

3. What was the rank of the U.S. diplomatic representative, ambassador or consul?
4. Neither consul nor ambassador; the U.S. was represented by a mission headed by its chief.

5. What about before the Second World War; was a U.S. embassy there?
6. No. The American representative was a plenipotentiary minister.

7. Which nations does Albania trade with now?
8. With the countries behind the Iron Curtain and with some of the Western nations.

9. What does Albania export?
10. More than anything else minerals, primarily oil, copper and chrome.

11. Where are the most important oil fields located?
12. Around Berat. The most important oil wells are concentrated in Kuçovë which today is called Stalin City.

13. What else, besides minerals, does Albania export?
14. Hides, wool, tobacco, wood and fruits; these are some of the articles that Albania exports.

15. Are these private companies and firms that handle Albania's foreign trade?
16. No. Trade, be it domestic or foreign, is a state monopoly and is handled by the appropriate Ministry of Trade, be that Foreign or Internal (Trade).

17. What is the average salary of a laborer (worker) in Albania?
18. An unskilled (unqualified) agricultural worker earns 12 leks a day; in industry he earns a little more.

19. What about a skilled (qualified) worker?
A skilled (qualified) worker or an employee of one of the various state enterprises is paid 15-22 leks a day.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

21. What is the buying power of this amount?
22. With 15 leks, one buys 6 kg of flour or 1.5 kg of sugar.

23. What is the rate of exchange of a dollar in Albania.
24. In the bank one dollar is 15 leks; there is also another exchange rate for tourists -- one dollar is 25 leks.



Asht koha me mbushë ujë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

1. VERBAL PREFIXES

a. The verbal prefix ç- and its variant sh- usually negate the action expressed by the basic verb.

Examples:

me u-lodhë (to get tired)	me u-çlodhë, u-shlodhë (to rest)
me armatosë (to arm)	me çarmatosë (to disarm)
me qetsue (to calm down)	me shqetsue (to disturb)

Remarks: When the verb begins with the consonant b or d, the prefix zh is used to signify the contrariety of the basic ation. The consonent v takes the prefix xh or zh.

Examples:

me veshë (to dress)	me u-xhveshë (to undress)
me u-dukë (to appear)	me u-zhdukë (to disappear)
me bâ (to do)	me zhbâ (to undo)

b. The same prefixes sh- and ç-, in many cases, function as intensifiers; they reinforce the idea of the basic verb.

Examples:

me lirue (to free)	me çlirue (to liberate)
me përndá (to distribute)	me shpërndá (to distribute)
me pague (to pay)	me shpague (to pay back)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

c. The prefix <u>për-</u> also is used to reinforce the meaning of the basic verb, but the meaning of the derived verb is considerably altered and must be learned as a new vocabulary item.

Examples:

me hapë (to open)	me përhapë (to divulge, spread)
me këthye (to turn, turn into)	me përkëthye (to translate)
me caktue (to assign)	me përcaktue (to define)
me bâ (to make)	me përbâ (to form, consist of)

d. The prefixes <u>n-</u>, <u>s-</u> and <u>z-</u> are sometimes attached to adjectives or nouns to form verbs.

Examples:

i gjallë (alive)	me ngjallë (to revive)
i kuq (red)	me skuqë (to redden)
i bukur (beautiful)	me zbukurue (to beautify, decorate)
dritë (light)	me ndriçue (to enlighten, illuminate)

2. THE PREPOSTION <u>për</u>

We have seen so far that the preposition <u>për</u> governs the accusative. This preposition may also govern the ablative; in such a case, most of the time it is translated into English with "by."

Examples:

me kapë dikê	për dore	to grab someone by the hand
	për krahu	by the arm
	për flokësh	by the hair
	për xhakete	by the jacket,
	etj.	etc.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me lidhë dikê	për duersh	to tie somebody's hands,
	për kambësh	feet,
	etj.	etc.
me tërheqë dikê	për veshi	to pull someone by the ear
	për kambësh	by the feet
	për hundësh	to lead someone by the nose,
	etj.	etc.

3. THE PARTICLE mos

As was explained in the Grammar Analysis of Lesson 36, the negative particle mos is used with the imperative, subjunctive, optative, and the infinitive modes. Here we want to add that when mos is used with the subjunctive there is a tendency to split this form of the verb. Instead of mos preceding it (the verb), it usually goes between the particle të and the main form of the verb. This shift of position has occurred for phonetic reasons only.

Example:

I thashë të mos shkojë instead of:
I thashë mos të shkojë (I told him/her not to go), and many other examples.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 67
PART IV
GRAMMAR DRILL

1. Përdorimi i pjesëzës "mos"

a. Në fjalí pyetëse që tregojnë dyshim, çudí ase dëshirë:

Mësuesi: A e di ti vallë, kush e ka marrë librin tim?
Nxânsi: A mos e di ti, kush e ka marrë librin tim?

A mendon ti se ai âsht zemrue me mue?
A mos âsht zemrue ai me mue?

Më duket se ti e ke njoftë babën tim, apo jo?
A mos e ke njoftë ti babën tim?

A e ke pá vallë kapelën time?
A mos e ke pâ kapelën time?

Kujtoj se ju m'a keni bâ këtë pyetje edhe nji herë tjetër.
A mos m'a keni bâ këtë pyetje edhe nji herë tjetër?

Vallë, a do të kemi shtesë rroge sivjet?
A mos do të kemi shtesë rroge sivjet?

Dikush ka qenë këtu mbrâmë; kam dyshim se ke qenë ti.
A mos ke qenë ti këtu mbrâmë?

Vallë, a e ka marrë Agimi fjalorin tim?
A mos e ka marrë Agimi fjalorin tim?

Vallë, a e ka gjetë ndokush prej jush fjalorin tim?
A mos e ka gjetë ndokush prej jush fjalorin tim?

A e di ti vallë ku ka shkue Agimi?
A mos e di ti ku ka shkue Agimi?

A bân të ftofët atje, vallë?
A mos bân të ftofët atje?

b. Në fjalí që tregojnë frikë:

Mësuesi: Kam frikë se do të ftofet djali.
Nxânsi: Kam frikë se mos ftofet djali.

Kam frikë se do të zemrohet.
Kam frikë se mos zemrohet.

Ai ka frikë se do të bjerë shí nesër.
Ai ka frikë se mos bie shí nesër.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ndoshta e kanë arrestue. Sa keq!
Kam frikë se mos e kanë arrestue.

Ata kanë frikë se do të mbesin në klasë.
Ata kanë frikë se mos mbesin në klasë.

Unë kam frikë se ata e dijnë.
Unë kam frikë se mos e dijnë.

Ai ka frikë se do të vîjë baba.
Ai ka frikë se mos vjen baba.

Na kemi frikë se do të bâjë të ftofët.
Na kemi frikë se mos bân të ftofët.

c. Me urdhënore, lidhore e infinitiv (përsëritje e mësimevet të kalueme):

Mësuesi: Shkrueni!
Nxânsi: Mos shkrueni!

Shkrueje me laps!
Mos e shkruej me laps!

Shko me fjetë!
Mos shko me fjetë!

Rrini këtu!
Mos rrini këtu!

Merre librin!
Mos e merr librin!

Lahuni me ujë të nxehtë!
Mos u-lani me ujë të nxehtë!

Vehuni në rresht!
Mos u-vêni në rresht!

Agimi të rrijë këtu!
Agimi të mos rrijë!

A i thé Agimit të më telefonojë?
A i thé Agimi mos të më telefonojë?

Ai më tha të shkoj heret.
Ai më tha të mos shkoj heret.

Unë dishroj të vîj me jú.
Unë dishroj të mos vîj me jú.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kam vendosë me u-zgjue heret nesër.
Kam vendosë mos me u-zgjue heret nesër.

Ai më ka thânë me folë me jú.
Ai më ka thânë mos me folë me jú.

Ai flet si me qenë i rí.
Ai flet si mos me qenë i rí.

2. Parashtesat mohuese

a. sh-

Na e kemi frŷ topin mbrâmë.

Kush e ka frŷ topin mbrâmë?
Çka kemi frŷ mbrâmë?

Na e kemi shfrŷ topin sot?

Kush e ka shfrŷ topin sot?
Çka kemi shfrŷ sot?
Kur e kemi shfrŷ topin?

Punët e mira e nderojnë njeriun.

Cilat punë e nderojnë njeriun?
Kê nderojnë punët e mira?
Çka i bâjnë punët e mira njeriut?

Punët e këqija e shnderojnë (çnderojnë) njeriun.

Cilat punë e shnderojnë (çnderojnë) njeriun?
Kê shnderojnë (çnderojnë) punët e këqija?
Çka i bâjnë njeriut punët e këqija?

b. ç-

Punët e mija i rregulloj unë vetë.

Kush i rregullon punët tueja?
Cilat punë rregulloni ju vetë?

Dikush m'a ka çrregullue mbrâmë zyrën.

Kush m'a ka çrregullue zyrën?
Çka më ka çrregullue dikush?
Çka i ka bâ dikush zyrës sime?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kapiten Selmani e ka organizue mirë njisín e tij.

Kush e ka organizue mirë njisín e tij?
Cilën njisí ka organizue mirë Kapiten Selmani?
Si e ka organizue njisín e tij Kapiten Selmani?

Komunistët e kanë çorganizue ekonomín e vendit.

Kush e ka çorganizue ekonomín e vendit?
Cilën ekonomí kanë çorganizue komunistët?
Çka i kanë bâ komunistët ekonomís së vendit?

3. Parafjala "për" me ablativ (rrjedhore)

Agimi e kapi shokun e tij për kambe.

kravatë:	Agimi e kapi shokun e tij për	kravate.
dorë	"	dore.
xhaketë	"	xhakete.
flokë	"	flokësh.
pantallona	"	pantallonash.
krah	"	krahu.
vesh	"	veshi.

Mos e tërhiqni djalin për flokësh!

xhaketë	Mos e tërhiqni djalin për	xhakete!
vesh	"	veshi.
krah	"	krahu.
kambë	"	kambe.
dorë	"	dore.

U-përpoqa me e mbajtë për krahu, por më shpëtoi.

xhaketë	U-përpoqa me e mbajtë për	xhakete, por më shpëtoi.
krah	"	krahu, "
flokë	"	flokësh, "
kambë	"	kambe "
pantallona	"	pantallonash, por më shpëtoi.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

LESSON 67
PART V
READING TEXT

Mbas ardhjes në fuqí të komunistëvet, në nânduer të vjetit 1944, qeverija e tyne e parë kërkoi që të njifet nga shtetet prendimore. Shtetet e Bashkueme t'Amerikës dërguen në Shqipní nji mision për të pá se ç'po ngjante atje dhe ç'punë po zhvillonte Fronti Demokratik. Ky ishte emni i rí i organizatës "Lëvizja Nacional Çlirimtare," mbrapa të cilit fshehesh partija komuniste. Edhe Anglija bâni të njâjtën gjâ. Hapat e parë pra drejt vendosjes së marrëdhânievet diplomatike ndërmjet këtyne vendeve ishin bâ, por gjatë vjetit 1946 marrëdhâniet ndërmjet Shqipnís dhe Shtetevet të Bashkueme u-keqsuen për këto arsye: vendet prendimore nuk pranuen me dorëzue refugjatët politikë që ishin strehue n'Europë, e sidomos n'Italí e Greqí; ca prej anëtarëvet të misionit amerikan e anglez u-nxorën jashtë nga Shqipnija, tjerët s'mund të dilshin nga kryeqyteti pa leje; puna e njerëzvet të UNRRA-s u-bâ e pamundun nga vështirësít që u shkaktonte qeverija. Por arsyeja mâ e madhe ka qenë se qeverija shqiptare nuk kërkoi kurrë vendosjen e marrëdhânievet diplomatike me Shtetet e Bashkueme, kurse këto të fundit e kishin kërkue disa herë. Përveç këtyne, radiostacioni i Tiranës dhe gazeta "Zëri i popullit," organ i KQ të PPSH, filluen të përdorin nji gjuhë shumë të keqe kundër qeverís së SHBA dhe politikës së saj. Në

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

nji atmosferë të tillë anmiqsore, më 5 nânduer 1946, Ministri i Jashtëm i Amerikës urdhënoi tërheqjen e misionit amerikan nga Shqipnija. Deri sot s'janë bâ hapa tjerë për vendosjen e marrëdhânievet diplomatike.

Tregtín RPS e Shqipnís e bân me të gjitha vendet përtej perdes së hekurt, në radhë të parë me Çekoslovakín, me Gjermanín Lindore, me Hungarín dhe Rumanín. Nuk duhet harrue se Shqipnija nuk ka marrëdhânie diplomatike ase tregtare me Bashkimin Sovjetik; këto dy shtete u-prishën në vjetin 1961, dhe deri në këtë datë 42% e tregtís së Shqipnís bâhesh me Bashkimin Sovjetik. Mallnat mâ me rândësí që Shqipnija eksporton në këto vende përtej perdes së hekurt janë: prodhimet e nëntokës si vojgur, bakër e krom, dhe artikuj tjerë si lëkura (sidomos dhelpnash, e kafshësh tjera t'egra), lesh, pambuk, duhan, ullîj, dërrasa e fruta.

Tregtija me vendet e lira të Prendimit âsht relativisht e vogël; pjesa mâ e madhe e kësaj tregtije bâhet me Italín. Qeverija komuniste shqiptare asnji herë nuk ka dhânë informata rreth valutës me të cilën paguhen mallnat që importohen nga vendet e hueja. Dihet se në marrëdhâniet tregtare ndërkombëtare leku nuk pranohet; me vendet prendimore çmimet caktohen në dollarë, kurse me vendet e demokracís popullore ndoshta me valutën e atyne vendeve ase edhe me dollarë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS-PYETJE

1. Nga cilat shtete kërkoi që të njifet qeverija e parë komuniste?
2. Çka kërkoi qeverija e parë komuniste?
3. Kur kërkoi qeverija e parë komuniste që të njifet nga shtetet prendimore?
4. Me ç'datë erdhën komunistët në fuqí?
5. Çka dërguen Shtetet e Bashkueme në Shqipní?
6. Pse e dërguen at mision Shtetet e Bashkueme në Shqipní?
7. Cili ishte emni i rí i Lëvizjes Nacional Çlirimtare?
8. Cila organizatë fshehesh mbrapa Frontit Demokratik?
9. Cili shtet tjetër bâni të njâjtën gjâ, d.m.th. dërgoi mision?
10. Drejt vendosjes së cilave marrëdhânie ishin bâ hapat e parë?
11. Me dërgimin e cilave misione ishin bâ hapat e parë drejt vendosjes së marrëdhânievet diplomatike?
12. Drejt vendosjes së marrëdhânievet diplomatike ndërmjet cilave vende ishin bâ hapat e parë?
13. Gjatë cilit vjet u-keqsuen marrëdhâniet ndërmjet Shqipnís dhe Shtetevet të Bashkueme?
14. Çka ngjau gjatë vjetit 1946?
15. Cilët refugjatë nuk pranuen me dorëzue shtetet prendimore?
16. Ku ishin strehue këta refugjatë?
17. Ç'u ngjau ca prej anëtarëvet të misionit amerikan e anglez?
18. Po ca tjerëve, anëtarë të misionit, ç'u ngjau?
19. Pse u-bâ e pamundun puna e njerëzvet të UNRRA-s?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

20. Cilat kanë qenë pra katër nga arsyet për të cilat u-keqsuen marrëdhâniet diplomatike?

21. Por, arsyeja mâ e madhe, a ka qenë se qeverija shqiptare nuk kërkoi kurrë vendosjen e marrëdhânievet diplomatike?

22. Cila qeverí nuk kërkoi vendosjen e marrëdhânievet diplomatike?

23. Po Shtetet e Bashkueme t'Amerikës, a e kishin kërkue vendosjen e marrëdhânievet diplomatike?

24. Cilat organe filluen të përdorin nji gjuhë të keqe kundër qeverís së SHBA?

25. Organ i cilës organizatë âsht gazeta "Zëri i popullit"?

26. Kush e urdhënoi tërheqjen e misionit amerikan nga Shqipnija?

27. Në çfarë atmosfere e urdhënoi tërheqjen e misionit Ministri i Jashtëm i SHBA?

28. Me ç'datë e urdhënoi ai tërheqjen e misionit në nji atmosferë anmiqsore?

29. Deri sot, a janë bâ hapa tjerë për vendosjen e marrëdhânievet diplomatike?

30. Me çfarë vendesh bân tregtí RPS e Shqipnís?

31. Cilat janë ato vende përtej perdes së hekurt, me të cilat bân tregtí RPS e Shqipnís?

32. A ka Shqipnija marrëdhânie diplomatike me Bashkimin Sovietik?

33. Kur u-prishën këto dy shtete?

34. Deri në vjetin 1961, me cilin shtet bâhesh 42% e tregtís së Shqipnís?

35. Cilat janë prodhimet e nëntokës që eksporton Shqipnija?

36. Çfarë lëkurash eksporton Shqipnija?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

37. Çka tjetër eksporton Shqipnija në vendet përtej perdes së hekurt?

38. Tregtija që bâhet me cilat vende âsht relativisht e vogël?

39. Me cilin shtet të Prendimit bâhet pjesa mâ e madhe e kësaj tregtije?

40. Cila qeverí nuk ka dhânë informata rreth valutës me të cilën paguhen mallnat?

41. Për cilët mallna jemi tue folë?

42. A pranohet leku në marrëdhâniet tregtare ndërkombëtare?

43. Me çfarë valute caktohen çmimet me vendet prendimore?

44. Po me vendet e demokracís popullore, me çfarë valute caktohen çmimet?



Vajzë shqiptare e veshun
me kostum kombëtar

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E GJASHTË
DETRYË SHTËPIJE

LESSON 67
PART VI
HOMEWORK

A. Mbushni vendet boshe të këtyne fjalive:

1. Me at njerí s'kam pasë kurrë _____ (good relations).

2. Përtej _____ (the river) nuk kanë mbjellë misër.

3. Ai thotë se nuk âsht i pasun, por unë e dij se ka nji _____ (a large amount) të hollash, që ka _____ (earned) _____ gjatë luftës.

4. Ky âsht nji ilaç për ata që kanë _____ (dry skin).

5. Gjendja politike e botës s'ka qenë kurrë e mirë dhe _____ (is getting worse (deteriorating)) çdo ditë.

B. Bâni 5 fjalí me këto fjalë:

bakër

me u-fshehë

marrëdhânie

me u-pague

me urdhnënue

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 67
PART VII
VOCABULARY

PJESA E SHTATË
FJALORI

ambasadë, -a ambasada, -t	(f.)	embassy
ambasador, -i ambasadorë, -t	(m.)	ambassador
anmiqsor, -e anmiqsorë	(adj. m. & f.)	hostile
atmosferë, -a	(f.)	atmosphere
bakër, bakri	(m.)	copper
blés, -e	(adj. m. & f.)	purchasing
Britanija e Madhe	(f.)	Great Britain
demokratik, -e demokratikë	(adj. m. & f.)	democratic
diplomatik, -e	(adj. m. & f.)	diplomatic
me dorëzue (unë dorëzoj)	(v.)	to hand over, deliver; present; surrender; to ordain (eccl.)
me eksportue (unë eksportoj)	(v.)	to export
firmë, -a firma, -t	(f.)	firm; signature
me fitue (unë fitoj)	(v.)	to win, gain, earn
front, -i fronte, -t	(m.)	front
me u-fshehë (unë fshehem)	(v.)	to hide oneself
fuqiplotë	(adj. m. & f.)	plenipotentiary (invested with full power)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

i, e, të hekurt të hekurta	(adj. m. & f.)	iron-, or iron; strong
i, të jashtëm e, të jashtme	(adj.)	foreign, external, outer
me u-keqsue (unë keqsohem)	(v.)	to get worse, deteriorate
konsull, -i konsuj, -t	(m.)	consul
krom, -i	(m.)	chrome
i, të kualifikuem e, të kualifikueme	(adj. m. & f.)	qualified, skilled
lëkurë, -a lëkura, -t	(f.)	hide, leather; skin, rind, peel
marrëdhânie, -a marrëdhânie, -t	(f.)	relation
mëditje, -a mëditje, -t	(f.)	wage
miell, -i	(m.)	flour
mision, -i misione, -t	(m.)	mission
monopol, -i monopole, -t	(m.)	monopoly
nëntokë, -a	(f.)	underground regions, subsoil
me u-pague (unë paguhem)	(v.)	to be paid, to get paid
i, të pakualifikuem e, të pakualifikueme	(adj. m. & f.)	unqualified, unskilled
me u-përfaqësue (unë përfaqësohem)	(v.)	to be represented
përkatës, -e	(adj. m. & f.)	appropriate, pertinent, proper
i, të përqëndruem e, të përqëndrueme	(adj. m. & f.)	concentrated

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

përtej	(prep. & adv.)	beyond, on the other side
politikë, -a	(f.)	policy, politics
sektor, -i sektorë, -t	(m.)	sector
tregtár, -e tregtarë	(adj. m. & f.)	trade-, commercial, trading, merchant
turist, -i turistë, -t	(m.)	tourist
me u-thye (unë thyhem)	(v.)	to be exchanged (for money); to be broken, shattered; to be defeated
me urdhënue (unë urdhënoj)	(v.)	to order, command
valutë, -a	(f.)	currency
vojgur, -i	(m.)	oil (petroleum)
vojguror, -e vojgurorë	(adj. m. & f.)	oil-
me zhvillue (unë zhvilloj)	(v.)	to develop, evolve

Shënime:

me bâ tregtí	to trade
në radhë të parë	primarily

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 68
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE — GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. Mbiemni që përdoret para e mbas emnit:

a. i njâjti

Ky âsht i njâjti punëtuer që ka punue ke ju.

Cili punëtuer âsht ky?
Ku ka punue i njâjti punëtuer?

Edhe shtëpija që keni marrë ju me qirá âsht e të njâjtit punëtuer.

Edhe cila shtëpí âsht e të njâjtit punëtuer?
E kujt âsht shtëpija që kam marrë unë me qirá?

Edhe unë i kam dhânë të holla huá të njâjtit punëtuer.

Cilit punëtuer i keni dhânë ju të holla huá?
Çka i keni dhânë ju të njâjtit punëtuer?

Ai do të marri me punue të njâjtin punëtuer.

Cilin punëtuer do të marri ai me punue?
Kush do t'a marri të njâjtin punëtuer?

Nji ftesë si këtê kam marrë edhe unë prej të njâjtit punëtuer.

Prej cilit punëtuer keni marrë ju nji ftesë si këtê?
Çfarë ftese keni marrë ju prej të njâjtit punëtuer?

a.1. Ky libër âsht i njâjtë me atê librin që keni ju në shtëpí.

A âsht ky libër i njâjtë me atê që keni ju në shtëpí?
Cili libër âsht i njâjtë me atê që keni ju në shtëpí?
Si cili libër âsht i njâjtë ai që kam unë në shtëpí?

b. e njâjta

Kjo âsht e njâjta grue me të cilën fola dje.

A âsht kjo e njâjta grue me të cilën fola dje?
Cila âsht kjo grue?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Këta janë fëmijët e së njâjtës grue që erdhi sot në zyrë.

A janë këta fëmijët e së njâjtës grue që erdhi sot në zyrë?
Fëmijët e cilës grue janë këta?

Së njâjtës grue i kanë thânë të vîjë në zyrë edhe nji herë.

Cilës grue i kanë thânë të vîjë në zyrë edhe nji herë?
Çka i kanë thânë të bâjë së njâjtës grue?

Të njâjtën grue e takova përsërí në rrugë.

Kush e takoi përsërí në rrugë të njâjtën grue?
Cilën grue takova përsërí në rrugë?

Unë i blej vét prej së njâjtës grue që i blén ti.

Kush i blen vét prej së njâjtës grue që i blén ti?
Prej cilës grue i bléj unë vét?
Ç'bléj unë prej së njâjtës grue?

b.1. Kjo shtëpí âsht e njâjtë me atê që pashë dje.

A âsht kjo shtëpí e njâjtë me atê që pashë dje?
Cila shtëpí âsht e njâjtë me atê që pashë dje?
Si cila shtëpí âsht e njâjtë ajo që patë dje?

c. të njâjtët

Të njâjtët punëtorë do të vîjnë edhe ke unë.

Cilët punëtorë do të vîjnë ke ju?
Ku do të vîjnë të njâjtët punëtorë?

Unë do të marr të njâjtët punëtorë.

Cilët punëtorë do të merrni ju?
Kush do t'i marri të njâjtët punëtorë?

d. të njâjtat

Këto janë të njâjtat vajza me të cilat fola dje.

Cilat vajza janë këto?
Kush foli dje me të njâjtat vajza?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Unë do të takoj sot të njâjtat vajza që keni takue ju.

Cilat vajza do të takoni sot?
Kush do t'i takojë të njâjtat vajza që kam takue unë?

e. i vetmi

Kjo âsht fotografija e të vetmit vllá që kam në Shqipní.

Cila fotografí âsht kjo?
Kjo âsht fotografija e cilit vllá?

Sot do t'i shkruej të vetmit vllá që kam në Shqipní.

Cilit vllá do t'i shkrueni sot?
Kur do t'i shkrueni të vetmit vllá që keni në Shqipní?

Të vetmin njerí që arrestuen e lëshuen të nesërmen.

Cilin njerí lëshuen të nesërmen?
Kur e lëshuen të vetmin njerí që arrestuen?

Sot mora letër prej të vetmit vllá që kam në Shqipní.

Prej cilit vllá mora letër sot?
Kush mori letër prej të vetmit vllá që ka në Shqipní?

f. e vetmja

Kjo âsht e vetmja vajzë që vjen heret.

A âsht kjo e vetmja vajzë që vjen heret?
Cila âsht e vetmja vajzë që vjen heret?

Ky âsht provimi i së vetmes vajzë që mbeti në klasë.

A âsht ky provimi i së vetmes vajzë që mbeti në klasë?
Provimi i cilës vajzë âsht ky?

Ai i dërgon pako së vetmes vajzë që ka në Shqipní.

Kush i dërgon pako së vetmes vajzë që ka në Shqipní?
Çka i dërgon ai së vetmes vajzë që ka në Shqipní?

Sot humba të vetmen pêndë që kishem.

Cilën pêndë humbët sot?
Kur e humbët të vetmen pêndë që kishi?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Sot mora letër prej së vetmes vajzë që kam në Shqipní.

Prej cilës vajzë morët sot letër?
Kur morët letër prej së vetmes vajzë që keni në Shqipní?

2. Si "i njâjti" dhe "i vetmi" edhe numërorët rrjeshtorë mund të vêhen para emnit për theksim.

Mësuesi: Ti je nxânsi i parë amerikan që ke studjue shqip.
Nxânsi: Ti je i pari nxânës amerikan që ke studjue shqip.

Kjo âsht fotografija e nxânsit të parë amerikan që ka studjue shqip.
Kjo âsht fotografija e të parit nxânës amerikan që ka studjue shqip.

Nxânsit të parë amerikan që ka studjue shqip i kanë dhânë nji punë të mirë.
Të parit nxânës amerikan që ka studjue shqip i kanë dhânë nji punë të mirë.

Unë kam njoftë nxânsin e parë amerikan që ka studjue shqip.
Unë kam njoftë të parin nxânës amerikan që ka studjue shqip.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 68
PART II
DIALOGUE

Arsimi në Shqipní

1. Kam lexue se gjatë periudhës së paraluftës, në Shqipní ka pasë nji sistem shkollor modern.
2. Asht e vërtetë. N'at kohë arsimi ka qenë influencue nga qytetnimi prendimuer.

3. Si âsht i riorganizuem sot arsimi shqiptár?
4. Asht i riorganizuem simbas sistemit me tre komponentë që janë: mësimi, puna prodhuese dhe edukimi fizik e ushtarak.

5. Cila âsht baza e arsimit të përgjithshëm sot?
6. Shkolla 11-vjeçare, e cila ndahet në shkollën 8-vjeçare, që âsht e detyrueshme, dhe në shkollën e mesme, që zgjat tre vjet.

7. Po çka do me thânë sistem me "baza politeknike-praktike"?
8. Do me thânë se gjatë shkollës 11-vjeçare, paralelisht me lândët e arsimit të përgjithshëm mësohen edhe mjeshtrí të ndryshme.

9. Atëherë ato shkolla qenkan teknikume.
10. Jo. Teknikumet janë shkolla të mesme të veçanta profesionale, ku nxânsi specializohet në nji zanát.

11. A mund të më numroni ndonji prej këtyne teknikumeve?
12. Po. Teknikumi i Naftës, Teknikumi Industrial, Teknikumi i Ndërtimit, Teknikumi Bujqësor etj.

13. Mbasi nji i rí merr maturën, çfarë mundësísh i epen atij për të përparue dhe bâ karierë?
14. Mund të regjistrohet në nji nga fakultetet e ndryshme t'Universitetit të Tiranës: në mjeksí, në drejtësí, në letërsí etj.

15. Ç'janë çerdhet dhe kopshtet e fëmijëvet?
16. Në teorí janë qendra edukimi t'arsimit parashkollor, ku fëmijëvet u mësohen lojna e u epen njohuní të dobishme.

17. Po në praktikë?
18. Tue qenë se qeverija dishron pjesëmarrjen sa mâ të gjânë të grues n'industrí...

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

19. E kuptoj; ato shërbejnë për të ruejtë fëmijët gjatë ditëvet që prindët dalin në punë.
20. Tamam. Përveç kësaj, qeverija përfiton nga këto shkolla për t'u dhânë fëmijëvet njohunît e para të botëkuptimit komunist.

21. Pse, a mendon se n'at moshë mund t'influencohet nji fëmijë nga propaganda komuniste?
22. T'a merr mendja. Fëmija nxên t'adhurojë disa njerëz, t'urrejë disa tjerë; me fjalë tjera, rritet me paragjykime.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 68



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 68
PART II
DIALOGUE

Education in Albania

1. I have read that during the pre-war period Albania had a modern educational system.
2. That's right. At that time the Albanian education was under the influence of Western civilization.

3. How is the Albanian education reorganized now?
4. It is reorganized on the basis of a system with three components, which are: instruction, productive work, and physical and military education.

5. What is the basis of the general education today?
6. The 11-year school, which is divided into an 8-year obligatory school and a three-year high school.

7. And what does "the polytechnical and practical basis" system mean?
8. It means that during the 11 years of schooling, along with general education, various skills are also taught.

9. Then these schools are vocational schools?
10. No. Technical high schools are special schools, where a student specializes in one skill.

11. Can you enumerate some of these technical high schools?
12. Yes. The Petroleum Technical High School, Industrial High School, Construction High School, Agricultural High School, etc.

13. After a young man receives his high school diploma, what possibilities does he have to progress and make a career?
14. He can enroll in one of the branches of the University of Tirana: in medicine, law, literature, etc.

15. What are the "nests" and the "gardens" for children?
16. In theory they are the centers of pre-school education, where children are taught how to play and acquire (are given) useful knowledge.

17. What is the practical usefulness of this?
18. Since the government requires women's greatest participation in industry ...

19. I get it now, they serve to care for the children during the days their parents work.
20. Exactly. Besides this, the government takes advantage of these schools to teach the children the first elements of communism.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

21. Why, does the government think that at that age children can be influenced by propaganda?
22. Naturally. The child learns to adore some people, hate others; in other words, he grows up with prejudices.



Shirokë

Shkodër

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 68
PART III
GRAMMAR ANALYSIS

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

1. ADJECTIVES PRECEDING NOUNS

a. Usually, in Albanian the adjective follows the noun, but the adjectives

i, e, të njâjtë	i, të vetëm
të njâjta	e, të vetme

precede the noun they modify. These adjectives have the case ending, while the noun indicates only the meaning and is used in the indefinite form.

Examples:

Më vizitoi i njâjti mjek që të vizitoi tý.
The same doctor that examined you examined me.

Mora me qirá të njâjtën shtëpí që kam pasë 4 vjet mâ parë.
I rented the same house that I had 4 years ago.

Të vetmit njerí që i kam shkrue këto kohët e fundit âsht Thomai.
Thomas is the only person to whom I wrote lately.

Humba të vetmen pêndë që pata.
I lost the only pen I had.

The paradigms of i njâjti:

Masculine

Nom.		i njâjti libër		të njâjtët	libra
Gen.	i, e, të	të njâjtit libër	i, e, të	të njâjtëvet	libra
Dat.		të njâjtit libër		të njâjtëvet	libra
Acc.		të njâjtin libër		të njâjtët	libra
Abl.	prej	të njâjtit libër	prej	të njâjtëvet	libra

Feminine

Nom.		e njâjta vajzë		të njâjtat	vajza
Gen.	i, e, të	së njâjtës vajzë	i, e, të	të njâjtavet	vajza
Dat.		së njâjtës vajzë		të njâjtavet	vajza
Acc.		të njâjtën vajzë		të njâjtat	vajza
Abl.	prej	së njâjtës vajzë	prej	të njâjtavet	vajza

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

b. For emphasis, some adjectives, especially ordinal numbers, may precede the nouns they modify.

Examples:

Ti qe i pari nxânës që mbarove provimin.
You were the first student to finish the test.

Po, ashtu âsht, i dashuni shok.
Yes, that's correct my dear friend.

I mjeri djalë, sa shumë po vuen!
Poor boy, he is suffering so much!

2. NOUNS USED AS ADJECTIVES

In Albanian, a noun in its indefinite form may function as a qualifying adjective.

Examples:

Agimin e kam shumë shok (d.m.th. të dashun, t'afërt).
Agim is a very good friend of mine.

Ti bâhe mâ fëmijë se yt bír (d.m.th. mâ i vogël).
You are more childish than your son.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 68
PART IV
GRAMMAR DRILL

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

1. Mbiemni kur përdoret para e mbas emnit:

a. i njâjti

Ky âsht i njâjti oficer, me të cilin fola dje.

Cili oficer âsht ky?

Këta janë fëmijët e të njâjtit oficer, me të cilin piva rakí dje.

Fëmijët e cilit oficer janë këta?

Të njâjtit polic i thash të njâjtën gjâ.

Cilit polic i thash të njâjtën gjâ?

Të njâjtin oficer e sjell përditë me automobil në shkollë.

Kush e sjell të njâjtin oficer përditë në shkollë me automobil?
Cilin oficer sjell përditë në shkollë me automobil?

Na jemi prej të njâjtit qytet.

A jemi na prej të njâjtit qytet?
Cilët janë prej të njâjtit qytet?

a.1. Ky automobil âsht i njâjtë me atê që ke blé ti.

Me cilin automobil âsht i njâjtë ky automobil?

b. e njâjta

Kjo âsht e njâjta gjâ që më ka ngjá mâ parë.

Kur më ka ngjá e njâjta gjâ?
Kujt i ka ngjá e njâjta gjâ mâ parë?

Këto janë syzat e së njâjtës tavolinë.

A janë këto syzat e së njâjtës tavolinë?
Syzat e cilës tavolinë janë këto?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

I shkrova edhe nji herë së njâjtës zyrë për këtçashtje.

A i shkrova edhe nji herë së njâjtës zyrë për këtçashtje?
Cilës zyrë i shkrova edhe nji herë për këtçashtje?

Unë i thash atij të njâjtën gjâ.

Kujt i thash unë të njâjtën gjâ?
Çka i thash atij?

Prej së njâjtës kushrînë kam marrë edhe nji libër.

Kush ka marrë edhe nji libër prej së njâjtës kushrînë?
Prej cilës kushrînë kam marrë unë edhe nji libër?

Kjo kravatë âsht e njâjtë me atê që ke vû ti.

A âsht kjo kravatë e njâjtë me atê që ke vû ti?
Cila kravatë âsht e njâjtë me atê që ke vû ti?

c. të njâjtët (emnore)

Këta janë të njâjtët njerëz që arrestuen ca ditë mâ parë.

A janë këta të njâjtët njerëz që arrestuen ca ditë mâ parë?
Cilët janë këta njerëz?

Të njâjtët njerëz i kam pâ tue kalue nëpër këtë rrugë.

Cilët kam pâ tue kalue nëpër këtë rrugë?
Ku i kam pâ tue kalue këta njerëz?

c.1 Automobilat e këtij vjeti janë pothuej të njâjtë me ata të vjetit të kaluem.

Cilët automobila janë pothuej të njâjtë me ata të vjetit të kaluem?

d. të njâjtat (emnore)

Të njâjtat grâ kanë ardhë edhe mâ parë për të kërkue djelmt e tyne.

Cilat grâ kanë ardhë edhe mâ parë për të kërkue djelmt e tyne?
Pse kanë ardhë të njâjtat grâ?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Të njâjtat grá i pashë tue hŷ në policí.

Cilat grá pashë tue hŷ në policí?
Ku i pashë tue hŷ të njâjtat grá?

Këto këmisha janë të njâjta me ato që ke ti.

d.1 A janë këto këmisha të njâjta me ato që ke ti?
Cilat këmisha janë të njâjta me ato që ke ti?

e. i vetmi

Skënderí âsht i vetmi shok që kam që s'e pi rakín.

Cili âsht i vetmi shok që s'e pi rakín?
Ç'nuk pi i vetmi shok që kam?

Ajo âsht fotografija e të vetmit nxânës me origjinë shqiptare që kemi pasë.

A âsht ajo fotografija e të vetmit nxânës me origjinë shqiptare që kemi pasë?
Fotografija e cilit nxânës âsht ajo?

I përgjegja të vetmit njerí që më kishte shkrue.

A i përgjegja të vetmit njerí që më kishte shkrue?
Cilit njerí i përgjegja?

Sot shitën të vetmin automobil që u kishte mbetë.

A e shitën sot të vetmin automobil që u kishte mbetë?
Cilin automobil shitën sot?

Mora letër prej të vetmit shok që kam.

A mora letër prej të vetmit shok që kam?
Prej cilit shok mora letër?

f. e vetmja

Kjo âsht e vetmja mënyrë për të punue.

A âsht kjo e vetmja mënyrë për të punue?
Cila âsht e vetmja mënyrë për të punue?

Kjo âsht fotografija e së vetmes zojë italo-shqiptare që njof.

A âsht kjo fotografija e së vetmes zojë italo-shqiptare që njof?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Fotografija e cilës zojë âsht kjo?

I dhash pak âmbëlsinë së vetmes vajzë që kishte mbetë pa marrë.

A i dhash pak âmbëlsinë së vetmes vajzë që kishte mbetë pa marrë?
Cilës vajzë i dhash pak âmbëlsinë?

Kam marrë letër prej së vetmes vajzë që kam në Shqipní.

Prej cilës vajzë kam marrë letër?
Kush ka marrë letër prej së vetmes vajzë që ka në Shqipní?

g. të vetmit

Ata të Sigurimit janë të vetmit njerëz që i paguejnë mirë.

A janë ata të Sigurimit të vetmit njerëz që i paguejnë mirë?
Cilët janë ata që i paguejnë mirë?

Ata janë të vetmit njerëz që nuk i kanë falë.

A janë ata të vetmit njerëz që nuk i kanë falë?
Cilët janë të vetmit njerëz që nuk i kanë falë?

h. të vetmet

Ato janë të vetmet grá që studjojnë gjuhë të hueja në këtë shkollë.

A janë ato të vetmet grá që studjojnë gjuhë të hueja në këtë shkollë?
Cilat janë të vetmet grá që studjojnë gjuhë të hueja në këtë shkollë?

Dje i shita të vetmet pula që kishem.

A i shitët dje të vetmet pula që kishi?
Cilat pula shitët dje?

2. Mbiemni para emnit për të theksue faktin.

a. i pari - i parë

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ky âsht i pari udhëtim që po bâj me aeroplan.

A âsht ky i pari udhëtim që po bâj me aeroplan?
Cili âsht i pari udhëtim që po bâj me aeroplan?

Roja arrestoi të parin ushtâr që zûni pa leje.

A e arrestoi roja të parin ushtâr që zûni pa leje?
Cilin ushtâr arrestoi roja?

a.1. Ai ka qenë mësuesi i parë në këtë shkollë që ka mësue japonisht.

A ka qenë ai mësuesi i parë në këtë shkollë që ka mësue japonisht?
Cili ka qenë mësuesi i parë në këtë shkollë që ka mësue japonisht?

Njeriun e parë e quejshin Adam.

Kê quejshin Adam?
Si e quejshin njeriun e parë?

b. e para - e parë

Kjo âsht e para herë që i thash.

A âsht kjo e para herë që i thash?
Cila herë âsht kjo që i thash?

Nuk më dhanë leje të parën herë, prandej bâna lutje përsërí.

A bâna lutje përsërí mbasi nuk më dhanë leje herën e parë?
Ç'bâna mbasi nuk më dhanë leje herën e parë?

b.1. Kjo âsht ndërtesa e parë që ka ndërtue shoqnija jonë.

A âsht kjo ndërtesa e parë që ka ndërtue shoqnija jonë?
E sata ndërtesë âsht kjo që ka ndërtue shoqnija jonë?

Herën e parë shkova vetëm.

A shkova vetëm herën e parë?
Cilën herë shkova vetëm?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

c. të parët - e parë

Të parët banorë të Ballkanit janë shqiptarët.

A janë shqiptarët të parët banorë të Ballkanit?
Cilët janë të parët banorë të Ballkanit?

Të parët njerëz që arrestuen i dërguen n'Italí.

A i dërguen n'Italí të parët njerëz që arrestuen?
Cilët njerëz dërguen n'Italí?

c.1. Fiqt e parë dalin zakonisht në qershuer.

A dalin në qershuer zakonisht fiqt e parë?
Kur dalin fiqt e parë?

Studentat e parë që erdhën i dërgova ke drejtori.

A i dërgova ke drejtori studentat e parë që erdhën?
Cilët studenta dërgova ke drejtori?
Ke kush i dërgova studentat e parë që erdhën?

d. të parat - e para

Këto janë të parat prodhime që merr nga kjo tokë.

A janë këto të parat prodhime që merr nga kjo tokë?
Cilat prodhime janë këto?

Të parat prodhime i mbajti për vete.

A i mbajti për vete të parat prodhime?
Cilat prodhime mbajti për vete?

d.1. Qytetet e para të Shqipnís kanë mbi 50 mijë banorë.

A kanë mbi 50 mijë banorë qytetet e para të Shqipnís?
Cilat qytete të Shqipnís kanë mbi 50 mijë banorë?

Mësimet e para i di pothuej përmendsh.

A i di pothuej përmendsh mësimet e para?
Cilat mësime di pothuej përmendsh?
Kush i di pothuej përmendsh mësimet e para?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

3. Numër plus mbiemën

Fakulteti i mjeksís âsht 6-vjeçár.

A âsht 6-vjeçár fakulteti i mjeksís?
Cili fakultet âsht 6-vjeçár?
Sa i gjatë âsht fakulteti i mjeksís?

Fakulteti i drejtësís âsht 4-vjeçár.

A âsht 4-vjeçár fakulteti i drejtësís?
Cili fakultet âsht 4-vjeçár?
Sa i gjatë âsht fakulteti i drejtësís?

4. Emni i përdorun si mbiemën:

Hakiun e kam pasë shumë shok.

Kê kam pasë shumë shok?
Çka e kam pasë Hakiun?
Kush e ka pasë Hakiun shumë shok?

Na e kemi Sokolin shumë mik.

Kush e ka Sokolin shumë mik?
Çka e kemi na Sokolin?
Kê kemi na shumë mik?

Matematika âsht landë bazë.

Cila landë âsht bazë?
Çfarë lande âsht matematika?
Çka âsht matematika?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

LESSON 68
PART V
READING TEXT

Sekretari e Parë i KQ të RPS të Shqipnís ka thânë kështu në Kongresin e Parë të Partís, më 1948:

"... Shkolla duhet t'i mësojë popullit punëtor idét e Partís, qëllimet e veprat e saja; duhet t'i edukojë fëmijët tanë në bazë t'arsimit të rí socialist; duhet të luftojë kundër çdo ideologjije dhe influence së huej në riní..." Komunistët e vazhdojnë edhe sot të njâjtën propagandë. Në të vërtetë në Kushtetutën e vjetit 1976 thuhet:

"Arsimi në RPS të Shqipnís organizohet e drejtohet nga shteti, âsht i hapun për të gjithë dhe epet falas; ai ndërtohet mbi bazën e botëkuptimit marksist-leninist dhe kombinon mësimin me punën prodhuese dhe me edukimin fizik e ushtarak."

Me fjalë tjera shteti kujdesohet që fëmijët të rriten nën kontrollin e tij të plotë. Simbas ideologjís komuniste kultura nuk duhet të jetë nji stolisje e mendjes, por vetëm që t'a vêjë njeriun në gjendje që të prodhojë sa mâ shumë e mâ mirë.

Arsimi komunist i edukon fëmijët në nji fushë të ngushtë njohunísh dhe tamam për këtë arsye arsimi profesional âsht zhvillue shumë në RPS të Shqipnís.

Në Shqipní arsimi fillon me "arsimin parashkollor", që përfshîn çerdhet dhe kopshtet e fëmijëvet. Tue qenë se sot pjesëmarrja e grues shqiptare n'industrí, bujqësí dhe shëndetësí âsht shumë e gjânë, numri i çerdhevet dhe i kopshtevet të

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

fëmijëvet âsht rritë shumë dhe gjithnji vazhdon të rritet.

Mbas arsimit parashkollor vjen "arsimi i përgjithshëm", që përfshîn: shkollën fillore (4 vjet), shkollën e mesme t'ulët (4 vjet) dhe shkollën e mesme (3 vjet). Dy të parat janë të detyrueshme me ligjë dhe quhen "shkolla 8-vjeçare" dhe të trija së bashku marrin emnin "shkolla 11-vjeçare." Ndër shkollat e mesme, si u-tha mâ nalt, rândësí të madhe kanë shkollat profesionale, d.m.th. teknikumet, të cilat u mësojnë nxânësvet nga nji zanát, në mënyrë që ata të jenë në gjendje me ndihmue specialistët me arsim të naltë.

Sot të rijt shqiptarë e marrin arsimin e naltë n'Universitetin e Tiranës dhe në filialet e tija (Durrës, Shkodër, Elbasan, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë dhe Korçë e Gjirokastër).

Nji student që ka mbarue universitetin mund t'i vazhdojë studimet e shkallës së parë të kualifikimit pasuniversitár në nji fushë të shkencës e të fitojë gradën "Kandidat i Shkencavet", që âsht nji gradë pak mâ e naltë se diploma amerikane MA. Kur nji student i plotëson kërkesat e shkallës së dytë të kualifikimit pasuniversitár, ai merr titullin "Doktor". Titulli "Profesor" âsht grada mâ e naltë që zakonisht u epet ca prej doktoravet mâ të zotë t'institucioneve arsimore ose t'institucioneve tjera shkencore dhe që kanë pregatitë ose botue vepra shkencore origjinale.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS-PYETJE

1. Çfarë idesh duhet t'i mësojë shkolla popullit punëtor?
2. Kush ka thânë se shkolla duhet t'i mësojë popullit idét e Partís?
3. Ku dhe kur e ka thânë këtê Sekretari e Parë i KQ të PP të Shqipnís?
4. Cilat qëllime dhe vepra duhet të dijë populli?
5. Simbas Sekretarit të Parë, në bazë të cilit arsim duhet t'i edukojë fëmijët shkolla?
6. Kundër cilës ideologjí dhe influencë duhet të luftojë shkolla në rinís?
7. Cilët e vazhdojnë edhe sot të njâjtën propagandë?
8. Në kushtetutën e cilit vjet thuhet se arsimi në Shqipní organizohet e drejtohet nga shteti?
9. Ku âsht i hapun arsimi për të gjithë dhe epet falas?
10. Çka ndërtohet në Shqipní mbi bazën e botëkuptimit marksist-leninist?
11. Çka e kombinon mësimin me punën prodhuese dhe me edukimin fizik e ushtarak?
12. Ç'bân arsimi në Shqipní?
13. Nën kontrollin e kujt kujdesohet shteti që të rriten fëmijët?
14. Simbas cilës ideologjí, kultura nuk duhet të jetë nji stolisje e mendjes?
15. Kê duhet t'a vêjë në gjendje kultura që të prodhojë sa mâ shumë e sa mâ mirë?
16. Cili arsim i edukon fëmijët në nji fushë të ngushtë njohunísh?
17. Tamam për këtë arsye, cili arsim âsht zhvillue shumë në RPS të Shqipnís?
18. Pse âsht zhvillue shumë arsimi profesional në RPS të Shqipnís?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

19. Me ç'lloj arsimi fillon arsimi në Shqipní?

20. Ç'përfshîn arsimi parashkollor?

21. Ku âsht pjesëmarrja e grues shqiptare shumë e gjânë?

22. Për këtë arsye, sa âsht rritë numri i çerdhevet dhe i kopshtevet të fëmijëvet?

23. Cili numër vazhdon të rritet gjithnji?

24. Cili arsim vjen mbas arsimit parashkollor?

25. Cilat shkolla përfshin arsimi i përgjithshëm?

26. Sa vjet zgjat shkolla fillore?

27. Sa vjet zgjat shkolla e mesme e ulët?

28. Sa vjet zgjat shkolla e mesme?

29. Cilat shkolla janë të detyrueshme me ligjë?

30. Si quhen shkolla fillore dhe shkolla e mesme e ulët?

31. Cilat shkolla e marrin emnin "shkolla 11-vjeçare"?

32. Ndër shkollat e mesme, cilat shkolla kanë rândësí të madhe?

33. Si quhen me nji fjalë shkollat profesionale?

34. Çka u mësojnë nxânësvet teknikumet?

35. Kê duhet të jenë në gjendje me ndihmue nxânsit që mësojnë nga nji zanát?

36. Ku e nxânë zanatin nxânsit që ndihmojnë specialistët me arsim të naltë?

37. Ku e marrin sot të rijt shqiptarë arsimin e naltë?

38. Thoni emnat e disa filialeve t'Universitetit të Tiranës!

39. Sa filiale ka Universiteti i Tiranës?

40. Ku mund t'i vazhdojë studimet nji student që ka mbarue universitetin?

41. Çfarë grade fiton nji student që ka mbarue studimet e shkallës së parë të kualifikimit pasuniversitar?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

42. Cila gradë âsht pak mâ e naltë se diploma amerikane MA?

43. Ç'titull merr nji student, i cili i plotëson kërkesat e shkallës së dytë të kualifikimit pasuniversitár?

44. Kur e merr titullin "Doktor" kandidati i shkencavet?

45. Cila âsht grada mâ e naltë n'arsim?

46. Zakonisht, cilëve doktora u epet grada "Profesor"?

47. Çfarë veprash duhet të kenë pregatitë ose botue njerzit e shkencës që të marrin titullin "Profesor"?



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 68
PART VI
HOMEWORK

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

Përkëtheni anglisht fjalít që vijojnë:

1. E shoqja ka punue si rrobaqepëse për 20 vjet; t'a merr mendja që e di mirë këtë zanát.

2. Meshari (missal) i Gjon Buzukut, botue më 1555, shënon fillimin e letërsís shqipe.

3. Paragjykimet janë mendime (opinions) që formojnë njerzit pa e studjue mirë nji çashtje, ase mendime që janë formue prej tjerëve.

4. E vetmja landë që nuk më pëlqente kur ishem në shkollë të mesme ishte matematika.

5. Mësimi i shqipes në këtë shkollë zgjat 11 muej.

6. U a dhanë misrin falas sepse ishin të vorfën.

7. A e ka bâ ende kërkesën për të marrë leje?

8. Stolisja e qytetit âsht bâ për festën e 28 Nandorit.

9. Universiteti i Tiranës ka mâ shumë se 7 fakultete; ndër këto edhe fakultetin e drejtësís.

10. M'u-drejtue mue për t'ia ndreqë at punë, por nuk munda.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me adhurue (unë adhuroj)	(v.)	to worship, adore
botëkuptim, -i botëkuptime, -t	(m.)	one's personal philosophy about life
me botue (unë botoj)	(v.)	to publish
i, të detyrueshëm e, të detyrueshme	(adj. m. & f.)	obligatory, compulsory, mandatory
i, të dobishëm e, të dobishme	(adj. m. & f.)	useful, beneficial, profitable
drejtësí, -ja	(f.)	law (jurisprudence), justice
me u-drejtue (unë drejtohem)	(v.)	to straighten out, to turn to (usually for help); to be headed for
edukim, -i	(m.)	education, educating
me edukue (unë edukoj)	(v.)	to educate
fakultet, -i fakultete, -t	(m.)	college (a branch of learning or instruction at a university)
falas	(adv.)	free (of charge), gratis
filial, -i filiale, -t	(m.)	a branch of a large institution
fizik, -e	(adj. m. & f.)	physical
influencë, -a	(f.)	influence
me influencue (unë influencoj)	(v.)	to influence
me u-influencue (unë influencohem)	(v.)	to be influenced

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

kërkesë, -a kërkesa, -t	(f.)	request, demand
karierë, -a	(f.)	career
komponent, -i komponentë, -t	(m.)	component
kontroll, -i kontrolle, -t	(m.)	control
landë, -a landë, -t	(f.)	subject (school); material, lumber, timber
letërsí, -ja letërsí, -t	(f.)	literature
maturë, -a matura, -t	(f.)	high school diploma
mendje, mendja mendje, -t	(f.)	mind
me u-mësue (unë mësohem)	(v.)	to be taught; to get used to
mjeksí, -ja	(f.)	science of medicine
naftë, -a	(m.)	oil, díesel oil
ndërtim, -i ndërtime, -t	(m.)	construction, constructing
njohuní, -ja njohuní, -t	(f.)	knowledge, information
paragjykim, -i paragjykime, -t	(m.)	prejudice
paralelisht	(adv.)	simultaneously
i, e, të paraluftës	(adj. m. & f.)	pertaining to the pre-World War II period
parashkolluer, parashkollore, parashkollorë	(adj. m. & f.)	pre-school
pasuniversitár, -e	(adj. m. & f.)	postgraduate

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

periudhë, -a periudha, -t	(f.)	period (time)
me përfitue (unë përfitoj)	(v.)	to profit, benefit, to take advantage
i, të përgjithshëm e, të përgjithshme	(adj. m. & f.)	general
me përparue (unë përparoj)	(v.)	to progress, advance
pjesëmarrje, pjesëmarrja	(f.)	participation, partaking
politeknik, -e politeknikë	(adj. m. & f.)	polytechnic
praktik, -e praktikë	(adj. m. & f.)	practical
praktikë, -a	(f.)	practice
me prodhue (unë prodhoj)	(v.)	to produce
prodhues, -e	(adj. m. & f.)	productive
qytetnim, -i qytetnime, -t	(m.)	civilization
me u-regjistrue (unë regjistrohem)	(v.)	to be registered, to sign up
i, të riorganizuem e, të riorganizueme	(adj. m. & f.)	reorganized
me u-specializue (unë specializohem)	(v.)	to be specialized
stolisje, stolisja stolisje, -t	(f.)	decoration, orna- ment, decorating
subjekt, -i subjekte, -t	(m.)	subject
shëndetësí, -ja	(f.)	health, sanitation
shkolluer, shkollore shkollorë	(adj. m. & f.)	school-, scholastic

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

teknikum, -t teknikume, -t	(m.)	trade (high) school
teorí, -ja teorí, -t	(f.)	theory
me urrejtë (unë urrej)	(v.)	to hate
vjeçár, -e vjeçarë	(adj. m. & f.)	year-old
zanát, zanati zanate, -t	(m.)	trade, skill

Shënime:

t'a merr mendja	of course

* * *

Asht e kotë që të mundohemi t'a shofim veten ashtu si na shofin të tjerët: nuk do t'u besojshim kurrë syvet tonë.

Infermierja: Agim, pse i ré shokut tând kokës?

Agimi: Sepse s'di gramatikë. Ishim tue vû gardh përreth kopshtit të tij dhe ai më tha: "Tash do të marr nji hû dhe t'a fus në gropë; kur unë t'ul kokën, ti merr çekiçin e bjeri me gjithë fuqí. Edhe unë i rash ...".

Shkrimtarja George Sand jetonte në nji kështjellë të vogël. Shpeshherë i vîjshin miq për të kalue ca ditë në pronën e saj plot komoditete. Nji prej këtyne miqve kishte ndejtë jashtëzakonisht shumë dhe nuk po epte shej se donte me u-nisë.

"A e di cili âsht ndryshimi ndërmjet teje dhe Don Kishotit?" e pyeti Zoja Sand. "Don Kishoti i merrte hotelet për kështjella, kurse ti ... ti i merr kështjellat për hotele".

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 69
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE — GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. Përemnat e pakufîshëm

a. Kërkush s'erdhi në mbledhje.

A erdhi ndokush në mbledhje?
Kush s'erdhi në mbledhje?

Ky qen s'âsht i kërkujt.

I kujt âsht ky qen?
Cili qen s'âsht i kërkujt?

Nuk i a kam thânë kërkujt këtë gjâ.

A i a kam thânë ndokujt këtë gjâ?
Kujt i a kam thânë këtë gjâ?

S'pashë kërkênd në kafe mbrâmë.

A pashë ndokênd në kafe mbrâmë?
Kush s'pá kërkênd në kafe mbrâmë?

Ai s'merr pare huá prej kërkujt.

A merr ai pare huá prej ndokujt?
Kush s'merr pare huá prej kërkujt?
Çka s'merr ai huá prej kërkujt?

b. Dikush duhet të ketë punue këtu mbrâmë.

A duhet të ketë punue dikush këtu mbrâmë?
Kush duhet të ketë punue këtu mbrâmë?
Kur duhet të ketë punue dikush këtu?

Kjo shtëpí âsht e dikujt që s'i a dij emnin.

A âsht kjo shtëpí e dikujt që s'i a dij emnin?
E kujt âsht kjo shtëpí?

I thash dikujt të më sjelli pak çaj.

A i thash dikujt të më sjelli pak çaj?
Kujt i thash të më sjelli pak çaj?
Çka i thash dikujt të më sjelli?

Kanë pá dikê tue hŷ në kamp pa leje.

A kanë pá dikê tue hŷ në kamp pa leje?
Kê kanë pá tue hŷ në kamp pa leje?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kam marrë letër prej dikujt që s'e kam takue kurrë.

A kam marrë letër prej dikujt që s'e kam takue kurrë?
Kush ka marrë letër prej dikujt që s'e ka takue kurrë?

c. Kushdo që e njef, e di se do të martohet.

Kush e di se do të martohet?
Çka di kushdo që e njef?

E kujtdo qoftë ajo tokë, ti s'duhet t'a kullosish bagëtín aty.

Çka s'duhet të bâni?

Do t'i thom kujtdo për çashtjen tânde.

A do t'i thom kujtdo për çashtjen tânde?
Kujt do t'i thom për çashtjen tânde?

Ti nuk duhet të flasish me kêdo për këtë çashtje.

Kush nuk duhet të flasi me kêdo për këtë çashtje?
Me kê nuk duhet të flas unë për këtë çashtje?

d. Ndokush mund t'a dijë këtë gjâ.

A mund t'a dijë ndokush këtë gjâ?
Kush mund t'a dijë këtë gjâ?

Kjo shtëpí mund të jetë e ndokujt që nuk banon këtu.

A mund të jetë kjo shtëpí e ndokujt që nuk banon këtu?
E kujt mund të jetë kjo shtëpí?
Cila shtëpí mund të jetë e ndokujt që nuk banon këtu?

Thueji ndokujt që të na sjelli pak kafe.

A t'i thom ndokujt që të ju sjelli pak kafe?
Kujt t'i thom që të ju sjelli pak kafe?
Çka t'i thom ndokujt që të ju sjelli?

S'pashë ndokênd që njof n'at mbledhje.

A pashë ndokênd që njof n'at mbledhje?
Ku s'pashë ndokênd që njof?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Këtê do t'a kesh ndigjue prej ndokujt.

A do t'a kem ndigjue këtê prej ndokujt?
Prej kujt mund t'a kem ndigjue këtê?

e. Cilido që të vîjë i pari, ai duhet të hapi dritoret.

A duhet t'i hapi dritoret cilido që të vîjë i pari?
Kush duhet t'i hapi dritoret?

I cilitdo qoftë libri, merre; s'ka rândësí.

A t'a marr librin, i cilitdo qoftë?
Çka të marr?

Cilindo që të gjêjsh në rrugë mbas orës 10 arrestoje!

A t'arrestoj cilindo që të gjêj në rrugë mbas orës 10?
Cilin duhet t'arrestoj?

Merr nji filxhan prej cilitdo prej tyne.

Prej cilit të marr nji filxhan?
Çka të marr prej cilitdo prej tyne?

f. Cilado që të largohet e fundit, duhet të mbylli derën.

A duhet t'a mbylli derën cilado që të largohet e fundit?
Çka duhet të bâjë ajo që do të largohet e fundit?

I cilësdo qoftë krahni, merre; s'ka rândësí.

A t'a marr krahnin i cilësdo qoftë?
Çka duhet të marr?

Epja këtë libër cilësdo prej tyne.

Cilës t'i a ap këtë libër?
Çka duhet t'i ap cilësdo prej tyne?

Merre cilëndo (pêndë) po të të hŷjë në punë.

A t'a marr cilëndo (pêndë) po të më hŷjë në punë?
Cilën të marr po të më hŷjë në punë?

Merr ca libra huá prej cilësdo prej tyne.

A të marr ca libra huá prej cilësdo prej tyne?
Prej kujt të marr libra huá?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

2. Emna me parashtesën "pa"

a. Nga nji emën:

Ai ka mundësí të të ndihmojë, por s'do.

A ka ai mundësí të më ndihmojë, por s'do?
Kush ka mundësí të më ndihmojë, por s'do?
Çka ka mundësí ai të bâjë?

Ai âsht në pamundësí t'i mbajë të gjithë me bukë.

A âsht ai në mundësí t'i mbajë të gjithë me bukë?
Kush âsht në pamundësí t'i mbajë të gjithë me bukë?
Cilët âsht ai në pamundësí të mbajë?

Ai ka gjumë gjithnji.

A ka ai gjumë gjithnji?
Kush ka gjumë gjithnji?

Jam shumë i lodhun nga pagjumësija (lack of sleep).

A jam shumë i lodhun nga pagjumësija?
Kush âsht shumë i lodhun nga pagjumësija?
Nga se jam shumë i lodhun?

b. Nga nji mbiemën:

Në verë ky lumë âsht i kalueshëm më kambë.

A âsht ky lumë i kalueshëm më kambë në verë?
Cili lumë âsht i kalueshëm më kambë në verë?
Kur âsht i kalueshëm ky lumë?

Në dimën kjo rrugë âsht e pakalueshme për arsye të borës.

A âsht e pakalueshme kjo rrugë në dimën për arsye të borës?
Cila rrugë âsht e pakalueshme në dimën për arsye të borës?
Kur âsht e pakalueshme kjo rrugë?
Pse âsht e pakalueshme kjo rrugë në dimën?

Ai âsht shumë i kujdesshëm kur e nget maqinën.

A âsht ai shumë i kujdesshëm kur e nget maqinën?
Kush âsht shumë i kujdesshëm kur e nget maqinën?
Kur âsht ai shumë i kujdesshëm?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ai âsht i pakujdesshëm, prandej ka pasë shumë aksidente.

A âsht ai i pakujdesshëm, prandej ka pasë shumë aksidente?
Kush âsht i pakujdesshëm, prandej ka pasë shumë aksidente?
Pse ka pasë ai kaq shumë aksidente?

Qumështi âsht shumë i nevojshëm sidomos për fëmijë.

A âsht qumështi shumë i nevojshëm sidomos për fëmijë?
Për cilët âsht shumë i nevojshëm qumështi?
Çka âsht shumë i nevojshëm për fëmijë?

Ai ishte i panevojshëm këtu, prandej i dhanë nji punë tjetër.

A ishte ai i panevojshëm këtu, prandej i dhanë nji punë tjetër?
Kush ishte i panevojshëm këtu, prandej i dhanë nji punë tjetër?

Jam shumë i lodhun nga të nxehtit dhe nga puna.

A jam shumë i lodhun nga të nxehtit dhe nga puna?
Kush âsht shumë i lodhun nga të nxehtit dhe nga puna?
Nga se jam shumë i lodhun?

Ai âsht i palodhun në punë, prandej i kaloi të gjitha vështirësít.

A âsht ai i palodhun në punë e prandej i kaloi të gjitha vështirësít?
Kush âsht i palodhun në punë e prandej i kaloi të gjitha vështirësít?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 69
PART II
DIALOGUE

Shëndetsija në RPS të Shqipnís

1. Në Shqipní, mjeksija âsht e shtetzueme, apo jo?
2. Po. Si çdo gjâ tjetër, edhe aktiviteti i mjekëvet ushtrohet nën kontrollin e shtetit me anë të Ministrís së Shëndetsís.

3. Me fjalë tjera, i sëmundi nuk paguen as për mjekim, as për ilaçe dhe as në formë shpërblimi për mjekun.
4. Nuk mund të thuhet se nuk paguen; shërbimet mjeksore janë pjesë e sigurimevet shoqnore, për të cilat ...

5. E dij, kushdo që punon ep nji kontribut mujor.
6. Tamam. Prandej, ndihma mjeksore nuk i epet falas kërkujt.

7. A mund të thërrasi nji i sëmundë cilindo mjek që dishron?
8. Së pari, i sëmundi nuk thërret mjekun, por qendrën shëndetsore, ku ka nji numër mjekësh në shërbim.

9. Qendra shëndetsore e dërgon mjekun?
10. Po. Ajo e dërgon mbasi i sëmundi t'a njoftojë mbi simptomat e sëmundjes që ka.

11. Ç'âsht "personeli i mesëm"?
12. Me këto emën quhen ndihmësmjekët, të cilët janë t'ushtruem me dhânë ndihmë të shpejtë, me shërue plagë e sëmundje të thjeshta.

13. Pse quhen kështu?
14. Sepse për aftësí profesionale dhe përgjegjësí qëndrojnë në mes infermierevet dhe mjekëvet.

15. Ku e zhvillojnë ata aktivitetin e tyne?
16. Nëpër ambulanca periferike, nëpër konsultore për fëmijë, por sidomos nëpër fabrika e qendra pune.

17. Ç'janë "ekipet javore mjeksore ose dentare"?
18. Janë grupe mjekësh, dentistësh ose mamísh që vizitojnë çdo javë të sëmundët ndër fshatra të largët ku s'ka ambulanca ose spitale rurale.

19. Cilat janë sëmundjet mâ të përhapuna në Shqipni? Për shembull na këtu kemi sëmundjen e zemrës dhe kancerin.
20. Po ato që kemi këtu: sëmundjen e zemrës, pikën dhe kancerin.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 69



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 69
PART II
DIALOGUE

Public Health in the People's Socialist Republic of Albania

1. In Albania, medicine is socialized, isn't it?
2. Yes. Like anything else, the activity of the physicians is under state control through the Ministry of Health.

3. In other words, the patient doesn't pay either treatments, medicine or the doctor's fees.
4. Well, you can't say that he doesn't pay. Medicare is part of social security, for which ...

5. I know. Every person that works gives a monthly contribution.
6. Exactly. Therefore, medicare is not given free to anybody.

7. Can a patient call any doctor he wishes?
8. First of all, the patient cannot call a doctor but calls the medical center where a number of doctors are on duty.

9. You mean that the medical center sends the physician?
10. Yes. They send the doctor after the patient has given the symptoms of the disease that he has.

11. What's "middle personnel?"
12. This name is given to the physician's assistants who are trained in giving first aid, to treat wounds and simple diseases.

13. Why are they called (this way) by this name?
14. Because their professional skills and responsibility are between that of nurses and doctors.

15. Where do they practice (their activity)?
16. In suburban ambulances, in consulting centers for children, but especially in the factories and in work centers.

17. What are the "weekly medical or dental crews?"
18. They are a group of physicians, dentists and midwives, who examine the sick every week in the remote villages where there are no ambulances or rural hospitals.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

19. What are the most widespread diseases in Albania?
    For example, we have heart disease and cancer here.
20. The same diseases that you have here: heart disease, stroke and cancer.



Nji kishë e vjetër në Mborje, afër Korçës ndërtue në vjetin 898.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

LESSON 69
PART III
GRAMMAR ANALYSIS

INDEFINITE COMPOUND PRONOUNS

a. The following indefinite compound pronouns refer to persons only and cannot be used as adjectives (followed by a noun).

ndokush	someone, anybody, any person, (it is usually used to ask questions)
dikush	someone, somebody
pakkush	few people
shumëkush	many people
gjithkush	everybody
askush or kurrkush (kërkush)	nobody
tjetërkush	somebody else
kushdo	anyone, whoever

Paradigms of ndokush and kushdo

Nom.	ndokush	kushdo
Gen.	i, e, të ndokujt	i, e, të kujtdo
Dat.	ndokujt	kujtdo
Acc.	ndokênd	kêdo
Abl.	prej ndokujt	prej kujtdo

b. The following may refer to persons or objects and may be followed by a noun (used in the indefinite form, but only the indefinite pronoun is declined).

cilido, cilado	everybody, anyone (no matter who)
secili, secila	each, every one, any one (of them)
gjithsecili, gjithsecila	each one of them, every one of them

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Paradigms of cilido and cilado

Nom.		cilido (djalë)		cilado	(vajzë)
Gen.	i, e, të	cilitdo "	i, e, të	cilësdo	"
Dat.		cilitdo "		cilësdo	"
Acc.		cilindo "		cilëndo	"
Abl.	prej	cilitdo "	prej	cilësdo	"

c. The following are used as adjectives only if followed by a noun.

çdo — each, every (The noun that follows is declined in the indefinite singular.):

Nom.		çdo djalë
Gen.	i, e, të	çdo djali
Dat.		çdo djali
Acc.		çdo djalë
Abl.	prej	çdo djali

njifarë — a certain ...

kurrfarë — none of that kind

çfarëdo — any kind (precedes the noun in the ablative).

Examples:

Blej çfarëdo mishi që të gjejsh në treg!
(Buy any kind of meat you find in the market!)

Mue nuk më pëlqen qumështi, çfarëdo qumështi që të jetë.
(I don't like milk, no matter what kind of milk it is.)

A e njef ti njifarë Haki Bakalli?
(Do you know a certain Haki Bakalli?)

The accent on the compound indefinite pronouns falls always on the second part or element.

Examples: gjithkúsh, kushdó, etc.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 69
PART IV
GRAMMAR DRILL

1. Përemnat e pakufîshëm

a. Emnorja

Gjithkush e di se ai ka lé në Përmet.
Kush e di se ai ka lé në Përmet?
Ç'di gjithkush?

Shumëkush shkon për pushime në gusht.
Kush shkon për pushime në gusht?
Në ç'muej shkon shumëkush për pushime?
Ç'bân shumëkush në gusht?

Pakkush udhëton sot më kalë.
Kush udhëton sot më kalë?
Ç'bân sot pakkush?
Qysh udhëton sot pakkush?

Dikush e ka thye xhamin e dritores.
Ç'ka thye dikush?
Kush e ka thye xhamin e dritores?
Cilin xham ka thye dikush?

Kërkush (kurrkush) s'do me e blé këtë radio të vjetër.
Kush s'do me e blé këtë radio të vjetër?
Çka s'do me blé kërkush?
Cilën radio s'do me e blé kërkush?

Askush nuk më tregoi se ç'kishte ngjá.

Kush nuk më tregoi se ç'kishte ngjá?
Çka nuk më tregoi askush?

b. Gjindorja

Kjo âmbëlsinë s'âsht vetëm imja, âsht e gjithkujt.
Cila âmbëlsinë s'âsht vetëm imja?
E kujt âsht kjo âmbëlsinë?

Shtëpít e shumëkujt kanë dritore të vogla.
Shtëpít e kujt kanë dritore të vogla?
Çfarë dritoresh kanë shtëpít e shumëkujt?

Ky âsht vetëm mendimi i pakkujt.
Cili âsht vetëm mendimi i pakkujt?
Mendimi i kujt âsht ky?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ai s'âsht automobili i Janit, âsht i dikujt tjetër.
Cili automobil s'âsht i Janit, por i dikujt tjetër?
I kujt âsht ai automobil?

Ajo s'âsht çanta e kërkujt që njof unë.
Cila s'âsht çanta e kërkujt që njof unë?
Çanta e kujt âsht ajo?

Paret e askujt nuk do të shpenzohen kot.
A do të shpenzohen kot pare e ndokujt?
Cilat pare nuk do të shpenzohen kot?

c. Dhânorja

Gjithkujt nuk i pëlqen të shkojë për pushime në verë.
Kujt nuk i pëlqen të shkojë për pushime në verë?
Çka nuk i pëlqen gjithkujt të bâjë?

Shumëkujt i duhet të marri pare huá në fund të vjetit.
A i duhet shumëkujt të marri pare huá në fund të vjetit.
Kujt i duhet të marri pare huá në fund të vjetit?
Ç'i duhet të marri shumëkujt në fund të vjetit?

Pakkujt i kanë thânë të vîjë nesër në punë.
Kujt i kanë thânë të vîjë nesër në punë?
Çka i kanë thânë pakkujt?

I bâna telefon dikujt me ardhë me më marrë.
Kujt i bâna telefon me ardhë me më marrë?
Pse i bâna telefon dikujt?

Nuk i tregova kërkujt se do të nisemi nesër.
Kujt nuk i tregova se do të nisemi nesër?
Çka nuk i tregova kërkujt?

Askujt nuk i tregon sa vjeç âsht.
Kujt nuk i tregon sa vjeç âsht?
Çka nuk i tregon askujt?

d. Kallzorja

Kam pyetë gjithkênd, por askush s'e njef.
A kam pyetë gjithkênd, por askush s'e njef?
Kê kam pyetë, por askush s'e njef?
Kush ka pyetë gjithkênd, por askush s'e njef?

Do të këshillohem me shumëkênd para se të vendos.
Me kê do të këshillohem para se të vendos?
Çka do të bâj para se të vendos?
Kush do të këshillohet me shumëkênd para se të vendosi?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Unë njof pakkênd në rrugën ku banoj.
Kê njof unë në rrugën ku banoj?
Në cilën rrugë njof unë pakkênd?
Kush njef pakkênd në rrugën ku banon?

Nesër mbrâma kam ftue dikê për darkë.
Kê kam ftue për darkë nesër mbrâma?
Kush ka ftue dikê për darkë nesër mbrâma?

S'pashë në teatër kërkênd që njof.
Kê s'pashë në teatër?
Ku s'pashë kërkênd që njof?
Kush s'pá në teatër kërkênd që njef?

Nuk do të shkoj me askênd tjetër në Korçë.
Me kê nuk do të shkoj në Korçë?
Ku nuk do të shkoj me askênd tjetër?
Kush nuk do të shkojë me askênd tjetër në Korçë?

e. Rrjedhorja

S'kam marrë ende përgjegje prej gjithkujt.
Prej kujt s'kam marrë ende përgjegje?
Çka s'kam marrë ende prej gjithkujt?
Kush s'ka marrë ende përgjegje prej gjithkujt?

Pres lajme prej shumëkujt.
Prej kujt pres lajme?
Ç'pres prej shumëkujt?
Kush pret lajme prej shumëkujt?

Prej pakkujt kam marrë letër muejin që shkoi.
Prej kujt kam marrë letër muejin që shkoi?
Çka kam marrë prej pakkujt muejin që shkoi?
Kur kam marrë letër prej pakkujt?

Kam marrë nji kartëpostale prej dikujt që ti nuk njef.

Prej kujt ke marrë nji kartëpostale?
Çka ke marrë prej dikujt që nuk njof unë?
Sa kartëpostale ke marrë prej dikujt që nuk njof unë?

S'kam marrë pare huá prej kërkujt.
Prej kujt s'kam marrë pare huá?
Çka s'kam marrë prej kërkujt?
Kush s'ka marrë pare huá prej kërkujt?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Nuk pres letër prej askujt.
Prej kujt nuk pres letër?
Çka nuk pres prej askujt?
Kush nuk pret letër prej askujt?

f. Fto nxânsit të bâjnë nga nji fjalí me këta përemna të pakufîshëm: secili, secila, cilido, cilado.

2. Emnat e formuem me "pa"

a. Nga nji emën

Gjergji ka mundësí të vîjë nesër mbasdreke.
Kur ka mundësí të vijë Gjergji?
Kush ka mundësí të vîjë nesër mbasdreke.
Ç'ka mundësí të bâjë Gjergji nesër mbasdreke.

Tahiri âsht në pamundësí të vîjë n'orën pesë.
Kush âsht në pamundësí të vîjë n'orën pesë?
Ç'âsht Tahiri në pamundësí të bâjë?

Drejtësija âsht karakteristikë e njeriut të ndershëm.
Karakteristikë e cilit njerí âsht drejtësija?
Cili virtyt âsht karakteristikë e njeriut të ndershëm?

Këtij njeriu i kanë bâ shumë padrejtësí.
Kujt i kanë bâ shumë padrejtësí?
Ç'i kanë bâ këtij njeriu?
Sa padrejtësí i kanë bâ këtij njeriu?

Nji punëtuer i mirë punon me kujdes.
Cili punëtuer punon me kujdes?
Si punon nji punëtuer i ndershëm?

Shtëpija mori zjarr nga pakujdesija e të zotit.
Çka i ngjau shtëpís nga pakujdesija e të zotit?
Nga se mori zjarr shtëpija?

b. Nga mbiemni

Të gjithë shokët e mij janë të martuem.
Shokët e kujt janë të martuem?
Cilët shokë janë të martuem?

Vllai i tij âsht i pamartuem.
Vllai i kujt âsht i pamartuem?
Kush âsht i pamartuem?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Asht e mundun që të nisemi të gjithë me aeroplan.
A âsht e mundun që të nisemi të gjithë me aeroplan?
Me se âsht e mundun që të nisemi të gjithë?
Ç'âsht e mundun të bâjmë të gjithë?

Asht e pamundun që të nisemi të gjithë me tren.
A âsht e pamundun që të nisemi të gjithë me tren?
Me se âsht e pamundun të nisemi të gjithë?
Ç'âsht e pamundun të bâjmë të gjithë?

Mishi âsht nji ushqim i nevojshëm për njeriun.
Për kë âsht mishi nji ushqim i nevojshëm?
Çfarë ushqimi âsht mishi për njeriun?

Çakmaku âsht i panevojshëm për ata që nuk e pijnë duhanin.
A âsht çakmaku i panevojshëm për ata që nuk e pijnë duhanin?
Për kë âsht çakmaku i panevojshëm?

Kur ngasim automobilin duhet të jemi të kujdesshëm.
Qysh duhet të jemi kur ngasim automobilin?
Kur duhet të jemi të kujdesshëm?

Vllai i saj âsht njerí i pakujdesshëm.
A âsht vllai i saj njerí i pakujdesshëm?
Vllai i kujt âsht njerí i pakujdesshëm?
Çfarë njeriu âsht vllai i saj?

Uji në shishe nuk âsht i mjaftueshëm për mue.
Cili ujë nuk âsht i mjaftueshëm për mue?
Për kë nuk âsht i mjaftueshëm uji në shishe?

Këto të holla janë të mjaftueshme për nji muej.
Për sa muej janë të mjaftueshme këto të holla?
Cilat të holla janë të mjaftueshme për nji muej?

Rroga që marr unë âsht e pamjaftueshme për nji familje 4 vetësh.

Cila rrogë âsht e pamjaftueshme për nji familje 4 vetësh?
Për cilën familje âsht e pamjaftueshme rroga që merr ti?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

LESSON 69
PART V
READING PART

Mjeksija në Shqipní âsht e shtetzueme; kjo do të thotë se mjekët, ndihmës mjekët, dentistët dhe infermieret janë nëpunës të shtetit; ata mund t'ushtrojnë zanatin e tyne vetëm gjatë kohës së lirë, d.m.th. jashtë orarit të punës. Dikasteri që administron shërbimet mjeksore âsht Ministrija e Shëndetsís.

Sigurimet Shoqnore Shtetnore në RPS të Shqipnís varen nga Ministrija e Financavet; ato veprojnë në bashkëpunim me Ministrín e Mbrendshme, me Ministrín e Shëndetsís dhe me Bashkimet Profesionale. Sigurimet Shoqnore Shtetnore përfshîjnë këto ndihma: (1) ndihmat mjeksore, (2) ndihmat për paaftësí të përkohshme në punë, (3) ndihmat për foshnjen mbas lindjes, (4) pensionet dhe (5) ndihmat për plotësimin e nevojavet kulturore të punëtorëvet dhe të nëpunësvet.

Ndihmat mjeksore u epen falas gjithë atyne që punojnë dhe familjarëvet të tyne; tue qenë se në Shqipní nuk ka njerëz që nuk punojnë, pothuejse i gjithë populli ka të drejtë me kërkue ndihmë mjeksore nga qendrat shëndetsore.

Ndihmat për paaftësí të përkohshme i marrin të gjithë ata punëtorë e nëpunës që bijnë të sëmundë ase vriten në punë dhe grát me barrë ca kohë para dhe mbas lindjes.

Punëtori, kur e ndien veten të sëmundë, shkon në qendrën shëndetsore dhe kërkon të vizitohet nga nji prej mjekëvet që ka atje në shërbim. Po qe se nuk âsht në

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

gjendje me ecë, atëherë thërret qendrën shëndetsore të lagjes, e cila, mbasi e pyet për simptomat e sëmundjes, i çon mjekun. Punën mâ të madhe nëpër qendrat shëndetsore, nëpër ambulanca periferike, nëpër fabrika e qendra pune e bâjnë ndihmësmjekët; këta janë t'ushtruem me shërue sëmundje të thjeshta; në konsultoret për fëmijë, ata këshillojnë nânat e reja si me rritë fëmijët.



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS-PYETJE

1. Ku âsht e shtetzueme mjeksija?
2. Tue qenë mjeksija e shtetzueme, cilët janë nëpunës të shtetit?
3. Pse janë nëpunës të shtetit mjekët, ndihmës mjekët, dentistët dhe infermieret?
4. Kur mund t'a ushtrojnë ata zanatin e tyne?
5. Cilët mund t'a ushtrojnë zanatin e tyne gjatë kohës së lirë?
6. Kur âsht "kohë e lirë" për mjekët, dentistët etj.?
7. Cili dikaster i administron shërbimet mjeksore?
8. Cilat shërbime administron Ministrija e Shëndetsís?
9. Nga cila ministrí varen Sigurimet Shoqnore Shtetnore?
10. Në bashkëpunim me cilat ministrí veprojnë Sigurimet Shoqnore Shtetnore?
11. Sa llloj ndihmash përfshîjnë Sigurimet Shoqnore Shtetnore?
12. Cilat janë 5 llojet e ndihmavet që përfshîjnë Sigurimet Shoqnore Shtetnore?
13. Çfarë llloj ndihmash u epen falas gjithë atyne që punojnë dhe familjarëvet të tyne?
14. Cilëve u epen falas ndihmat mjeksore?
15. A ka njerëz që nuk punojnë në Shqipní?
16. A ka ndonji njerí që nuk punon në Shqipní?
17. Pse pra, pothuejse i gjithë populli ka të drejtë me kërkue ndihmë mjeksore?
18. Nga cilat organizata kërkon populli ndihmë mjeksore?
19. Çfarë ndihmash marrin të gjithë ata punëtorë e nëpunës që bijnë të sëmundë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

20. Cilët i marrin ndihmat për paaftësí të përkohshme?

21. Vetëm ata që bijnë të sëmundë kanë të drejtë me marrë ndihmat e paaftësís së përkohshme?

22. Kush tjetër ka të drejtë me kërkue ndihmat e paaftësís së përkohshme?

23. Kur i marrin grât me barrë ndihmat e paaftësís së përkohshme?

24. Ku shkon punëtori kur e ndien veten të sëmundë?

25. Çka kërkon punëtori nga nji prej mjekëvet që ka në shërbim atje?

26. Çka bân punëtori kur e ndien veten të sëmundë?

27. Po qe se punëtori nuk âsht në gjendje me ecë, cilën zyrë thërret ai?

28. Ku gjindet qendra shëndetsore që thërret punëtori?

29. Në cilin rast thërret punëtori qendrën shëndetsore të lagjes së tij?

30. Për çka e pyet punëtorin qendra shëndetsore?

31. Mbasi e pyet punëtorin për simptomat e sëmundjes, çka bân qendra shëndetsore?

32. Kur i a çon mjekun punëtorit qendra shëndetsore e lagjes?

33. Kush e bân punën mâ të madhe nëpër qendrat shëndetsore?

34. Sa punë bâjnë ndihmësmjekët nëpër qendrat shëndetsore, nëpër ambulanca periferike, nëpër fabrika e qendra pune?

35. Ku e bâjnë ndihmësmjekët punën mâ të madhe?

36. Cilët janë t'ushtruem me shërue sëmundje të thjeshta?

37. Çfarë sëmundjesh janë t'ushtruem me shërue ndihmësmjekët?

38. Cilat nâna këshillojnë ata si me rritë fëmijët?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

39. Kush i këshillon nânat e reja si me rritë fëmijët?

40. Çfarë pune bâjnë ndihmësmjekët nëpër konsultore për fëmijë?



Veshje karakteristike e qytetit
të Shkodrës

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

LESSON 69
PART VI
HOMEWORK

Përkëtheni anglisht këto fjalí:

1. E pushuen nga puna për paaftësí.

2. Ka qenë në burg për bashkëpunim me anmikun gjatë luftës.

3. Qeverija u a ka dhânë misrin falas banorëvet të zonave të tërmetit.

4. I ka vdekë i ati nga sëmundja e zemrës.

5. Gjithkush e di se ai nuk merr ndonji shpërblim për punën që bân.

6. Agimi shkoi ke mjeku dhe ky, mbas ca kohe, ia shëroi plagën që kishte në kambë.

7. Ajo s'ka asnji përgjegjësí për çka ka ngjá, prandej s'ka as faj.

8. Lajmi i përhapun se ka rá sëmundja e barkut të keq n'at qytet s'âsht i vërtetë.

9. Ai ka nji punë të përkohshme, prandej s'do të martohet tash për tash.

10. Në Shqipní grueja punëtore ase nëpunëse kur âsht me barrë ka të drejtë për nji leje të pagueshme prej 12 deri në 15 javë para dhe mbas lindjes.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E SHTATË
FJALORI

LESSON 69
PART VII
VOCABULARY

aftësí, -ja aftësí, -t	(f.)	ability, capability
aktivitet, -i aktivitete, -t	(m.)	activity
ambulancë, -a ambulanca, -t	(f.)	first-aid station, infirmary, ambulance
ambulancë periferike ambulanca periferike	(f.)	suburban first-aid station
barku i keq	(m.)	dysentery
bashkëpunim, -i	(m.)	collaboration, collaborating, cooperation, cooperating
cilido	(adj. m. & pron.)	any, whoever, whichever
dentár, -e	(adj. m. & f.)	dental
ekip, -i ekipe, -t	(m.)	crew
epidemí, -ja epidemí, -t	(f.)	epidemic
falas	(adv.)	free (of charge), gratis
familjarë, -t	(m. pl.)	members of one's family
foshnje, -ja foshnje, -t	(f.)	baby
grue me barrë	(f.)	pregnant woman
javuer, javore	(adj. m. & f.)	weekly
kancer, -i	(m.)	cancer
kërkush	(pron.)	nobody

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

konsultore, konsultorja konsultore, -t	(f.)	dispensary
kontribut, -i kontribute, -t	(m.)	contribution
mamí, -ja mamí, -t	(f.)	midwife
në mes	(prep.)	between
mjekim, -i mjekime, -t	(m.)	treatment (medical)
mjeksuer, mjeksore	(adj. m. & f.)	medical
mujuer, mujore	(adj. m. & f.)	monthly
ndihmë, -a ndihma, -t	(f.)	help, aid, contribution
ndihmës, -e	(adj. m. & f.)	assistant-, auxiliary
ndihmësmjek, -u ndihmësmjekë, -t	(m.)	a physician's aid or assistant
nëpër	(prep.)	in, through, across
me njoftue (unë njoftoj)	(v.)	to notify
paaftësí, -ja paaftësí, -t	(f.)	inability, inefficiency, incapability
pension, -i pensione, -t	(m.)	pension; boarding-house
personel, -i	(m.)	personnel
përgjegjësí, -ja përgjegjësí, -t	(f.)	responsibility
i, e, të përhapun të përhapuna	(adj. m. & f.)	widespread
i, të përkohshëm e, të përkohshme	(adj. m. & f.)	temporary, provisional

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

plagë, -a plagë, -t	(f.)	wound, scar, sore
plotësim, -i	(m.)	completion, completing
rural, -e	(adj. m. & f.)	rural
me rritë (unë rris)	(v.)	to grow, raise
simptomë, -a simptoma, -t	(f.)	symptom
shëndetsí, -ja	(f.)	health; sanitation
shëndetsuer, shëndetsore	(adj. m. & f.)	medical, sanitary
me shërue (unë shëroj)	(v.)	to heal, cure
shpërblim, -i shpërblime, -t	(m.)	compensation; reward; reparations, damages
tifo, -ja	(f.)	typhus
tuberkuloz, -i	(m.)	tuberculosis
me u-ushtrue (unë ushtrohem)	(v.)	to be exercised, exerted, trained; drilled
i, t'ushtruem e, t'ushtrueme	(adj. m. & f.)	trained
zemër, zemra zemra, -t	(f.)	heart

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 70
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE

GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. Përdorimi i foljevet të formës thuhet, flitet, tregohet etj.

- me thânë:

A thonë se e kanë pushue nga puna për vjedhje?
Po, thonë se e kanë pushue nga puna për vjedhje.

Kush thotë se e kanë pushue nga puna për vjedhje?
Gjithkush thotë se e kanë pushue nga puna për vjedhje.

Për çka thonë se e kanë pushue nga puna?
Thonë se e kanë pushue nga puna për vjedhje.

- me u-thânë:

A thuhet se e kanë pushue nga puna për vjedhje?
Po, thuhet se e kanë pushue nga puna për vjedhje.

Për çka thuhet se e kanë pushue nga puna?
Thuhet se e kanë pushue nga puna për vjedhje.

- me folë:

A flasin bota për Skënder Teqen gjithfarë fjalësh së këqija?
Po, bota flasin gjithfarë fjalësh së këqija për Skënder Teqen.

Kush flet fjalë të këqija për Skënder Teqen?
Bota flasin fjalë të këqija për Skënder Teqen.

Çfarë fjalësh flasin bota për Skënder Teqen?
Bota flasin gjithfarë fjalësh së këqija për Skënder Teqen.

- me u-folë:

A fliten gjithfarë fjalësh së këqija për Skënder Teqen?
Po, për Skënder Teqen fliten gjithfarë fjalësh së këqija.

Çfarë fjalësh fliten për Skënder Teqen?
Për Skënder Teqen fliten gjithfarë fjalësh së këqija.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Për kê fliten gjithfarë fjalësh së këqija?
Për Skënder Teqen fliten gjithfarë fjalësh së këqija.

2. Përdorimi i vetes së tretë të foljevet pësore me kuptimin "âsht ase nuk âsht e mundun," "âsht ase nuk âsht zakon":

A âsht zakon me shkue në nji dasëm pa ftesë?
Jo, pa ftesë nuk âsht zakon me shkue në nji dasëm.

Ku nuk âsht zakon me shkue pa ftesë?
Në nji dasëm nuk âsht zakon me shkue pa ftesë.

Pa çka nuk âsht zakon me shkue në nji dasëm?
Pa ftesë nuk âsht zakon me shkue në nji dasëm.

A shkohet në nji dasëm pa ftesë?
Jo, pa ftesë nuk shkohet në nji dasëm.

Ku nuk shkohet pa ftesë?
Në nji dasëm nuk shkohet pa ftesë.

Pa çka nuk shkohet në nji dasëm?
Pa ftesë nuk shkohet në nji dasëm.

A âsht e mundun me udhëtue nëpër këtë krahinë në dimën?
Jo, nëpër këtë krahinë nuk âsht e mundun me udhëtue në dimën.

Ku nuk âsht e mundun me udhëtue në dimën?
Nëpër këtë krahinë nuk âsht e mundun me udhëtue në dimën.

A udhëtohet nëpër këtë krahinë në dimën?
Jo, nëpër këtë krahinë nuk udhëtohet në dimën.

Ku nuk udhëtohet në dimën?
Nëpër këtë krahinë nuk udhëtohet në dimën.

Në cilën stinë nuk udhëtohet nëpër këtë krahinë?
Nëpër këtë krahinë nuk udhëtohet në dimën.

A âsht zakon, ndër katunde, me e çue ke burri nusen më kalë?
Po, ndër katunde âsht zakon me e çue nusen ke burri më kalë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ku âsht zakon me e çue nusen ke burri më kalë?
Ndër katunde âsht zakon me e çue nusen ke burri më kalë.

A çohet nusja ke burri më kalë ndër katunde?
Po, ndër katunde nusja çohet ke burri më kalë.

Si çohet nusja ke burri ndër katunde?
Ndër katunde nusja çohet ke burri më kalë.

Ku çohet nusja ke burri më kalë?
Nusja çohet ke burri më kalë ndër katunde.



Tiranë, Xhamija e Vjetër dhe Sahati

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 70
PART II
DIALOGUE

Ushtrija Popullore Shqiptare

1. Ç'kuptoni me fjalët "Ushtrija Popullore Shqiptare"?
2. Me këtë emën njifen kolektivisht Forcat e Armatosuna: tokësore, detare dhe ajrore, si edhe Forcat Ushtarake të Sigurimit.

3. Ç'përfshîjnë Forcat Ushtarake të Sigurimit?
4. Ato përfshîjnë Rojën e Kufînit dhe Armën e Sigurimit të Shtetit, që quhet edhe Sigurimi.

5. Prej Ministrís së Mbrojtjes Popullore varen të gjitha këto?
6. Jo. Dy të fundit varen nga Ministrija e Mbrendshme, sepse janë mâ fort forca politike policore se sa ushtarake.

7. Cili âsht misioni i secilës nga këto dy degë të Forcavet t'Armatosuna?
8. Misioni i Rojës së Kufînit âsht me ruejtë kufînin, kryesisht që të mos aratisen njerëz të pakënaqun e kundershtarë të regjimit.

9. Po tjetra, due me thânë Arma e Sigurimit të Shtetit?
10. Ajo mbron regjimin nga çdo akt rezistence a sabotimi dhe nga ndonji kryengritje e armatosun; merret edhe me kundërzbulim.

11. Cila âsht njisija taktike mâ e madhe e fuqivet tokësore?
12. Brigada e kambësorís, e cila përfshîn nji regjiment artilerije dhe ca bataliona tjerë repartesh së veçanta.

13. Sa âsht efektivi i kësaj njisije?
14. Autoritetet shqiptare nuk e kanë shpallë kurrë botënisht numrin e saktë që kanë nën armë.

15. Mirëpo, sa mendohet të jetë efektivi i kësaj brigade?
16. 3000 vetë. Fuqít e sotshme ushtarake nuk besohet t'i kalojnë të 45.000 vetët, tue numrue edhe kuadrot.

17. Kam marrë vesh se ushtrija shqiptare i përshtatet organizimit taktik sovjetik. A âsht e vërtetë?
18. Ca kohë mâ parë i përshtatesh jo vetëm organizimit sovjetik, por mâ vonë edhe atij kinez.

19. A kanë grada oficerët dhe nënoficerët në Shqipní?
20. Jo, në këtë pikë ata kanë mbajtë sistemin kinez, pa grada.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 70



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 70
PART II
DIALOGUE

The Albanian People's Army

1. What do you mean by the words "the Albanian People's Army?"
2. The Armed Forces are known collectively by this name; those of land, sea and air, as well as the Security Armed Forces.

3. What do the Security Armed Forces include?
4. They include the Border (Frontier) Guard and the State Secutity which is also called the Security.

5. Are they all part of the Ministry of Defense?
6. No. The last two are under control of the Ministry of Interior, because they are mostly political police forces rather than military.

7. What is the mission of each of these two branches of the Armed Forces?
8. The mission of the Frontier Guard is to guard the border, primarily not to allow discontented citizens and opponents of the regime to flee the country.

9. What about the other one? I mean the State Security?
10. It protects the regime from any resistance or acts of sabotage and from any armed revolt; it also deals with counterintelligence.

11. What is the largest tactical unit of the land forces?
12. The infantry brigade, which comprises an artillery regiment and several other battalions of special units.

13. What's the strength of this unit?
14. The Albanian authorities have never announced publicly the exact number of men in the Armed Forces.

15. How large is this brigade thought to be?
16. It has 3,000 men. The present Armed Forces are not believed to have more than 45,000 men, counting the officers and NCOs also.

17. It is my understanding that the Albanian rmy conforms to the Soviet tactical organization. Is it true?
18. Some time ago it used to conform not only to the Soviet organization, but later, also, to that of the Chinese.

19. Do the officers and the NCOs in Albania have ranks?
20. No. On this point they have kept the Chinese system which has no ranks.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

LESSON 70
PART III
GRAMMAR ANALYSIS

1. IMPERSONAL VERBS

The present tense of reflexive or passive verbs is used both in the singular and plural for the following verbs: flitet (me u-folë), thuhet (me u-thânë), hahet (me u-hangër), pihet (me-upi), and flihet, the impersonal form of the quasi-passive voice me fjetë. They correspond to the English "it is said" or "it's a rumor" for flitet and thuhet, "one can eat" for hahet, "one can drink" for pihet, and "one can sleep" for flihet, and so on.

2. COMPOUND ADJECTIVES

Adjectives in Albanian may be formed by combining a noun with another noun, a noun with an adjective after omitting the particle, or a noun with an adverb. These types of adjectives are of high frequency in speech and oftentimes cannot be found in dictionaries. Moreover, their translation is quite often difficult. Students are encouraged to analyze their derivation in order to get the real meaning and enjoy the beauty of the expression.

Examples:

a. Adjectives formed by two nouns:

sŷ (eye)	zhgabë (eagle)	sŷzhgabë (sharp-sighted)
gojë (mouth)	mjaltë (honey)	gojëmjaltë (gentle)
buzë (lip)	gaz (laughter)	buzagaz (good natured, jolly)
zemër (heart)	gúr (stone)	zemërgúr (cold hearted; cruel)

b. Adjectives formed by a noun and an adjective:

mish (meat)	ngranës (eater)	mishngranës (carnivorous)
faqe (cheek)	e bardhë (white)	faqebardhë (successful, honorable)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

faqe (cheek)	i zí, (black) e zezë	faqezí, faqezezë (wretched, vile, dishonest)
fjalë (word)	i madh (big)	fjalëmadh (bombastic, arrogant)
lirí (freedom)	dashës (lover)	liridashës (freedom loving)

c. Adjectives formed by a noun and an adverb:

fjalë (word)	shumë (much)	fjalëshumë (chatterbox)
fjalë (word)	mirë (good)	fjalëmirë (peacemaker)
kuptim (meaning)	plot (full)	kuptimplotë (meaningful)

d. The most frequently used compound in Albanian is the noun-noun compound.

Examples:

at (father)	dhé (land)	atdhé (fatherland)
krye (head)	qytet (city)	kryeqytet (capital city)
hekur (iron)	udhë (road)	hekurudhë (railroad)
zjarm (fire)	fikës (extinguisher)	zjarmfikës (fireman)

e. Compound nouns are also formed by combining an adverb and a noun.

bashkë (together)	punim (work, working)	bashkëpunim (cooperation)
mirë (good)	sjellje (behavior, conduct)	mirësjellje (good behavior, good conduct)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 70

para (before)	thanie (saying)	parathanie (preface)
kundër (against)	zbulim (revealing)	kundërzbulim (counter-intelligence)



Ushtrija Popullore në stërvitje

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 70
PART IV
GRAMMAR DRILL

1. Përdorimi i foljevet të formës thuhet, flitet, tregohet etj.

Thuhet se atij i ka lânë i ati shumë pasuní.
Çfarë pasunije thuhet se i ka lânë i ati atij?
Kujt thuhet se i ati i ka lânë shumë pasuní?
Çka thuhet për atê?

Flitet se miku ynë kërkon me u-ndá nga e shoqja.
Nga kush flitet se kërkon me u-ndá miku ynë?
Kush flitet se kërkon me u-ndá nga e shoqja?
Çka flitet për mikun tonë?

Për nji dasëm të tillë mendohet se janë shpenzue 7500 lekë.
Sa mendohet se janë shpenzue për nji dasëm të tillë?
Për çfarë dasme mendohet se janë shpenzue 7500 lekë?
A âsht e sigurtë se janë shpenzue 7500 lekë për nji dasëm të tillë?

Kjo përrallë nuk mund të tregohet sepse âsht e ndytë.
Pse nuk mund të tregohet kjo përrallë?
Cila përrallë nuk mund të tregohet?

Ai fiton mjaft, por nuk mund të thuhet se âsht i pasun.
Kush fiton mjaft, por nuk mund të thuhet se âsht i pasun?
Për kê nuk mund të thuhet se âsht i pasun?
Megjithëse fiton mjaft, çka nuk mund të thuhet?

Javën që kaloi flitesh se do të kemi shtesë rroge.
Kur flitesh se do të kemi shtesë rroge?
Çka flitesh javën që kaloi?
Çfarë lloj shtese flitesh se do të kemi?

Dje u-fol gjatë e gjânë mbi zakonet e vendit tonë.
Kur u-fol gjatë e gjânë mbi zakonet e vendit tonë?
Mbi cilat zakone u-fol dje gjatë e gjânë?
Çka u-fol dje?

Dje u-tha se do të bisedojmë përsërí mbi këtë çashtje.
Kur u-tha se do të bisedojmë përsërí mbi këtë çashtje?
Mbi cilën çashtje u-tha dje se do të bisedojmë përsërí?
Ç'u-tha dje?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

2. Përdorimi i kompozitavet

a. **mbiemna** nga dy emna:

Nuk njof njerí mâ zemërgúr se atê.
Kush nuk njef njerí ma zemërgúr se atê?
Si çfarë njeriu e njof unë atê?
Kê njof unë si zemërgúr?

Skënderbeu ka qenë me të vërtetë zemërluan.
Si ka qenë Skënderbeu?
Kush ka qenë me të vërtetë zemërluan?
A ka qenë ai zemërluan sepse ka tregue shumë burrëní?

b. mbiemna nga nji emën dhe nji mbiemën:

Disa burra shteti janë dorëhekurt.
Kush âsht dorëhekurt?
Si janë disa burra shteti?
Cilët burra janë dorëhekurt?

Zoja Kosova âsht zemërgjânë.
Cila âsht zemërgjânë?
Si âsht Zoja Kosova?
Çfarë grueje âsht Zoja Kosova?

Ai që e ka mendjen të lehtë quhet mendjelehtë.
Qysh quhet ai që e ka mendjen të lehtë?
Pse e quejnë dikê mendjelehtë?
Si janë disa njerëz?

Disa zotní të pasun janë shumë dorëngushtë.
Si janë disa zotní të pasun?
Sa zotní të pasun janë dorëngushtë?
Çfarë zotnísh janë dorëngushtë?

Kafshët e egra quhen mishngranëse, sepse kryesisht ato hanë mish.
Cilat kafshë quhen mishngranëse?
Pse quhen kafshët e egra mishngranëse?
Çka hanë kryesisht kafshët mishngranëse?

Disa udhëheqës janë liridashës e disa tjerë gjakpirës.
Si janë disa udhëheqës?
Si janë disa tjerë?
A janë të gjithë udhëheqësit liridashës?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

c. mbiemna nga nji emën dhe nji adverb:

Unë nuk e dijshem se ai ishte shpirtkeq.
Çka nuk dijshem unë?
Kush nuk e dinte se ai ishte shpirtkeq?
Qysh ishte ai?

E kanë emnue ministër fuqiplotë.
Çka e kanë emnue atê?
Kê kanë emnue ministër fuqiplotë?
Çfarë ministri e kanë emnue?

Ai që flet pak quhet fjalëpakë.
Si quhet ai që flet pak?
Kush quhet fjalëpakë?
Zakonisht, a bân shumë gabime ai që âsht fjalëpakë?

Ajo përpiqet mjaft, por âsht fatkeqe.
Kush përpiqet mjaft, por âsht fatkeqe?
Çka bân ajo, por âsht fatkeqe?
Çka âsht ajo?
A njifni ju, Z... , ndonji njerí fatkeq?

d. emna nga dy emna:

Atdheu i parë i mësuesvet tonë âsht Shqipnija.
Cili âsht atdheu i parë i mësuesvet tonë?
Çka âsht Shqipnija?
Atdheu i parë i cilëve mësues âsht Shqipnija?

Kryetari i nji qeverije zakonisht quhet kryeministër.
Zakonisht, si quhet kryetari i nji qeverije?
Si quhet kryetari i nji qeverije zakonisht?
Ç'titull ka kryetari i nji qeverije?

Na vêmë pikëpyetje në fund të çdo fjalije, me të cilën pyesim.
Ç'vêmë na në fund të çdo fjalije, me të cilën pyesim?
Ku vêmë na pikëpyetje?
Kur e vêmë na pikëpyetjen?
Çka bâjmë na kur shkruejmë nji fjalí, me të cilën pyesim?

Ai thotë se ka shërbye si kryemjek i Spitalit të Korçës.
Kush thotë se ka shërbye si kryemjek i Spitalit të Korçës?
Si çka ka shërbye ai?
Çka thotë ai?
Në cilin qytet ka shërbye ai si kryemjek?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ata u-këthyen në vendlindje për të kalue pushimet e verës.
Ku u-këthyen ata?
Pse u-këthyen ata në vendlindje?
Çka bânë ata?
Ku do t'i kalojnë ata pushimet e verës?

Ai nuk m'a kërkoi letërnjoftimin.
Kush nuk m'a kërkoi letërnjoftimin?
Çka nuk më kërkoi ai?
Çka bâni ai?
Çfarë dokumenti nuk më kërkoi ai?

Nji pjesë e mirë e Shqipnís âsht e lidhun me hekurudhë.
Me çfarë mjet udhëtimi âsht e lidhun nji pjesë e mirë e Shqipnís?
Nji pjesë e mirë e cilit vend âsht e lidhun me hekurudhë?

Bregdeti i Shqipnís âsht nji ndër bregdetet mâ të bukura t'Adriatikut.
Bregdeti i cilit vend âsht nji ndër bregdetet mâ të bukura t'Adriatikut?
Çfarë bregdeti ka Shqipnija?



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 70
PART V
READING TEXT

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

Gjendja financiare e popullit, mungesa e zhvillimit t'industrís së rândë, sasija e kufizueme e landëvet të para etj., nuk e lejojnë Shqipnín të ketë nji ushtrí moderne të pajisun dhe t'armatosun mirë. Megjithatê, për nji vend të vogël dhe të vorfën si Shqipnija, ushtrija e saj âsht tepër e madhe: thuhet se ka nja 45.000 vetë tue numrue edhe kuadrot. Mbajtja nën armë e nji efektivi të tillë i kushton shtetit e popullit shuma të mëdhaja të hollash e materiali.

Forcat e Armatosuna të RPS të Shqipnís mbahen për dy qëllime: 1. për të mbajtë regjimin në fuqí tue e ruejtë atê nga ndonji kryengritje e armatosun e kundërshtarëvet të tij, punë që ato e kryejnë në bashkëpunim me Forcat e Sigurimit dhe, 2. për të ndihmue ndërmarrjet e ndryshme në punët e rânda të "ndërtimit të socializmit".

Në bazë të kushtetutës, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partís së Punës të Shqipnís âsht Komandant i Përgjithshëm i Forcavet t'Armatosuna.

Dy degë të Fuqivet t'Armatosuna që nuk varen nga Ministrija e Mbrojtjes Popullore janë Roja e Kufînit dhe Arma e Sigurimit të Shtetit, të cilat njifen me emnin Forcat Ushtarake të Sigurimit. Mbasi puna e tyne âsht kryesisht politike e policore, ato varen nga Ministrija e Mbrendshme.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Thuhet se ushtrija âsht e përbâme nga dy njisí të mëdhaja, ndoshta nga 15.000 vetë secila, që quhen korp-armata. Çdo korparmatë ndahet në brigada. Brigada âsht njisija taktike mâ e madhe e fuqivet tokësore. Në vija të përgjithshme Ushtrija Shqiptare u përshtatet mâ shumë kondítavet të vendit, parimi i së cilës, natyrisht, âsht vetëmbrojtja.

Përveç krenëvet ushtarakë, në kuadrin e Forcavet t'Armatosuna përfshîhen edhe komisarët politikë, të cilët janë njerzit e partís n'ato forca. Zyrtarisht ata kanë përgjegjësín e edukimit t'ushtarakëvet me ideologjín marksiste-leniniste, por në të vërtetë, tue qenë se janë njerëz të Partís, ata kontrollojnë edhe çdo veprim t'ushtrís, si edhe çdo veprimtarí t'ushtarakëvet.

Shërbimi ushtarak âsht i detyrueshëm me ligjë: 2 vjet në kambësorí dhe n'artilerí, 3 vjet n'aviacion, në marinë dhe në Rojën e Kufînit.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS-PYETJE

1. A e lejojnë Shqipnín gjendja financiare e popullit dhe mungesa e zhvillimit t'industrís së rândë të ketë nji ushtrí moderne?
2. Çka nuk e lejon Shqipnín të ketë nji ushtrí moderne?
3. Sasija e cilave landë âsht e kufizueme në Shqipní?
4. Përveç gjendjes financiare të popullit dhe mungesës së zhvillimit t'industrís së rândë, çka tjetër nuk e lejon Shqipnín të ketë nji ushtrí moderne?
5. Si âsht e pajisun dhe e armatosun nji ushtrí moderne?
6. Megjithatê, për cilin vend ushtrija e tij âsht tepër e madhe?
7. Çfarë vendi âsht Shqipnija?
8. Sa vetë ka ushtrija shqiptare tue numrue edhe kuadrot?
9. Kujt i kushton snuma të mëdhaja të hollash e materiali mbajtja e nji efektivi të tillë?
10. Çka i kushton popullit mbajtja e nji efektivi të tillë?
11. Për sa qëllime mbahen Forcat e Armatosuna të RPS të Shqipnís?
12. Për të mbajtë cilin regjim në fuqí mbahen Forcat e Armatosuna?
13. Cili âsht pra qëllimi i parë i mbajtjes së Forcavet t'Armatosuna?
14. Nga çka e ruejnë Forcat e Armatosuna regjimin?
15. Në bashkëpunim me cilat forca e kryejnë këtë punë Forcat e Armatosuna?
16. Çka bâjnë Forcat e Armatosuna në bashkëpunim me Forcat Ushtarake të Sigurimit?
17. Në cilat punë i ndihmojnë ndërmarrjet e ndryshme Forcat e Armatosuna?
18. Cili âsht pra qëllimi i dytë i mbajtjes së Forcavet t'Armatosuna?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

19. Nën komandën e kujt janë Forcat e Armatosuna të Shqipnís?

20. A varen nga Ministrija e Mbrojtjes Populiore Roja e Kufînit dhe Arma e Sigurimit të Shtetit?

21. Cilat janë dy degët e Forcavet t'Armatosuna që nuk varen nga Ministrija e Mbrojtjes Populiore?

22. Me çfarë emni njifen Roja e Kufînit dhe Arma e Sigurimit të Shtetit?

23. Puna e cilave forca âsht kryesisht politike e policore?

24. Çfarë lloj pune kanë Forcat e Sigurimit?

25. Nga cili dikaster varen Forcat e Sigurimit?

26. Nga sa njisí të mëdhaja thuhet se âsht e përbâme Ushtrija Shqiptare?

27. Sa vetë ka secila korparmatë?

28. Në çfarë njisísh ndahet korparmata?

29. Çfarë njisije âsht brigada?

30. Cila âsht njisija taktike mâ e madhe e fuqivet tokësore?

31. Në vija të përgjithshme, cila ushtrí u përshtatet konditavet të vendit dhe parimit të vetëmbrojtjes?

32. Cilit parim i përshtatet Ushtrija Shqiptare në rast lufte?

33. Përveç krenëvet ushtarakë, kush tjetër përfshîhet në kuadrin e Forcavet t'Armatosuna?

34. Në kuadrin e cilave forca përfshîhen edhe komisarët politikë?

35. Cilët janë njerëz të Partís?

36. Zyrtarisht, kush e ka përgjegjësín e edukimit t'ushtarakëvet me ideologjín marksiste-leniniste?

37. Çfarë përgjegjësije kanë komisarët politikë?

38. Në të vërtetë, a kontrollojnë ata çdo veprim t'ushtrís dhe çdo veprimtarí t'ushtarakëvet?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

39. Kê kontrollojnë komisarët politikë?

40. Ç'u kontrollojnë ata ushtrís dhe ushtarakëvet?

41. Cili shërbim âsht i detyrueshëm me ligjë në Shqipní?

42. Sa vjet zgjat shërbimi ushtarak në kambësorí dhe n'artilerí?

43. Në ç'degë t'ushtrís zgjat 2 vjet shërbimi ushtarak?

44. Po n'aviacion, në marinë dhe në Rojën e Kufînit, sa vjet zgjat shërbimi ushtarak?

45. Në cilat degë të Forcavet t'Armatosuna zgjat shërbimi ushtarak 3 vjet?



Vizatim **AGIM FAJA**

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 70
PART VI
HOMEWORK

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

A. Plotësoni fjalít që vijojnë:

1. Policija kërkon dy vetë _____ (who fled) ca ditë mâ parë dhe që po përpiqen _____ (to cross the border).

2. _____ (The counterintelligence) gjerman gjatë _____ (World War II) ka qenë i organizuem mirë.

3. Në _____ (main gate) të Ministrís kishte nji _____ (armed guard).

4. S'më kanë _____ (notified) ende zyrtarisht.

5. Nesër do të bjerë shí, por _____ (however) unë do të shkoj.

B. Përkëtheni anglisht fjalít që vijojnë:

6. Nji oficer i Rojës së Kuffînit u-aratis, sepse qe i pakënaqun nga regjimi në fuqí.

7. Herët tjera më ka lejue të shkoj, por këtherë s'e dij se pse po më pengon.

8. Vrasja qe për vetëmbrojtje, prandej u-lirue nga burgu.

9. Kjo që thoni ju âsht kundër parimevet të tija, prandej s'besoj se do t'a bâjë.

10. Ajo letër nuk përmbante asnji lajm të saktë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E SHTATË
FJALORI

LESSON 70
PART VII
VOCABULARY

akt, -i akte, -t	(m.)	act
me u-aratisë (unë aratisem)	(v.)	to flee, escape
artilerí, -ja artilerí, -t	(v.)	artillery
batalion, -i bataliona, -t	(m.)	battalion
me u-besue (unë besohem)	(v.)	to be trusted, believed
botënisht	(adv.)	publicly
brigadë, -a brigada, -t	(f.)	brigade
drejtorí, -ja drejtorí, -t	(f.)	directorate, management
efektiv, -i efektive, -t	(m.)	strength (mil.)
financiar, -e	(adj. m. & f.)	financial
forcë, -a forca, -t	(f.)	force, strength
kolektivisht	(adv.)	collectively
komisár, -i komisarë, -t	(m.)	commissar
konditë, -a kondita, -t	(f.)	condition
korparmatë, -a korparmata, -t	(f.)	corps
kryengritje, -a kryengritje, -t	(f.)	revolution, uprising

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

kryesisht	(adv.)	mainly, chiefly
kuadro, -ja kuadro, -t	(f.)	cadre; staff (specialist, manager, leader, NCOs and officers of the Armed Forces); frame
kufî, -ni kufîj, -t	(m.)	border, frontier, boundary, limit
i, të kufizuem e, të kufizueme	(adj. m. & f.)	limited
kundërshtár, -i kundërshtarë, -t	(m.)	opponent, adversary
kundërzbulim, -i	(m.)	counterintelligence
me lejue (unë lejoj)	(v.)	to allow, permit
me u-marrë (unë merrem)	(v.)	to deal with, be busy with, have an occupation or job; to be taken
me mbrojtë (unë mbroj)	(v.)	to defend, protect, shield
me u-mendue (unë mendohem)	(v.)	to think over; it's believed
mungesë, -a mungesa, -t	(f.)	lack, want, deficiency; absence, absentia
i, e, të pajisun të pajisuna	(adj. m. & f.)	equipped, endowed
i, e, të pakënaqun të pakënaquna	(adj. m. & f.)	dissatisfied, discontented
parim, -i parime, -t	(m.)	principle
me pengue (unë pengoj)	(v.)	to hinder, impede, obstruct, handicap; to pawn, mortgage

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me u-përshtatë (unë përshtatem)	(v.)	to adapt oneself, to conform
policuer, policore	(adj. m. & f.)	police-
regjiment, -i regjimente, -t	(m.)	regiment
repart, -i reparte, -t	(m.)	small unit (mil.); section
rezistencë, -a	(f.)	resistance
rojë, -a roje, -t	(f.)	guard, guardsman, sentry, watchman
sabotim, -i sabotime, -t	(m.)	sabotage, sabotaging
i, e, të saktë të sakta	(adj. m. & f.)	accurate, exact; trustworthy
sido që të jetë	(conj.)	be that as it may, however
taktik, -e	(adj. m. & f.)	tactical
tokësuer, tokësore tokësorë	(adj. m. & f.)	land-, territorial, terrestrial
vetëmbrojtje, -a	(f.)	self-defense
vijë, -a vija, -t	(f.)	line; canal, ditch, rut
zyrtarisht	(adv.)	officially
zhvillim, -i zhvillime, -t	(m.)	development

Shënime

në kuadrin e ...	in the framework of of ...

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 71
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. E pakryemja si gjendje ase veprim i përsëritun në të kaluemen:

Më dhimte kryet shumë, prandej s'shkova në festë.
Çka të dhimte që s'shkove në festë?
Kujt i dhimte kryet, prandej s'shkoi në festë?
Pse s'shkove në festë?

Shkolla ime gjindesh 5 km. larg shtëpís.
Ç'gjindesh 5 km. larg shtëpís?
Shkolla e kujt gjindesh 5 km. larg shtëpís?
Sa kilometra larg shtëpís gjindesh shkolla jote?

Nuk ndejta mâ gjatë sepse njerzit e shtëpís dojshin me fjetë.
Kush nuk ndejti mâ gjatë sepse njerzit e shtëpís dojshin me fjetë?
Pse nuk ndejte mâ gjatë?
Cilët dojshin me fjetë?
Çka dojshin me bâ njerzit e shtëpís?

Diçka kishte Agimi dje; dukesh i mërzitun.
Kush kishte dje diçka?
Pse dukesh Agimi i mërzitun?
Qysh dukesh Agimi, sepse kishte diçka?

Kur shkuem na me e pá, Fatoni kishte ethe dë forte.
Kush kishte ethe të forta kur shkuem na me e pá?
Çfarë ethesh kishte Fatoni kur shkuem na me e pá?
Kur kishte Fatoni ethe të forta?

Nuk shkova me ta sepse nuk kishem të holla.
Pse nuk shkove ti me ta?
Kush nuk shkoi me ta sepse nuk kishte të holla?
Me kê nuk shkove ti sepse nuk kishe të holla?

2. E pakryemja si zakon ase veprim i përsëritun në të kaluemen:

Dikur ai vinte shpesh me na pá.
Kur vînte ai shpesh me ju pá?
Çka bânte ai shpesh dikur?
Kê vînte ai me pá shpesh dikur?

Të shtundevet nuk rrinte në shtëpí kurrë.
Kur nuk rrinte ai në shtëpí?
Ku nuk rrinte ai të shtundevet?
Kush nuk rrinte në shtëpí të shtundevet?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 71
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. E pakryemja si gjendje ase veprim i përsëritun në të kaluemen:

Më dhimte kryet shumë, prandej s'shkova në festë.
Çka të dhimte që s'shkove në festë?
Kujt i dhimte kryet, prandej s'shkoi në festë?
Pse s'shkove në festë?

Shkolla ime gjindesh 5 km. larg shtëpís.
Ç'gjindesh 5 km. larg shtëpís?
Shkolla e kujt gjindesh 5 km. larg shtëpís?
Sa kilometra larg shtëpís gjindesh shkolla jote?

Nuk ndejta mâ gjatë sepse njerzit e shtëpís dojshin me fjetë.
Kush nuk ndejti mâ gjatë sepse njerzit e shtëpís dojshin me fjetë?
Pse nuk ndejte mâ gjatë?
Cilët dojshin me fjetë?
Çka dojshin me bâ njerzit e shtëpís?

Diçka kishte Agimi dje; dukesh i mërzitun.
Kush kishte dje diçka?
Pse dukesh Agimi i mërzitun?
Qysh dukesh Agimi, sepse kishte diçka?

Kur shkuem na me e pá, Fatoni kishte ethe dë forte.
Kush kishte ethe të forta kur shkuem na me e pá?
Çfarë ethesh kishte Fatoni kur shkuem na me e pá?
Kur kishte Fatoni ethe të forta?

Nuk shkova me ta sepse nuk kishem të holla.
Pse nuk shkove ti me ta?
Kush nuk shkoi me ta sepse nuk kishte të holla?
Me kê nuk shkove ti sepse nuk kishe të holla?

2. E pakryemja si zakon ase veprim i përsëritun në të kaluemen:

Dikur ai vinte shpesh me na pá.
Kur vînte ai shpesh me ju pá?
Çka bânte ai shpesh dikur?
Kê vînte ai me pá shpesh dikur?

Të shtundevet nuk rrinte në shtëpí kurrë.
Kur nuk rrinte ai në shtëpí?
Ku nuk rrinte ai të shtundevet?
Kush nuk rrinte në shtëpí të shtundevet?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kur vînte me më pá, na flitshim për gjâna të ndryshme.
Kur flitshim na për gjâna të ndryshme?
Për çka flitshim na kur vînte me më pá?
Çka bâjshim na kur vînte me më pá?

Kur ishem i vogël, gjyshja më donte shumë.
Kush të donte shumë kur ishe i vogël?
Sa të donte gjyshja kur ishe i vogël?
Kur të donte gjyshja shumë?
Kê donte gjyshja shumë kur ishte i vogël?

Dikur më pëlqejshin âmbëlsinat.
Kujt i pëlqejshin âmbëlsinat?
Çka të pëlqejshin tý dikur?
Kur të pëlqejshin âmbëlsinat?

Kur flitte keq për shokët e mij më bânte nervoz.
Kur flitte keq për kê më bânte nervoz?
Kê bânte ai nervoz kur flitte keq për shokët e tú?
Ç'ngjante kur ai flitte keq për shokët e tú?

Çdo herë që e pyetshem Skënderin e dinte mësimin.
Kush e dinte mësimin çdo herë që e pyetshem?
Kur e dinte Skënderi mësimin?

Né na merrte gjumi sepse hajshim shumë.
Kê merrte gjumi sepse hante shumë?
Pse na merrte né gjumi?
Ç'ngjante kur hajshim shumë?

3. E pakryemja si veprim që vazhdon në të kaluemen:

Edhe n'at kohë dinte me folë mirë shqip, por nuk flitte.
Çka dinte me bâ ai edhe n'at kohë?
Kush dinte me folë shqip mirë, por nuk flitte?

E takova, por kishte mâ se dy orë që po na pritte.
Sa orë kishte që po na pritte?
Kush po na pritte megjithëse kishin kalue dy orë?

Mësuesi i historís kujtonte se unë ishem nxânsi mâ i mirë.
Cili mësues kujtonte se ti ishe nxânsi mâ i mirë?
Çka kujtonte mësuesi i historís?
Për kê kujtonte mësuesi i historís se ishte nxânsi mâ i mirë?

N'at kohë ai ishte ende i pamartuem.
A ishte ai i pamartuem n'at kohë?
Kush ishte i pamartuem n'at kohë?
Kur ishte ai i pamartuem?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 71
PART II
DIALOGUE

PJESA E DYTË
DIALOGU

Shqipnija nga pikëpamja turistike

1. Më thuej, nga pikëpamja turistike, a paraqet Shqipnija ndonji gjâ të veçantë që i pëlqen turistit?
2. Vizitorët e huej nuk janë kursye kurrë në lëvdata kur flasin për Shqipnín si vend turistik.

3. Ku e kanë bazën lëvdatat e tyne?
4. E kemi thânë kaq herë se Shqipnija ka klimë të mirë.

5. E dij; klimë të mirë kanë edhe vendet tjera, por çka e tërheq turistin në mënyrë të veçantë?
6. Traditat e pasuna të popullit mikpritës shqiptár u pëlqejnë shumë turistëvet.

7. Për zakonet je tue folë?
8. Jo vetëm për zakonet, por edhe për veshjet, kângët, vallet e për çdo çfaqje tjetër të folklorit.

9. Për nji shkrimtár ase piktor folklori ka nji vlerë të madhe, por jo për turistin e thjeshtë.
10. Je gabim. Edhe turistit të thjeshtë i pëlqen mënyra e jetesës në vendin tonë.

11. A mund të më flasish pak mbi banesat?
12. Pse jo! Qytetet, por veçanërisht vendet malore, ruejnë edhe sot stilin arkitektural të mesjetës.

13. Cili âsht tipi i shtëpís që shërben si model për këto banesa?
14. Asht kulla. Kjo âsht nji lloj fortese për sigurimin e familjes.

15. A kanë zbukurime të mbrendshme kullat?
16. Jo, shtëpít në fushë i kanë ato, si p.sh. dyert, dollapët e tavani janë të gdhenun me mjeshtrí të rrallë.

17. Po për veshjet kombëtare, ç'di me më thânë?
18. E ku t'i a filloj mâ parë? Çdo krahinë ka veshjet e veta kombëtare.

19. Cilat janë veshjet mâ të zakonshme?
20. Tirqit, xhubleta, guna, fustanella dhe qeleshja.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 71



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 71
PART II
DIALOGUË

PJESA E DYTË
DIALOGU

Albania from the Tourist Point of View

1. Tell me, does Albania, from the tourist point of view, present any special aspect that pleases the tourist?
2. The foreign visitors have never spared praise when they talk about Albania as a tourist country.

3. What is the foundation of their praise?
4. We have said so many times that Albania has a good climate.

5. I know that. Other countries have a good climate also, but what especially attracts the tourists?
6. The tourists are very much pleased with the rich traditions shown by the hospitable Albanian people.

7. Are you talking about the customs?
8. Not only about the customs, but also about the costumes, songs, dances and about any other aspect of folklore.

9. Folklore has great value for a writer or painter, but not for an ordinary (plain) tourist.
10. You are wrong. Even the ordinary (plain) tourist likes the way of life in our country.

11. Can you speak a little about the dwellings?
12. Why not? The cities, especially the mountainous areas, preserve even today the medieval architecture.

13. What is the usual type of these houses?
14. The two-story house. It's sort of a fort, for the security of the family.

15. Do these houses have interior decorations?
16. No, only the houses in the plains have decorations. For example the doors, the cabinets and ceilings are carved with a singular skill.

17. What do you know about national costumes?
18. Where shall I begin? Each region has its own costumes.

19. What are the most common costumes?
20. The trousers, the xhubleta which is a heavy ornate woolen skirt, the cloak, the fustanella and the white cap.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

LESSON 71
PART III
GRAMMAR ANALYSIS

THE USE OF THE IMPERFECT TENSE

We have dealt with the imperfect in Lesson 32, this time another effort will be made to complete and reinforce the extensive usage of the imperfect.

The imperfect tense has three important uses:

1. To describe a physical or mental condition of the past, a state of being.

Examples:

Dje ishem në bibliotekë gjithë mbasdreken.
Yesterday, I was in the library the whole afternoon.

Ajo ishte e sëmundë kur foli me mue.
She was sick when she talked to me.

N'at kohë im åt gjindesh në spital.
At that time my father was in the hospital.

Nuk ndejta mâ gjatë sepse ai donte me fjetë.
I did not stay any longer because he wanted to go to sleep.

Ti mendojshe ndryshe kur u-martove.
You thought differently when you got married.

2. To describe a habitual or repeated action in an indefinite past time, which may often, but not always, be translated by using "used to."

Examples:

Ai vînte shpesh me na på, por telefononte mâ parë.
He used to come to see us often, but he would call first.

Të shtundevet nuk rrinte kurrë në shtëpí.
On Sundays he never stayed home.

Më flitte për t'án gjithsaherë takoheshim.
He would talk about his father every time we met.

Kur shkojshem ke gjyshja, ajo më falte sheqerna.
When I used to go to my grandmother, she would give me candy.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kur flitshem për të birin më shikonte i çuditun.
He would look at me amazed every time I talked about his son.

3. To describe an action that had been going on, one that lasted at a given moment in the past.

Examples:

N'at kohë ai dinte shqip, por nuk flitte.
At that time he knew how to speak Albanian, but he wouldn't speak (it).

Kishte më se dy orë që po na pritte.
He had been waiting for us for more than two hours.

Vjet, nuk mendojshem se do të më shkonte puna kaq keq.
Last year I didn't think that things would go so wrong.

Nuk e bleva sepse nuk më rrinte mirë.
I did not buy it because it did not fit me well.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 71
PART IV
GRAMMAR DRILL

1.

Unë ishem i sëmundë kur u-hapën shkollat.
A ishem unë i sëmundë kur u-hapën shkollat?
Kush ishte i sëmundë kur u-hapën shkollat?
Kur ishem unë i sëmundë?
Si ishem unë kur u-hapën shkollat?

Nuk kishte të holla me vete.
A kishte të holla me vete?
Çka s'kishte me vete?
Kush nuk kishte të holla me vete?

Ishte nji shtëpí dykatshe me shumë dritore.
A ishte nji shtëpí dykatshe me shumë dritore?
Çfarë shtëpije ishte?
Ishte nji shtëpí dykatshe me sa dritore?

Ata kujtojshin se ajo ishte shqiptare.
A kujtojshin ata se ajo ishte shqiptare?
Cilët kujtojshin se ajo ishte shqiptare?
Ç'kujtojshin ata?

Lumi kalonte shumë afër fshatit.
A kalonte lumi shumë afër fshatit?
Ç'kalonte shumë afër fshatit?
Ku kalonte lumi?
Sa afër fshatit kalonte lumi?

Ai ishte fëmijë kur mbarova unë shkollën.
A ishte ai fëmijë kur mbarova unë shkollën?
Kush ishte fëmijë kur mbarova unë shkollën?
Ç'ishte ai kur mbarova unë shkollën?

Shpeshherë punojshem edhe dhetë orë në ditë.
A punojshem shpeshherë edhe dhetë orë në ditë?
Kush punonte shpeshherë edhe dhetë orë në ditë?
Çka bâjshem shpeshherë?
Kur punojshem edhe dhetë orë në ditë?

Vllai i tij kishte nji dyqan të vogël ku ndreqte orë.
A kishte vllai i tij nji dyqan të vogël ku ndreqte orë?
Kush kishte nji dyqan të vogël ku ndreqte orë?
Vllai i kujt kishte nji dyqan të vogël ku ndreqte orë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

S'më njifte se kush ishem.
A më njifte se kush ishem?
Kush s'më njifte se kush ishem?
Kê s'njifte se kush ishte?

Të gjithë ishin t'armatosun me armë moderne.
A ishin t'armatosun të gjithë me armë moderne?
Cilët ishin t'armatosun me armë moderne?
Me çfarë armësh ishin t'armatosun të gjithë?

Dyqani i babës tim ishte në rrugën "Adriatik"?
A ishte dyqani i babës tim në rrugën "Adriatik"?
Dyqani i kujt ishte në rrugën "Adriatik"?
Në ç'rrugë ishte dyqani i babës tim?

Të tre ishim në të njâjtën klasë.
A ishim të tre në të njâjtën klasë?
Cilët ishin në të njâjtën klasë?
Në ç'klasë ishim të tre?

Fatoni ishte në gjendje të bânte çdo llloj pune.
A ishte Fatoni në gjendje të bânte çdo llloj pune?
Ç'punë ishte në gjendje të bânte Fatoni?
Kush ishte në gjendje të bânte çdo llloj pune?
Çfarë pune ishte në gjendje të bânte Fatoni?

Nuk e mora vesh se prej nga ishte.
A e mora vesh se prej nga ishte?
Kush nuk e mori vesh se prej nga ishte?
Ç'nuk mora vesh?

Mâ parë nënshkruente mâ se 200 letra në ditë.
A nënshkruente mâ parë mâ se 200 letra në ditë?
Çka bânte mâ parë?
Sa letra nënshkruente në ditë mâ parë?
Kur nënshkruente ai mâ se 200 letra në ditë?

Flitte shqip mâ mirë se anglisht.
A flitte shqip mâ mirë se anglisht?
Ç'gjuhë flitte mâ mirë se anglisht?
Qysh flitte shqip?

Të gjithë e respektojshin mbasi ishte mâ i vjetër.
A e respektojshin të gjithë mbasi ishte mâ i vjetër?
Cilët e respektojshin mbasi ishte mâ i vjetër?
Kê respektojshin të gjithë mbasi ishte mâ i vjetër?
Pse e respektojshin të gjithë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kur ishte i pamartuem banonte afër nesh.
A banonte afër nesh kur ishte i pamartuem?
Kur banonte afër nesh?
Ku banonte kur ishte i pamartuem?
Afër kujt banonte kur ishte i pamartuem?

Im ât shkruente me dorën e majtë, por hante me të djathtën.
A shkruente im ât me dorën e majtë, por hante me të djathtën?
Çka bânte im ât me dorën e majtë?
Me ç'dorë shkruente e me ç'dorë hante im ât?
Kush shkruente me dorën e majtë, por hante me të djathtën?

N'at kohë nuk njifeshim me njâni-tjetrin.
A njifeshim n'at kohë me njâni-tjetrin?
Kur nuk njifeshim me njâni-tjetrin?
Me kê nuk njifeshim n'at kohë?

Nuk studjonte kurrë të premtevet mbrâma.
A studjonte ndonji herë të premtevet mbrâma?
Kur nuk studjonte?
Çka nuk bânte të premtevet mbrâma?

Kur kalojshem para dyqanit të saj gjithmonë shikojshem mbrendë.
A shikojshem gjithmonë mbrendë kur kalojshem para dyqanit të saj?
Ç'bâjshem gjithmonë kur kalojshem para dyqanit të saj?
Kur kalojshem para cilit dyqan gjithmonë shikojshem mbrendë?

Nuk lejojshin njerí të hŷnte mbrendë pa biletë.
A lejojshin njerí të hŷnte mbrendë pa biletë?
Kê nuk lejojshin të hŷnte mbrendë pa biletë?
Ku nuk lejojshin njerí të hŷnte pa biletë?

Djali gëzohesh shumë kur i falshem ndonji peshqesh të vogël.
A gëzohesh shumë kur i falshem ndonji peshqesh të vogël?
Ç'ngjante kur i falshem ndonji peshqesh të vogël?
Kush gëzohesh shumë kur i falshem ndonji peshqesh të vogël?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

S'munda të vîj sepse më dhimte kryet.
Kush s'mundi të vîjë sepse i dhimte kryet?
Pse s'munda të vîj?
Çka s'munda të bâj sepse më dhimte kryet?

Mue më pëlqente me udhëtue me autobus.
A të pëlqente me udhëtue me autobus?
Kujt i pëlqente me udhëtue me autobus?
Çka të pëlqente tý?

S'kishin kohë të hajshin drekë me né.
A kishin kohë të hajshin drekë me né?
Çka s'kishin kohë të bâjshin?
Me kê s'kishin kohë të hajshin drekë?



Dasëm në Shkodër, vepër e piktorit
K. Idromeno (shek. XIX)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

LESSON 71
PART V
READING TEXT

Shqipnija âsht nji nga shtetet mâ të vogla t'Evropës, por nga pikëpamja turistike paraqet nji interes të veçantë. Pothuej të gjithë vizitorët e huej e kanë çmue si të tillë dhe nuk janë kursye në lëvdata që e kanë bazën në bukurín e vendit, në traditat karakteristike të popullit mikpritës shqiptár, në monumentet e shumta dhe me vlerë të madhe për sa i përket historís. Qe disa nga këto lëvdata: "Shqipnija âsht vend turistik i klasës së parë, âsht "kopsht me gjithfarë lulesh", âsht "margaritár turistik".

Traditat e pasuna të popullit shqiptár, tue përfshî zakonet, veshjet, kângët, vallet e çdo çfaqje tjetër të folklorit kanë vlerë të madhe jo vetëm për shkrimtarin ase poetin, por edhe për turistin e thjeshtë.

Qytetet dhe sidomos vendet malore ruejnë edhe sot stilin arkitektural të mesjetës. Tipi i shtëpís që shërben si model për këto banesa âsht "kulla". Kulla ka pamjen e nji fortese dhe në të vërtetë ishte nji fortesë e vogël që mbronte nga anmiku të zotin e shtëpís dhe njerzit e vet. Kulla âsht nji ndërtesë dykatshe; kati i dytë ka dritore të vogla e të ngushta, që në mesjetë shërbejshin sa për të nxjerrë pushkët e për të luftue kundër anmikut. Ndërsa njerzit e shtëpís

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

banojnë në katin e dytë, kati i parë përdoret për të mbajtë bagëtín e kafshët tjera shtëpijake. Natyrisht, këto shtëpí janë të ndërtueme me gurë dhe s'kanë zbukurime të mbrendshme. Përkundrazi, shtëpít në fushë kanë zbukurime të tilla, si p.sh. dyert, dollapët dhe tavani janë të gdhenun me mjeshtrí të rrallë.

Veshjet kombëtare të popullit shqiptár janë ndër mâ të pasunat n'Evropë. Tue qenë se pothuej çdo krahinë ka veshjet e veta âsht e pamundun që të flasim për të gjitha. Tirqit në Shqipnín e Veriut, fustanella në Shqipnín e Jugut dhe qeleshja janë baza e veshjevet kombëtare në Shqipní.

Kostume të shfaqjes së operas «Skanderbeg»



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS-PYETJE

1. Cili shtet âsht nji nga shtetet mâ të vogla t'Evropës?
2. Çfarë interesi paraqet Shqipnija nga pikëpamja turistike?
3. Nga cila pikëpamje paraqet Shqipnija nji interes të veçantë?
4. Kush e ka çmue Shqipnín si të tillë, d.m.th. që paraqet nji interes të veçantë nga pikëpamja turistike?
5. Si e kanë çmue Shqipnín të gjithë vizitorët e huej?
6. Cilët nuk janë kursye në lëvdata për Shqipnín si vend turistik?
7. A e kanë bazën lëvdatat e tyne në bukurín e vendit?
8. Ku e kanë bazën lëvdatat e vizitorëvet të huej?
9. A e kanë bazën lëvdatat e tyne edhe në traditat karakteristike të popullit mikpritës shqiptár?
10. Në cilat tradita e kanë bazën lëvdatat e vizitorëvet të huej?
11. Ku tjetër e kanë bazën lëvdatat e vizitorëvet të huej?
12. Cilat janë disa nga lëvdatat e vizitorëvet të huej?
13. Simbas lëvdatavet të vizitorëvet të huej, çfarë vendi turistik âsht Shqipnija?
14. Çfarë kopshti âsht Shqipnija?
15. Cili vend âsht margaritár turistik simbas vizitorëvet të huej?
16. Traditat e pasuna të cilit popull kanë vlerë të madhe?
17. Çfarë vlere kanë traditat e pasuna të popullit shqiptár?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

18. A kanë traditat vlerë të madhe vetëm për shkrimtarin dhe poetin?

19. Për kê tjetër kanë vlerë të madhe traditat e pasuna të popullit shqiptár?

20. Çka përfshîjnë traditat e popullit shqiptár?

21. Për cilët turistë pra kanë vlerë të madhe zakonet, veshjet, kângët, vallet e çdo çfaqje tjetër e folklorit?

22. Cilat vende ruejnë edhe sot stilin arkitektural të mesjetës?

23. Çfarë stili ruejnë edhe sot qytetet dhe sidomos vendet malore?

24. Cili âsht tipi i shtëpís që shërben si model për këto banesa?

25. Pamjen e çfarë lloj ndërtese ka kulla?

26. Cila ndërtesë ka pamjen e nji fortese?

27. Dhe në të vërtetë, a ishte kulla në mesjetë nji fortesë e vogël?

28. Kê mbronte kulla nga anmiku?

29. Nga kush e mbronte kulla të zotin e shtëpís dhe njerzit e vet?

30. Sa katshe âsht kulla?

31. Cili kat ka dritore të vogla e të ngushta?

32. Për çka shërbejshin dritoret e vogla e të ngushta?

33. Kundër kujt luftonte i zoti i shtëpís mbasi nxirte pushkën në dritoret e vogla të katit të dytë?

34. Çka bânte i zoti i shtëpís kur donte me luftue kundër anmikut?

35. Në cilin kat banojnë njerzit e shtëpís?

36. Për çka përdoret kati i parë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

37. Ku banojnë njerzit e shtëpís dhe ku mbahen kafshët shtëpijake?

38. Me çka janë të ndërtueme këto shtëpí, d.m.th. kullat?

39. A kanë zbukurime të mbrendshme kullat?

40. Cilat shtëpí kanë zbukurime të mbrendshme?

41. Cilat pjesë të shtëpís janë të gdhenuna me mjeshtrí të rrallë?

42. Si janë të gdhenuna dyert, dollapët dhe tavani?

43. Cilat veshje janë ndër mâ të pasunat n'Evropë?

44. A ka pothuej çdo krahinë veshjet e veta?

45. Për cilat veshje âsht e pamundun të flasim?

46. Cila âsht baza e veshjevet kombëtare në Shqipnín e Veriut?

47. Ku përdoret fustanella?

48. Çka vênë në krye shqiptarët?



Monument kulti i shekullit XI në Berat (pas restaurimit)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 71
PART VI
HOMEWORK

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

Përshkrueni shkurtimisht (100-130 fjalë) krahinën në të cilën jeni rritë, me çka merren banorët, ç't'ardhuna ka krahina dhe ç'gjâ të veçantë paraqet për nji turist etj.



At Gjergj Fishta, poet e dramaturg
(1871-1940)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E SHTATË
FJALORI

LESSON 71
PART VII
VOCABULARY

arkitektural, -e	(adj. m. & f.)	architectural
bukurí, -ja bukurí, -t	(f.)	beauty
çfaqje, -a çfaqje, -t	(f.)	performance; expression; feature, aspect
me çmue (unë çmoj	(v.)	to estimate, assess; esteem; appreciate
dollap, -i dollapë, -t	(m.)	cupboard, cabinet
folklor, -i	(m.)	folklore
fortesë, -a fortesa, -t	(f.)	fortress
fustanellë, -a fustanella, -t	(f.)	kilt; skirt
i, e, të gdhenun të gdhenuna	(adj. m. & f.)	carved, sculptured
gunë, -a guna, -t	(f.)	cloak, cape
interes, -i interesa, -t	(m.)	interest
jetesë, -a	(f.)	living, livelihood
kângë, -a kângë, -t	(f.)	song
kullë, -a kulla, -t	(f.)	country house (two-to three-stories high)
me u-kursye (unë kursehem)	(v.)	to do one's utmost; to be saved, spared
lëvdatë, -a lëvdata, -t	(f.)	praise; boasting
margaritár, -i margaritarë, -t	(m.)	pearl

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

mesjetë, -a	(f.)	Middle Ages
mikpritës, -e	(adj. m. & f.)	hospitable
monument, -i monumente, -t	(m.)	monument
piktor, -i piktorë, -t	(m.)	painter (artist)
pushkë, -a pushkë, -t	(f.)	rifle
qeleshe, qeleshja qeleshe, -t	(f.)	white Albanian cap
shkrimtár, -i shkrimtarë, -t	(m.)	writer
tip, -i tipe, -t	(m.)	type
tirq, tirqit	(m. pl.)	trousers (tight-fitting pants made of wool)
traditë, -a tradita, -t	(f.)	tradition
valle, vallja valle, -t	(f.)	folk dance
vizitor, -i vizitorë, -t	(m.)	visitor
vlerë, -a vlera, -t	(f.)	value
xhubletë, -a xhubleta, -t	(f.)	a heavy, ornate woolen skirt
zbukurim, -i zbukurime, -t	(m.)	decorating, enhancing, ornament, decoration, adornment, embellishment

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 72
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. Emna veprues (nomina agentis):

a. Mësuesi: me nxânë
Nji njerí që nxên quhet nxânës.

Si quhet nji njerí që drejton diçka?
Nxânsi: Ai njerí quhet drejtues.

Si quhet nji njerí që flet në radio ase në nji konferencë?
Quhet folës.

Si quhet nji njerí që shërben?
Quhet shërbyes.

Si quhet nji njerí që merr nji letër?
Quhet marrës.

Si quhet nji njerí që dërgon nji letër?
Quhet dërgues.

Si quhet nji njerí që fiton diçka?
Quhet fitues.

Si quhet nji njerí që përfaqëson dikë?
Quhet përfaqësues.

b. Mësuesi t'api foljen dhe nxânsi emnin veprues.

me mbrojtë	mbrojtës
me lexue	lexues
me ndigjue	ndigjues
me ngarkue	ngarkues
me ftue	ftues
me vizitue	vizitues
me veprue	veprues
me ruejtë	ruejtës
me përkëthye	përkëthyes

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me blé	blés
me përndá	përndás
me pyetë	pyetës
me zgjedhë	zgjedhës

2. Mbiemna:

Mësuesi: Si quhet nji maqinë që qep?
Nxânsi: Quhet maqinë qepëse.

Si quhet diçka që tërheq?
Quhet tërheqëse.

Si quhet diçka që kap?
Quhet kapëse.

Si quhet skuadra që ka fitue nji lojë?
Quhet skuadra fituese.

Si quhet nji brisk që rruen?
Quhet brisk rrues.

Si quhet nji sëmundje që mund t'i ngjitet dikujt?
Quhet sëmundje ngjitëse.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 72
PART II
DIALOGUE

Artizanati e arkitektura

1. Në ç'fushë t'artizanatit dallohen shqiptarët?
2. N'argjendarí e kryesisht në filigran; këtë lloj pune argjendarët shqiptarë e bâjnë me mjeshtrí të madhe.

3. Çfarë lloj punimesh bâjnë ata me argjend?
4. Kryesisht zbukurime grash, por edhe burrash, si kutí cingaresh etj.

5. A ka tjera aktivitete në fushën e artizanatit përveç argjendarís?
6. Po, ka; punimet e mëndafshta dhe punimet e drunit janë ndër mâ të rândësishmet.

7. Cilat janë veglat muzikore mâ në përdorim?
8. Lahuta e çiftelija; si e dini, kângët tona janë kryesisht kângë trimnije.

9. Po n'arkitekturë, a ka vepra arti me rândësí?
10. Po, ka ca ura të kohës së mesjetës, ca kisha e ca xhamí të shekullit XVIII.

11. A ka Tirana ndonji gjâ interesante?
12. Në Tiranë gjindet Muzeu Arkeologjik, ku janë mbledhë sende të ndryshme qysh nga koha paleolitike.

13. Kam lexue se pothuej çdo qytet në Shqipní ka nji kalá. A âsht e vërtetë?
14. Po, âsht e vërtetë?

15. Cila âsht kalaja mâ e famshme?
16. Kalaja e Krujës, sepse këtu ka luftue Skënderbeu kundër ushtrivet të Perandorís Turke.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 72



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 72
PART II
DIALOGUE

Craftsmanship and Architecture

1. In what field of craft do the Albanians distinguish themselves?
2. As silversmiths and primarily in filigree; the Albanian silversmiths do this type of work with great skill.

3. What kind of work do they do with silver?
4. Primarily ornaments for women, but also for men, such as cigarette boxes, etc.

5. Is there any other field in the realm of craftsmanship besides working in silver and gold?
6. Yes, there is. Silk handiwork and woodwork are among the most important.

7. What musical instruments are mostly used?
8. The lute and the two-stringed lute. As you know our songs are primarily heroic songs.

9. What about architecture, is there any important artistic work?
10. Yes, there are some medieval bridges, some churches and mosques of the 18th century.

11. Does Tirana have any interesting features?
12. The Archeological Museum is located in Tirana and things from the paleolithic era are found here.

13. I have read that almost every city in Albania has a fortress. Is it true?
14. Yes, it's true.

15. Which fortress is the most famous one?
16. Kruja fortress, because here Scanderbeg fought against the armies of the Turkish Empire.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

LESSON 72
PART III
GRAMMAR ANALYSIS

1. AGENT NOUNS

The basic ending of an agent noun is -s for the masculine and -se for the feminine, which corresponds to the suffix of the English language -er. These endings are attached:

a. to the participle:

Examples:

me ndigjue (to hear)	ndigjues, ndigjuese (listener)
me folë (to speak	folës, folëse (speaker, relator)
me shpërblye (to reward)	shpërblyes, shpërblyese (redeemer)
me vrá (to kill)	vrasës, vrasëse (murderer)
me marrë (to receive)	marrës, marrëse (receiver, addressee)
me dërgue (to send)	dërgues, dërguese (sender)

b. to another noun in the indefinite form:

Examples:

ndihmë (help)	ndihmës, ndihmëse (helper, assistant)
mullî (flour mill)	mullîs (miller)
vend (place, country)	vendës, vendëse (native, local)

2. ABSTRACT AND COLLECTIVE NOUN DERIVATIVES

Abstract and collective nouns are formed from nouns or adjectives by attaching the suffix -si or -ni to them. These abstract nouns correspond usually to the English nouns ending in -ness or -ity.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Examples:

komb (nation)	kombësí (nationality)
burrë (man)	burrëní (manliness, valor, bravery)
i madh (big, great)	madhësí (bigness, size)
i trashë (thick)	trashësí (thickness)
i përpikët (precise)	përpikëní (precision, exactness)

3. PREFIXES

Most prefixes are in origin either prepositions or adverbs. The following are the most important and widely used ones.

Prefix	Meaning	English equivalent	Examples
bashkë	together	co- con- fellow-	bashkëpunim (cooperation) bashkëfjalim (conversation) bashkatdhetár (fellow-countryman)
ish	was	ex-(former)	ish-ministër (ex-secretary)
jashtë	outside	extra-	i jashtëzakonshëm (unusual, extraordinary)
kundër	against	counter- contra-	kundërsulm (counterattack) kundërshtim (contradiction)
ndër	between, among	inter-	ndërkombëtár (international)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Prefix	Meaning	English Equivalent	Examples
nën	under	under- sub- vice-	nënvizoj (underline) nëndetse (submarine) nënpresident (vice-(president)
para	before	fore- pre- pro-	me parapá (to foresee) parafjalë (preposition) me paraqitë (to introduce, to present) parapagesë (prepayment)
tej	beyond	trans- sur-	i tejpashëm (transparent) me tejkalue (to surpass) tejkalim (surpassingness)
mos	not, don't	mis- dis- in-	mosmarrëveshje (misunderstanding) mosmarrëveshje (disagreement) mosbarazim (inequality)
pa	without	un- dis- in-	padrejtësí (unjustness, injustice) i pabesë (disloyal) i pakrahasueshëm (incomparable)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 72
PART IV
GRAMMAR DRILL

1. Emna veprues që mbarojnë me -s:

a. nga pjesorja:

me dërgue - dërgues

Dërguesi i kësaj letre nuk e paska shkrue emnin e tij në zarf.
Ku nuk e paska shkrue emnin e tij dërguesi i kësaj letre?
Çka nuk paska bâ dërguesi i kësaj letre?
Kush nuk e paska shkrue emnin e tij në zarf?

me përfaqësue - përfaqësues

Përfaqësuesi i vendit tonë u-nis dje për Evropë.
Kush u-nis dje për Evropë?
Për ku u-nis dje përfaqësuesi i vendit tonë?
Ç'bâni dje përfaqësuesi i vendit tonë?

me mësue - mësues

Shumica e mësuesvet të këtij instituti kanë lé jashtë SHBA.
Sa mësues të këtij instituti kanë lé jashtë SHBA?
Ku kanë lé shumica e mësuesvet të këtij instituti?
Jashtë cilit vend kanë lé shumica e mësuesvet të këtij instituti?

me ndigjue - ndigjues

S'qenë shumë ndigjues kur foli drejtori.
Sa ndigjues qenë kur foli drejtori?
Kur s'qenë shumë ndigjues?
A qenë shumë apo pak ndigjues kur foli drejtori?

me përkëthye - përkëthyes

Lule Bardhoku âsht përkëthyese e mirë.
Kush âsht përkëthyese e mirë?
Çfarë përkëthyesje âsht Lule Bardhoku?
Ç'punë bân ajo?

me përndá - përndás

N'Amerikë përndasi i fut letrat në kutín e postës.
Kush i fut letrat në kutín e postës n'Amerikë?
Në cilin vend i fut përndasi letrat në kutín e postës?
Çka bân përndasi n'Amerikë?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me vrá - vrasës

Policija nuk ka mundë me e arrestue vrasësin ende.
Çka nuk ka mundë me bâ ende policija?
Kê nuk ka mundë me arrestue ende policija?
Kush nuk ka mundë me e arrestue ende vrasësin?

me blé - blés

Kur s'ka blés, s'ka punë, natyrisht.
A ka punë kur s'ka blés?
Çka ndodh kur nuk ka blés?
Kur s'ka punë?

me shitë - shitës

Rexhep Domi âsht nji shitës që s'të gënjen.
Kush âsht nji shitës që s'të gënjen?
Çfarë shitësi âsht Rexhep Domi? (i ndershëm)
Ç'punë bân Rexhep Domi?

me nxânë - nxânës

Të gjithë nxânsit tonë kanë lé në SHBA.
Ku kanë lé të gjithë nxânsit tonë?
Sa prej nxânësvet tonë kanë lé në SHBA?
Në ç'vend kanë lé të gjithë nxânsit tonë?

me folë - folës

Disa folës të radiove flasin shumë shpejt.
Sa folës të radiove flasin shumë shpejt?
Ç'bâjnë disa folës të radiove?
Kush flet shumë shpejt?

me kapë - kapëse

Rrobet në litár mbahen me kapëse, përndryshe bijnë përdhé.
Me çka mbahen rrobet në litár?
Pse mbahen me kapëse rrobet në litár?
Ç'ndodh në qoftë se nuk i mbajmë rrobet me kapëse në litár?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

b. nga nji emën i paskajuem:

vend - vendës

Njerzit që lejnë dhe jetojnë në të njâjtin vend quhen vendës ase vendas.
Cilët quhen vendës ase vendas?
Si quhen njerzit që lejnë dhe jetojnë në të njâjtin vend?
A jeni ju vendës, apo keni ardhë (jeni ardhës ase i ardhun) nga ndonji shtet tjetër, Z....?

ndihmë - ndihmës

Mbas nji gjymës ore mrrijti ndihmësprokurori.
Kush mrrijti mbas nji gjymës ore?
Kur mrrijti ndihmësprokurori?
Mbas sa kohe mrrijti ndihmësprokurori?

gjykatë - gjykatës

Thonë se Arbën Laçi âsht gjykatësi mâ i rí n'at qytet.
Kush thotë se Arbën Laçi âsht gjykatësi mâ i rí n'at qytet?
Ç'detyrë ka Arbën Laçi?
Në cilin qytet âsht ai gjykatësi mâ i rí?

2. Emna abstraktë dhe kolektivë që mbarojnë me:

a. -sí

popull - popullsí dhe bujk - bujqësí

Pak mâ shumë se 50% e popullsís së Shqipnís merret me bujqësí.
Me çka merret pak mâ shumë se 50% e popullsís së Shqipnís?
Ç'pjesë e popullsís së Shqipnís merret me bujqësí?
Në ç'vend merret me bujqësí mâ shumë se 50% e popullsís?

komb - kombësí

Në mësimet e para mësuesit na pyetshin shpesh: "Ç'kombësije jeni?"
Cilët na pyetshin shpesh: "Ç'kombësije jeni?"
Si na pyetshin mësuesit në mësimet e para?
Kur na pyetshin mësuesit "Ç'kombësije jeni?"

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

përgjegje - përgjegjësí

Ajo s'ka përgjegjësí për atê që ngjau.
A ka përgjegjësí ajo për atê që ngjau?
Kush s'ka përgjegjësí për atê që ngjau?
Për çka s'ka përgjegjësí ajo?

shëndet - shëndetësí

Ministrija e Shëndetësís kujdesohet për shëndetin e popullit.
Cila ministrí kujdesohet për shëndetin e popullit?
Për çka kujdesohet Ministrija e Shëndetësís?
Çka bân Ministrija e Shëndetësís për shëndetin e popullit?

mjek - mjeksí

N'Anglí mjeksija âsht e shtetzueme.
Ku âsht e shtetzueme mjeksija?
Çka âsht e shtetzueme n'Anglí?
Çka i kanë bâ mjeksís n'Anglí?

shtet - shtetësí

Shumica e shqiptarëvet t'Amerikës janë me shtetësí amerikane.
Shumica e shqiptarëvet të cilit vend janë me shtetësí amerikane?
Sa shqiptarë kanë shtetësín amerikane n'Amerikë?
Simbas mendimit tuej, Z. ..., a mund të ketë nji njerí dy shtetësí?

mik (miq) - miqësí

E njof, por nuk kam miqësí me tê.
Kush e njef, por nuk ka miqësí me tê?
Kê njef ai, por nuk ka miqësí me tê?
Çka nuk ka ai me tê?

mal - malsí (highland)

Nji krahinë malore quhet malsí.
Si quhet nji krahinë malore?
Çfarë krahine quhet malsí?
A jeni ju nga qyteti apo nga malsija, Z. ...?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

b. -ní

zot - zotní

Ai zotní do të ju marri në pyetje.
Kush do të ju marri në pyetje?
Kê do të marri në pyetje ai zotní?
Çka do të bâjë ai zotní?

burrë - burrëní

Shqiptarët i përmend historija për besë, ndér e burrëní.
Cilët i përmend historija për besë, ndér e burrëní?
Për çka i përmend historija shqiptarët?
Përveç besës e nderit, edhe për çka tjetër i përmend historija shqiptarët?

trim - trimní

Kalât e kângët e trimnís na kujtojnë luftat kundër anmiqvet.
Çka na kujtojnë kalât dhe kângët e trimnís?
Çfarë luftash na kujtojnë kalât dhe kângët e trimnís?
Kujt ia kujtojnë kalât e kângët luftat e trimnís?





Punime druni

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 72
PART V
READING TEXT

PJESA E PESTË
ÇOPË LEXIMI

Po të shetitni nëpër krahinat e ndryshme të Shqipnís do të shifni se sa i pasun âsht ky vend në çfaqjet mâ të ndryshme të zakonevet, të banesavet, të veshjevet, të kângëvet, të vallevet etj. Nga të gjitha këto çfaqje, artizanati dallohet në mënyrë të veçantë. Veshjet sidomos përbâjnë çfaqjen mâ tërheqëse të kulturës së popullit shqiptâr. Pasunija e madhe e llojevet të këtyne veshjeve, e formavet, e ngjyravet, e zbukurimevet, por sidomos aftësija me të cilën janë punue këto veshje, paraqesin shijen e hollë të popullit shqiptâr. Ndër kostumet kombëtare thuhet se xhubleta, të cilën e veshin grât e malsivet të Veriut, dhe guna që e veshin burrat në Shqipnín e Jugut, rrjedhin nga veshjet e Ilirëvet. Ndër kostumet mâ të bukura duhet të përmendim kostumet e gravet të Mirditës, të Dukagjinit, të Zerqanit, të Shpatit, të Dumrés, të Dardhës, të Myzeqés, të Shkodrës e të Tiranës.

N'artizanat duhet përmendë gjithashtu argjendarija e veçanërisht filigrani, për të cilin argjendarët, tue punue me fije argjendi të holla sa nji flok, tregojnë mjeshtrí të jashtëzakonshme. Edhe punimet e mëndafshta e punimet e leshit, p. sh. qylymat, çantat e çorapët në radhë të parë, si edhe punimet e drunit, ato të bakrit, të gurit etj. nuk i rrijnë mbrapa argjendarís.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Në kulturën shoqnore të popullit, vlerë të madhe kanë zakonet, që janë ruejtë shekull mbas shekulli, si besa, mikpritja, burrënija etj. Kur burrat shqiptarë janë tue ndejtë e tue bisedue mbas darke, njâni prej tyne që di me këndue mâ mirë, merr lahutën -- vegël muzikore karakteristike e Shqipnís së Veriut -- ase çiftelín -- e përdorun mâ tepër në Shqipnín e Mesme dhe fillon e këndon kângë, të cilat kujtojnë trimnít e ndokujt në luftë kundër anmikut.

N'arkitekturë ruhen edhe sot shumë vepra arti me rândësí, si ura, xhamí, kisha e kalá. Pothuej çdo qytet ka nji kalá që i kujton popullit luftat kundër anmiqvet të shumtë gjatë shekujvet. Nji ndër kalát mâ të përmenduna (renowned) âsht ajo e Krujës, të cilën sa qe gjallë Skënderbeu e bâni të famshme me betejat e tija kundër turqvet. Këto beteja ndodhën nga vjeti 1443 e deri më 1467, por mbasi vdiq Skënderbeu, kalaja u-dorëzue mbas nji rrethimi të gjatë që kërcënonte t'i çfaroste krejt banorët e ushtarët, prej të cilëve kishin vdekë me mija nga luftimet, urija dhe nga epidemít.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

QUESTIONS-PYETJE

1. Po të shetisim nëpër krahinat e ndryshme të cilit shtet do të shofim se sa i pasun âsht ky vend nga shumë pikëpamje?

2. Kur mund të kemi rast të shofim se sa e pasun âsht Shqipnija në çfaqjet mâ të ndryshme të zakonevet?

3. Në çfarë çfaqjesh tjera âsht e pasun Shqipnija?

4. Nga të gjitha këto çfaqje, në ç'mënyrë dallohet artizanati?

5. Cilat sende përbâjnë çfaqjen mâ tërheqëse të kulturës së popullit shqiptár?

6. Çka përbâjnë veshjet?

7. A paraqet pasunija e llojevet të këtyne veshjeve shijen e hollë të popullit shqiptár?

8. Ç'paraqet pasunija e llojevet të këtyne veshjeve?

9. A e paraqet këtë shije edhe pasunija e formavet, e ngjyravet dhe e zbukurimevet të veshjevet?

10. Çka paraqet, pra, pasunija e llojevet, e formavet, e ngjyravet dhe e zbukurimevet të veshjevet?

11. Por sidomos cila aftësí e paraqet shijen e hollë të popullit shqiptár?

12. Ndër kostumet kombëtare, cilat veshje thuhet se rrjedhin nga veshjet e Ilirëvet?

13. Nga cilat veshje rrjedhin xhubleta dhe guna?

14. Cila nga këto dý veshje âsht e përhapun në Verí të Shqipnís?

15. Në ç'pjesë të Shqipnís âsht e përhapun guna?

16. Ndër kostumet e gravet, cilat duhet të përmendim si mâ të bukurat?

17. N'artizanat, cili zanât duhet përmendë gjithashtu?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

18. Cila punë e argjendarís duhet përmendë veçanërisht?

19. Kush punon në filigran me fije të holla pothuej sa nji flok?

20. Me çfarë fijesh punojnë argjendarët dhe sa të holla janë ato fije?

21. Çfarë mjeshtrije tregojnë argjendarët tue punue me fije argjendi?

22. Çfarë artikujsh përfshîjnë punimet e leshit?

23. Cilat punime nuk i rrijnë mbrapa argjendarís?

24. Ku kanë vlerë të madhe zakonet?

25. Për sa kohë janë ruejtë zakonet?

26. Cilat janë disa nga zakonet që janë ruejtë shekull mbas shekulli?

27. Kur burrat janë tue ndejtë e tue bisedue, çfarë vegle merr njâni prej tyne?

28. Kur e merr lahutën ase çiftelín njâni prej burravet që janë tue ndejtë e tue bisedue?

29. Çka di me bâ ai që merr lahutën ase çiftelín?

30. Në ç'pjesë të Shqipnís përdoret lahuta?

31. Po çiftelija, në ç'pjesë të Shqipnís përdoret?

32. Çka fillon me bâ ai që merr lahutën ase çiftelín?

33. Çfarë kângësh fillon të këndojë ai?

34. Trimnít e kujt kujtojnë kângët që këndon ai?

35. Çfarë veprash ruhen edhe sot n'arkitekturë?

36. Cilat janë këto vepra arti që ruhen n'arkitekturë?

37. Cilat nga këto vepra arti ka pothuej çdo qytet?

38. Cilat lufta i kujton kalaja popullit?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

39. Kujt i kujton kalaja luftat kundër anmiqvet të shumtë që ka pasë gjatë shekujvet?

40. Sa anmiq ka pasë populli shqiptár gjatë shekujvet?

41. Cila âsht nji ndër kalát mâ të famshme?

42. Kush e bâni të famshme kalán e Krujës?

43. Me cilat beteja e bâni ai të famshme kalán e Krujës?

44. Kundër kujt luftoi Skënderbeu nga vjeti 1443 e deri më 1467?

45. Kur ndodhën betejat që bâni Skënderbeu kundër turqvet?

46. Cila kalá u-dorëzue mbas nji rrethimi të gjatë?

47. A u-dorëzue kalaja e Krujës sa qe gjallë Skënderbeu, apo mbasi vdiq ai?

48. Çka i ndodhi kalás së Krujës mbasi vdiq Skënderbeu?

49. Çka kërcënonte me i çfarosë krejt banorët e ushtarët?

50. Nga se vdiqën me mija ushtarë e banorë gjatë rrethimit?



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

LESSON 72
PART VI
HOMEWORK

A. Mbushni vendet boshe të fjalivet që vijojnë:

1. Prindët e mij, _____ (when they were alive), jetojshin me mue.

2. Çdo të diele mbasdreke, më pëlqen _____ (to stroll) gjatë _____ (the seashore).

3. Megjithëqë ha shumë, âsht _____ (thin) si shkop.

4. Kjo gjellë s'ka _____ (taste).

5. Ka shumë njerëz që nuk mund t'i _____ (distinguish) ngjyrat.

B. Përkëtheni shqip fjalít që vijojnë:

6. They still don't know the reason why he threatened them.

7. Halil surrendered because he ran out of (he had no more) shells (cartridges).

8. Many nations have been annihilated through the centuries.

9. It is an honor for me to speak to you about Scanderbeg's bravery.

10. He withdrew from the battle only for tactical reasons.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E SHTATË
FJALORI

LESSON 72
PART VII
VOCABULARY

argjend, -i	(m.)	silver
argjendár, -i argjendarë, -t	(m.)	silversmith, goldsmith
argjendarí, -ja	(f.)	craft of the silversmith and goldsmith
arkeologjik, -e	(adj. m. & f.)	archaeological
arkitekturë, -a	(f.)	architecture
art, -i arte, -t	(m.)	art
betejë, -a beteja, -t	(f.)	battle
me çfarosë (unë çfaros)	(v.)	to annihilate, exterminate
çiftelí, -ja çiftelí, -t	(f.)	lute with two strings
me u-dallue (unë dallohem)	(v.)	to be distinguished, discerned
me u-dorëzue (unë dorëzohem)	(v.)	to surrender; to be ordained (Eccl.)
dru, -ni druj, -t	(m.)	wood, tree
fije, -a fije, -t	(f.)	thread
filigran, -i	(m.)	filigree
gjallë	(adv.)	alive, living
i, e, të hollë të holla	(adj. m. & f.)	thin, fine; slim, slender; clever, smart

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

interesant, -e	(adj. m. & f.)	interesting
kalá, -ja kalá, -t	(f.)	fortress
me kërcënue (unë kërcënoj)	(v.)	to threaten
lahutë, -a lahuta, -t	(f.)	lute
i, e, të mëndafshtë të mëndafshta	(adj. m. & f.)	made of silk, silken
mikpritje, -a	(f.)	hospitality
muzikuer, muzikore	(adj. m. & f.)	musical
me ndodhë (unë ndodh)	(v.)	to happen, take place; chance to be
paleolitik, -e	(adj. m. & f.)	paleolithic (pertains to the first period of the Stone Age)
perandorí, -ja perandorí, -t	(f.)	empire
përdorim, -i përdorime, -t	(m.)	use, usage, using
punim, -i punime, -t	(m.)	work, working
rrethim, -i rrethime, -t	(m.)	siege
shekull, -i shekuj, -t	(m.)	century
me shetitë (unë shetis)	(v.)	to walk, stroll, promenade; travel
shije, -a shije, -t	(f.)	taste

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

me u-tërheqë (unë tërhiqem)	(v.)	to withdraw; be pulled, towed, hauled
tërheqës, -e	(adj. m. & f.)	attractive; drawing, pulling
trimní, -ja	(f.)	bravery
turk, -e	(adj. m. & f.)	Turkish
turk, -u turq, -t	(m.)	Turk
urí, -ja	(f.)	hunger



499

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.